



ISLAMI DHE POLITIKA NË BALLKANIN PERËNDIMOR



ISLAMI DHE POLITIKA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Botues i origjinalit

Département fédéral des affaires étrangères DFAE
Direction politique
Secrétariat politique
Politorbis
www.eda.admin.ch/politorbis

Ribotim i:

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim
Ndërkombëtar



Titulli

Islami dhe politika në Ballkanin Perëndimor

Titulli i origjinalit

Islam et politique dans les Balkans occidentaux

Botues i origjinalit

Département fédéral des affaires étrangères DFAE

Direction politique

Secrétariat politique

Politorbis

Bernastrasse 28, 3003 Bern

Phone: +41 31 325 81 52

Fax: +41 31 324 38 39

mailto: politorbis@eda.admin.ch

www.eda.admin.ch/politorbis

Ribotim i:

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtare (QMBN)

Nikolla Parapunov p.n., f.p. 55

1060 Shkup, Maqedoni

Tel: +389 (0)2 30 65 381

Faksi: +389 (0)2 30 65 298

e-mail: mcms@mcms.org.mk

www.mcms.org.mk

Drejtor ekzekutiv

Sasho Klekovski

Redaktor përgjegjës

Aleksandar Krzhhalovski

Dizajni dhe përgatitja

Koma lab.

Shtypi

Borografika

Tirazhi

200 ekzemplarë

Përkthimi i botimit në gjuhën shqipe është mundësuar me lejen e botuesit.

Qëndrimet e parashtruara në këtë publikim i paraqet qëndrimet dhe vështrimet e autorit dhe nuk i pasqyrojnë qëndrimet e QMBN.

PËRMBAJTJA

Parathënie Olivje ENER	5
Hyrje Bashkim ISENI/Gvazje BUGARELL	7
Mes nacionalizmit laik dhe instrumentalizimit të institucioneve fetare islame Bashkim ISENI.....	19
Fundi i hegjemonisë së PAD dhe rrënjëzimi institucional i neosalafizmit Gvazje BUGAREL	55
Bibliografi e seleksionuar	93
Akronime	97

Parathënie

Olivje ENER¹

Ky botim i Politorbis është rezultat i një hulumtimi të porositur nga Sekretariati politik i BFPJ (DFAE). Qëllimi i tij është të sqarohen marrëdhëniet mes islamit dhe veprimeve politike në Ballkanin Perëndimor. Ky religjion në të vërtetë është element përbërës tradicional nga fundi i mesjetës, jo vetëm në jetën fetare, por njëkohësisht edhe të jetës kulturore dhe sociale për një numër të madh të banorëve në këtë rajon dhe kohabitojnë me më shumë ose më pak fat nëpër epoka – me krishterimin, qoftë ai katolik, ortodoks ose më rrallë, protestant.

Nëse inkuadrimi në aktivitetet e ndryshme fetare ka luajtur rol të pakontestueshëm në luftërat e paradokshme në Ballkan, pikërisht për shkak të aftësisë për karakterizim të identiteteve kolektive dhe mobilizimin e shtresës së gjerë të popullatës, do t ishte me të vërtetë e tepërt të thuhet se bëhet fjalë për luftë fetare. Edhe më shumë që nga Jugosllavia e paradokshme komuniste (1943-1991), shumica me kënaqësi u deklarua për ideologjinë zyrtare ateiste. Është e vërtetë se përtëritja e interesave për faktin fetar, sa individuale aq edhe kolektive, që erdhi pas rënies së sistemit të Titos, koincidon me fillimin e një dekade të re të luftërave (1991-2001), duke krijuar interaksione të shumta mes luftërave dhe religjioneve. Pikërisht këto të fundit ishin thirrur, para së gjithash, për përcaktimin e identitetit kolektiv, për t'u dalluar – mes atyre vëllezërve të mëparshëm sipas Marksit, ithtarëve të ri të Muhamedit, ato të Krishtit, me qëllim që të theksohen dallimet, të arsyetohet eliminimi i të afërmit ti tij me gjoja vullnetin e perëndisë.

Por, marrëdhëniet mes religjioneve nuk do të mund të sillen në manipulime politike, me qëllime ekskluzive, bile edhe luftarake, pasi që mund të numërohen shembuj të shumtë të marrëdhënieve të mira ndërfaqetare të cilat janë mbajtur, ose ku thjesht religjioni nuk ka krijuar pengesa mes qytetarëve me fe të ndryshme, bile edhe në periudhat më të vështira të luftës. Në të vërtetë, besimtarët e religjionit të tillë nuk i mbajnë me domosdoshmëri marrëdhëniet e njëjta me religjionin, ose nuk e implikojnë në të njëjtën mënyrë në jetën politike, varësisht nga nacionaliteti, epoka ose vendbanimi (dallimet në këtë fushë mes qytetit dhe fshatit, fushës dhe malit, duhet të theksohen).

Nëse ky hulumtim është përqendruar në islamin, kjo është pikërisht nga konteksti i marrëdhënieve aktuale ndërkombëtare, të cilat gjithë vëmendjen botërore e kanë përqendruar në çështjen e terrorizmit me inspirim islam, për shkak të atentateve të

.....
1 Bashkëpunëtor i Sekretariatit Politik (POLS), Byroja federale e Punëve të Jashtme të Zvicrës (DFAE).

shtatorit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 2001. Një studim i ngjashëm do të mund të bëhej për Ballkanin, me dimension politik për ortodoksinë, katolicizmin ose protestantizmin, bile edhe ideologji të tjera.

Bëhet fjalë për afrimin e religjionit autokton, që tradicionalisht është më pak e njohur në Ballkanin Perëndimor, nëpërmjet kontributit për migrimin nga fundi i shekullit 20. Për këtë qëllim, u referohemi dy specialistëve për zhvillimin politik të Ballkanit, z. Bashkim ISENI, specialist për çështjen e nacionalizmit në rajonet ku jetojnë shqiptarët dhe autor i hulumtimeve për faktet fetare në këtë rajon, dhe z. Gvazje BUGAREL, i njohur sipas veprës së tij për zhvillimin politik në Bosnjë dhe Hercegovinë, që ka të bëjë pikërisht me faktin fetar.

Rezultat i gjithë kësaj është një panoramë e pasur dhe e llojllojshme për zhvillimin e islamit në 20 vitet e fundit në rajonet kryesore të Ballkanit, në ato pjesë ku praktikohet, si dhe ndikimet e ndërsjella mes këtyre vendeve. Edhe më shumë, përfundimet i hulumtojnë perspektiva të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e mundshëm të marrëdhënieve mes islamit dhe politikës, duke marrë parasysh sfidat e mëdha, me të cilat ballafaqohet ky rajon (statusi i Kosovës, integrimi evropian etj.). Për fat të keq, për shkak të mungesës së kohës dhe resurseve, rajone të caktuara të rëndësishme janë lënë anësh, veçanërisht Shqipëria, si dhe studimi i interaksionit të islamit me religjionet tjera në rajon ose qasja ndaj këtyre çështjeve në kuadër të diasporës, veçanërisht në Zvicër.

Dëshirojmë që ky studim të kontribuojë për njoftimin më të mirë të njërës nga religjionet e mëdha tradicionale në rajonin e Evropës dhe njërës nga faktorët më të rëndësishëm politik në Ballkan, për zhvillimin e paradokohshëm të shpejtë dhe në harmoni.

Hyrje

Bashkim ISENI/Gvazje BUGAREL

Qëllimi i kësaj dosjeje është të kontribuojë në ndriçimin e evolucionit të islamit në Ballkanin Perëndimor në dy dekadat e fundit. Përqendrohet në popullatën myslimane në ish Jugosllavi dhe ndërlidhet në dy studime në teren, të realizuar në Kosovë, në Maqedoni dhe në Serbinë e Jugut nga njëra anë dhe në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Sanxhak (Serbi, Mali i Zi), nga ana tjetër. Në këtë hyrje, do të kthehemi kryesisht në karakteristikat historike të islamit në Ballkan, para së gjithash të interesohemi për pozitën që e merr religjioni në identitetin kombëtar të popullatës myslimane në rajon. Pastaj, pasi që shkurtimisht të saktësohet rëndësia e termeve të caktuara, do t'i prezantojmë përfundimet kryesore, të cilat do të dalin nga ky studim.

1 . Islami në Ballkan: qasje historike

Sipas llogarive të bëra në bazë të regjistrimit nga viti 1991, rreth 4.800.000 banorë në Jugosllavinë e atëhershme kanë qenë me fe myslimane, ose rreth 20% nga popullata e përgjithshme. Boshnjakët/Myслиmanët¹ kanë qenë rreth 2.400.000, të përqendruar në Bosnjë dhe Hercegovinë (1.900.000, ose 44% nga popullata e përgjithshme) dhe në Sanxhak, rajon i cili gjendet në kufirin me Serbisë dhe Malit të Zi (230.000, ose 52%). Shqiptarët me fe myslimane² kanë qenë rreth 2.100.000, të përqendruar në Kosovë (1.550.000, ose 80%), në Maqedoni (430.000, ose 21%) dhe në Luginën e Preshevës, në Serbinë Jugore (70.000, ose 68%). Romët me fe myslimane, numri i të cilëve ende vështirë vlerësohet (nga 100 deri 150.000), kanë qenë veçanërisht prezent në Maqedoni dhe në Kosovë³. Turqit në Maqedoni kanë qenë rreth 10.000, ose 0,5%. Dhe në fund,

.....

1 Në terminologjinë zyrtare të Jugosllavisë komuniste termi "Myслиman" (*Musliman*) me M të madhe ka kuptimin e kombësisë dhe i emëron të gjithë sllovenët e islamizuar që flasin gjuhën serbo-kroate, pa dallim të nivelit të asaj sa janë fetar, deri sa termi "myслиman" (*Musliman*) me m të vogël ka kuptimin fetar dhe i emëron të gjithë besimtarët myslimanë, pa dallim të përkatësisë së tyre kombëtare. Në vitin 1993 emri nacional "Myслиman" (*Musliman*) është zëvendësuar me emrin "Boshnjak" (*Bošnjak*). I njëjti nuk duhet të ngatërrohet me termin "Boshnjak" (Bos-anac) që përdoret për t'i emëruar banorët e Bosnjës dhe Hercegovinës.

2 Rreth 5% të shqiptarëve të Kosovës dhe 30% të shqiptarëve të Malit të Zi janë me fe katolike.

3 Jashtë Maqedonisë dhe Kosovës, shumica e romëve nga Ballkani Perëndimor janë me fe ort-

në Maqedoni dhe në Kosovë kategoria nacionale “Myslimanë” përfshin njëkohësisht Myslimanë/Boshnjakë, kryesisht me prejardhje nga Sanxhaku dhe grupe të vogla etnike sllavofone (Torbeshët në Maqedoninë Perëndimore, Goranët në Kosovën Jugore).

1.1. Procesi i islamizimit në Ballkanin osman

Islamizimi në Ballkan fillon me zgjerimin territorial të Perandorisë Osmane në shekullin 19 dhe 20. Në fillim, procesi i islamizimit i përfshinë mjediset urbane, që më vonë të zgjerohet dhe të konvertojë fshatra të tëra. Autokton islam para së gjithash janë shqiptarët dhe sllavenët, por gjithashtu edhe romët dhe vllehtë. Këtyre autoktonëve u bashkëngjiten edhe turqit dhe sirkasienët (me prejardhje nga Kaukazi Perëndimor), të ardhur nga pjesët lindore të Perandorisë.

Shkaqet për islamizimin paraqet qëllim kryesor për analiza të ndryshme. Ndonjëherë theksi i vihet presionit që e kanë kryer autoritetet osmane për konvertim të një popullate të caktuar. Ekzistojnë raste të shumta të konvertimit të dhunshëm, por nxitjet ekonomike kanë luajtur rol të rëndësishëm në procesin e islamizimit: për shkak të faktit se myslimanët kanë pasur tatime më të vogla nga jomyslimanët, konvertimi i islamizimit do të thoshte përparësi të dukshme. Kjo ka qenë mënyrë për ngritje në kuadër të aparatit shtetëror dhe ushtarak osman. Edhe më vonë, autoritetet lokale të Perandorisë Osmane dhe popullata e konvertuar lokale kanë kontribuar për përhapjen e islamit⁴.

Islami në Ballkan në masë të madhe është i përfaqësuar nga islami sunit, që i takon *madhhabit* hanefit, shkollë zyrtare juridike në Perandorinë Osmane. Por, gjithashtu karakterizohet me një shumicë të caktuar të brendshme. Vëllazëritë e sofizmit kanë luajtur rol aktiv në procesin e islamizimit dhe në praktikë kanë integruar elemente të caktuara me prejardhje nga religjionet tjera. Vëllazëritë kryesore të pranishme në Ballkan janë bektashinjtë (Bektash), me ndikim të veçantë në Shqipëri, halvetitë dhe nakshbendët. Sipas Mishel Balive, dallimi etnolinguist në Ballkan dhe prezenca e radhëve të sufuzmit e caktojnë islamin e fuqishëm ballkanik nëpërmjet besimit dhe praktikizmit popullor⁵.

1.2. Statusi i islamit në Ballkanin pas osman

Gjatë periudhës osmane, myslimanët e Ballkanit janë identifikuar me Perandorinë dhe gëzonin status superior socio-politik, përkundër jo myslimanëve. Me tërheqjen e Perandorisë Osmane gjatë shekullit 19 dhe 20, situata bëhet e kundërt. Përveç në rastin e veçantë me Shqipërinë, ky popull bëhet pakicë në kuadër të shteteve të reja ballkanike me shumicë ortodokse dhe cak i formave të ndryshme të presioneve dhe diskriminimeve. Kjo situatë paraqet shkas për valë të madhe migrimesh: mes 1878 dhe 1945, dy nga tre milionë myslimanë nga Ballkani emigrojnë në Turqi, tendencë që zgjati deri në vitin 1960.

odokse, katolike ose protestante.

4 Paralelisht, popujt e fesë ortodokse janë organizuar në millet (shoqëri e pvarur religjioze). Çdo millet duhej ta pranojë autoritetin politik të sulltanit, por pavarësisht e organizonin jetën religjioze, kulturore dhe edukative.

5 Shih te Mishel Balive (1992)

Përveç karakteristikave të islamit ballkanik lidhur me prejardhjen osmane, statusi i tyre si pakicë në periudhën post osmane sqaron edhe disa veçori të caktuara bashkëkohore. Institucionet fetare islame janë vënë nën pushtetin e drejtpërdrejtë të shteteve të reja. Nga ky shkak, ato duhet të aftësohen për statusin e tyre të ri si pakicë, dhe prej këtui, modernizimin e shtetit dhe të shoqërisë. Pas Luftës së Dytë Botërore, regjimi i vendosur komunist në shumicën e shteteve në rajon (me përjashtim të Greqisë), nisën me shkatërrimin e institucioneve tradicionale fetare: nacionalizimi i vakëfeve (waqf – fondacione fatura), mbylljen e medreseve, heqjen e gjykatave të sheriatit në Jugosllavi. Regjimi në këtë vend e mban nën kontroll të rreptë bashkësinë islame, i cili bën monopol në jetën fetare myslimane, me ndalimin e vëllazërisë së sofizmit në vitin 1952.

Megjithatë, duke filluar nga viti 1960, liberalizimi i regjimit jugosllav sjell deri te përtëritja e jetës fetare myslimane, i karakterizuar pikërisht me ndërtimin të xhamive, zhvillimin e mësimin fetar dhe botimeve fetare në gjuhën lokale. Por ky zhvillim nuk e sjell në pikëpyetje as ndjekjen e kryerjes së obligimeve fetare në rrethin privat, as modernizimin dhe laicizmin e shpejtuar të shoqërisë. Dhe e rënien e komunizmit në vitin 1989/1990, religjioni kthehet në jetën publike, dhe në masë të vogël në jetën politike.

2. Islami dhe identiteti kombëtar në Ballkanin Perëndimor

Gjatë shekullit 19 dhe 20 çdo grup etnolinguist, kalimin nga sistemi osman *milet* në shtete-kombe e kanë bërë sipas modaliteteve të veta. Veçanërisht, lidhja mes islamit dhe identitetit kombëtar nuk është e njëjtë për të gjitha grupet e prekura.

2.1. Islami dhe identiteti kombëtar te shqiptarët

Identiteti kombëtar te shqiptarët është ndërtuar rreth gjuhës, nga ideja për prejardhjen ilire e shqiptarëve dhe nga figura të caktuara mitologjike historike. Marrin pjesë në tre, bile edhe në katër bashkësi fetare (myslimanë, sunitë, myslimanë bektashi, katolikë dhe ortodoksë), promotorët e nacionalizimit shqiptar e shohin religjionin si faktor për ndarje dhe insistojnë në gjuhën si element ndërlidhës. Për ata gjuha paraqet mjet për t’iu kundërvënë procesit të centralizimit (dhe turqizmit), të filluar gjatë Perandorisë Osmane, në mesin e shekullit 19, si dhe mjet për mbrojtjen e viseve shqiptare nga përpjekjet ekspansioniste për shtete të reja ballkanike.

Mes luftërave ballkanike (1912-1913) dhe Luftës së Dytë Botërore (1941-1945), shqiptarët të cilët mbetën jashtë Shqipërisë kanë organizuar rezistencë ushtarake si “kaçak” dhe kërkojnë bashkëngjitje me Shqipërinë. Pikërisht në këtë periudhë formohet “Komiteti i Kosovës”. Për shkak të faktit se gjuha dhe kultura e shqiptarëve nuk ka prejardhje sllovene, vështirë mund të asimilohen nga Mbretëria e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, të formuar në vitin 1918 dhe (të riemëruar në Mbretëria e Jugosllavisë në vitin 1929) dhe janë të ekspozuar presioneve të mëdha. Pikërisht ky presion i shtynë një numër të madh të shqiptarëve të emigrojnë në Turqi, deri sa njëkohësisht kolonitë serbe dhe malazeze instalohen në Kosovë dhe Maqedoni.

Në planin edukativ, forcat serbe kërkojnë mbylljen e shkollave shqipe. Politika e tillë aplikohet për shkak të arsimimit të dobët të shtresës më të gjerë të popullatës dhe për shkak të pafuqisë së elitës politikës dhe intelektuale. Institucionet e vetme të autorizuar arsimore janë shkollat fetare, islame ose katolike. Ligjëruesit myslimanë janë dërguar nga Bosnja dhe Hercegovina me qëllim që të favorizohet asimilimi i popullatës shqiptare, por ky projekt dështoi për shkak të zhvillimit të një sistemi paralel shkollor në gjuhën shqipe, në kuadër të këtyre institucioneve të njëjta, të cilat shërbenin si platformë për përhapjen e ideve nacionaliste shqiptare.

Me inkuadrimin e popullatës shqiptare në Jugosllavinë komuniste, iniciohet politikë e rëndësishme për modernizim dhe integrim, duke filluar nga viti 1960 në viset kulturore shqiptare, veçanërisht në Kosovë. Kjo tërheq laicizëm të shpejtë të popullatës dhe elita të reja urgjente politike dhe intelektuale, të cilat i inspirojnë demonstratat në Kosovë nga viti 1968 deri në vitin 1981. Kërkesat e demonstruesve përqendrohen në përmirësimin e kushteve jetësore, status më të mirë politik për shqiptarët, njohjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare në kuadër të federatës jugosllave.

Duke pasur parasysh historinë bashkëkohore të shqiptarëve nga ish Jugosllavia, jepet një konstatim: edhe krahas asaj që kjo popullatë paraqet shumicën e myslimanëve sunitë, dhe krahas asaj që islami dhe katolicizmi paraqesin shenja të rëndësishme të identitetit në krahasim me popujt ortodoks slloven, rekomandimet për islamin mbeten marginale në fjalët dhe aksionet e lëvizjes nacionaliste shqiptare.

2.2. Islami dhe identiteti kombëtar te myslimanët/boshnjakët

Pas okupimit të Bosnjës dhe Hercegovinës nga ana e Perandorisë Austro-Hungareze në vitin 1878, myslimanët/boshnjakët kuptojnë se për të mbijetuar, do të duhet të kenë marrëdhënie të mira me pushtetin e ri qendror. Shumica, ata megjithatë e refuzojnë qëllimin e austro-hungarezëve për formimin e kombit boshnjak, i cili pranon tre bashkësi, myslimane, ortodokse dhe katolike. Që atëherë, islami gjen vendstrehim të identitetit për popullatën që flet gjuhën serbo-kroate, por kërkon një identitet tjetër nga ai i serbëve ortodoks dhe kroatëve katolik. Në të vërtetë, kjo paraqet përpjekje për marrjen e identitetit, nga ana e nacionalistëve serb dhe kroat, të cilët e përshkruajnë si “Serb me fe islame” ose “Kroat me fe islame” dhe në të njëjtën kohë kërkojnë të legjitimohen pretendimet e tyre territoriale në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Pas integritetit të Bosnjës dhe Hercegovinës në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, elitat tradicionale myslimane/boshnjake rigrupohen në Organizatën Myslimane Jugosllave (*Jugoslovenska Muslimanska Organizacija – JMO*). Kjo organizatë e mbështet idenë e “jugosllavizmit” me qëllim që të mbrohen nga qëllimi asimilues serb e kroat. Gjatë ndarjes territoriale të Bosnjës dhe Hercegovinës, mes Serbisë dhe Kroacisë në krahina në vitin 1939, liderët serb dhe kroat refuzojnë çfarë do qoftë rol politik dhe çfarë do lloj identiteti specifik të myslimanëve/boshnjakëve. Që atëherë, të fundit edhe më shumë tërhiqen në identitetin e tyre fetar dhe në atë kontekst idetë islamike paraqiten mes rinisë së arsimuar myslimane/boshnjake. Pas formimit të Jugosllavisë komuniste, në vitin 1945, paraqiten elita të reja laike myslimane/boshnjake, të cilat përpiqen të promovojnë një identitet specifik kombëtar. Në vitin 1960 zhvillimi politik në Jugosllavi e shtyn regjimin komunist ta pranojë ekzistimin e një kombi mysliman⁶ në Bosnjë e Hercegovinë dhe në mënyrë progresive e përhapin këtë pranim në gjithë territorin e Jugosllavisë. Pas këtij procesi, vazhdon zbulimi i serishëm i historisë dhe kulturës myslimane/boshnjake dhe riaktivizohen lidhjet me botën myslimane, në kuadër të pjesëmarrjes së Jugosllavisë në Lëvizjen e të Pavarurave.

2.3. Islami dhe identiteti kombëtar te turqit, te romët, te torbeshët dhe te goranët

Te turqit e Maqedonisë dhe të Kosovës lidhja mes islamit dhe identitetit kombëtar historikisht është kushtëzuar nga zhvillimi i ngjarjeve politike dhe fetare në Turqi. Në Maqedoni kjo bashkësi mban lidhje të ngushta me popullatat tjera myslimane, veçanërisht me atë shqiptare. Njëkohësisht, ajo mban lidhje të mira me autoritetet maqedonase dhe është relativisht mirë e integruar në aparatën shtetërore. Numri i turqve ndryshon shumë

.....
6 Shih te fusnota 1

gjatë kohës së regjistrimit në periudhën komuniste, për shkak të pjesëmarrjes së popullatës tjetër fetare islame në kategorinë “turq”, si për shembull shqiptarë, romë, torbesh. Nga viti 1960 një pjesë e popullatës urbane myslimane, e cila deklarohet si “turq”, fillon të deklarohet si “shqiptarë”. Ky revolucion e reflekton emancipimin e popullatës shqiptare në Jugosllavi gjatë kësaj periudhe të njëjtë.

Popullata rome me traditë fetare myslimane është e përbërë nga myslimanë sunitë dhe sufistë. Ajo është shumë e marginalizuar në planin socio-ekonomik dhe politik dhe shpesh është e ekspozuar në ndërrimin e identitetit dhe religjionit. Për shembull, në Maqedoni afrohet procesi i konvertimit në protestantizëm që vijon pas aksionit të misioneve protestante në këtë vend disa vite me radhë.

Torbeshët dhe goranët (sllavofon) në Maqedoni dhe në Kosovë në të kaluarën janë identifikuar si myslimanë/boshnjak ose, si turq. Por autoritetet maqedonase në mënyrë energjike kanë investuar në promovimin e identitetit “myslimanë maqedonas”, duke u frikësuar nga turqizmi ose shqiptarizimi i kësaj popullate mes lidhjeve fetare.

3. Disa definicione paraprake: islamizmi dhe neosalafizmi

Në Ballkan, si dhe gjithkund, debatet për raportet mes islamit dhe politikës ose zhvillimit doktrinar të islamit shpesh herë karakterizohet me një përdorim jo të saktë dhe polemikë të shprehjeve siç është “islamizimi”, “fundamentalizmi”, vehabizmi” ose “xhihadizmi”. Imponohet sqarim për terminologjinë e përdorur në këto dy studime, të cilat e përbëjnë këtë dosje, para së gjithash që të nxirren përfundimet kryesore.

Islamizmi – ose islami politik, mund të definohet si vullnet për riafirmimin e dimensioneve dhe shkathhtësisë politike të islamit në botën bashkëkohore. Do të thotë nuk është në kundërshtim me pranimin e një modernizmi të caktuar, duke e përfshirë edhe në dimensionet politike dhe kulturore. Lëvizjet islamike shpesh herë kanë dimension të madh nationalist, siç e ilustron këtë “Hezbollahu” (Hezbollah) në Liban, “Hamasi” (Hamas) në Palestinë dhe Lëvizja e vëllezërve myslimanë në botën arabe, ose Partia e Drejtësisë dhe Zhvillimit (Adalet ve kalkıma partisi - AKP) në Turqi. Duhet, mes tjerash, të bëhet dallim mes *islamizmit modern*, që i pranon strategjitë zgjedhore dhe i respekton parimet demokratike, dhe *islamizmit radikal*, që përdor mjete revolucionare dhe të dhunshme që të vijë deri në pushtet dhe ta udhëheqë pushtetin në mënyrë diktatori.

Neosalafizmi paraqet fundamentalizëm fetar i cili dëshiron të kthehet te islami i “paraardhësve të devotshëm” (*al salaf al salih*)⁷. Neosalafistët e idealizojnë kohën e Pejgamberit dhe ithtarët e tij dhe i hedh poshtë besimet dhe dukuritë fetare, të cilat nuk janë vërtetuar në Kuran ose *Synet* (traditë e bazuar në fjalët dhe veprat e Pejgamberit). Ata janë armiq të modernizmit politik dhe kulturor, si dhe të traditave lokale fetare, procedurë që e mohon zhvillimin historik dhe laramanin kulturore të bashkësisë myslimane.

Këtu duhet të bëhet dallim mes *neosalafizmit nga tipi i devotshëm* dhe *neosalafizmi i tipit të xhihadit*. *Neosalafizmi i tipit të devotshëm* kërkon, para së gjithash, të reislamizohen individët dhe bashkësia, ai në vete thellë është konservativ dhe qëllimi i tij është shembja e regjimit politik, që sqaron se është i inkurajuar dhe i financuar nga monarkitë e Gjirit Persik. *Neosalafizmi i tipit të xhihadit* e respekton *Ummen* (bashkësia e besimtarëve) si bashkësi e vetme legjitime politike-religjioze dhe insiston që detyrën fetare ta udhëheqë xhihadi (lufta e shenjtë) kundër botës perëndimore dhe regjimeve “të pafe” të botës myslimane. Kjo paraqet një ekstremizëm i llojit më të ri, global dhe i pakufizuar në territor, përfaqësues kryesor i së cilës është rrjeti “Al-kaeda”.

Më në fund, neosalafisët e Ballkanit shpesh kualifikohen si “vehabistë” nga ana e mediumeve lokale dhe nga perëndimi. Vehabizmi është formë e neosalafizmit karakteristik për Arabinë saudite dhe lidhet me *madhabin* hanbalit. Por, Arabia Saudite edhe pse

.....
7 Neosalafizmi e ka prejardhjen nga salafizmi, cili nga fundi i shekullit 19, ka dashur t’i kthehet islamit burimor që t’i kundërvihet dobësimi të tij në botën myslimane dhe dominimit nga perëndimi. Por, salafizmi, duke u angazhuar për hapjes e serishme të portave të xhihadit (komentim i lirë) njëkohësisht ka sjellur deri e përhapja e reformizmit mysliman, lëvizjeve islamike dhe lëvizjeve tjera laike nacionaliste të botës myslimane.

ka kontribuar gjerë për përhapjen e neosalafizmit në Ballkanin Perëndimor, kjo nuk do të thotë se përfaqësuesit lokal të cilët e hedhin poshtë madhhabin hanefit, e quajnë veten si vehabistë ose identifikohen me regjimin saudit. Aplikimi i epitetit “vehabistë” shpesh keqpërdoret, ushqen shumë polemika, duke i fshehur qëllimet e vërtetat dhe në fund rrezikon q ta kuptojë gabimisht zhvillimin dhe përçarjet e brendshme të islamit në Ballkanin Perëndimor.

4 . Islami në Ballkanin Perëndimor: përfundimet kryesore

Në bazë të dy studimeve në teren, të realizuara në Kosovë, në Maqedoni dhe në Serbinë Jugore nga njëra anë, në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Sanxhak (Serbi, Mali i Zi) nga ana tjetër, mund të nxirren përfundime të shumta, që ka të bëjë me raportet mes islamit dhe politikës, evolucionit të institucioneve fetare islame dhe përhapjen e një lëvizjeje neosalafiste.

4.1. Marrëdhëniet mes islamit dhe politikës

Krahasimi i raporteve ekzistuese mes islamit dhe politikës në Ballkanin Perëndimor lejon të dallohen 3 konfiguracione kryesore:

- Në Bosnjë dhe Hercegovinë, një lëvizje islamike, deri atëherë e marginalizuar, në vitin 1990 e krijoi Partinë për Aksion Demokratik (PAD), parti kryesore nacionaliste myslimane/boshnjake, dhe në këtë mënyrë hyri në qendrën e përbërjes së elitës politike boshnjake dhe në vitin 1993 e mori kontrollin mbi institucionet fetare islamike. Në vitin 2000 kjo lëvizje islamike ballafaqohet me marginalizimin progresiv në kuadër të së njëjtës PAD dhe institucionet fetare luajnë rol të pavarur, por jo më pak të rëndësishme në jetën politike;
- Në Kosovë institucionet fetare islame që në vitin 1990 i mbështetën kërkesat nacionaliste të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), atëherë hegjemoniste te popullata shqiptare. Në fund të vitit 1990 paraqitja e partive tjera nacionaliste shqiptare, të dalë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), nuk pati ndikim të madh mbi marrëdhëniet e religjionit dhe politikës, elita e përgjithshme politike shqiptare mbeti me inspirimin laik, ndërsa institucionet fetare qëndronin anash nga jeta politike;
- Në Maqedoni dhe në Sanxhak dallimet strategjike dhe rivalitetet partiake të elitave nacionaliste shqiptare (Maqedoni) ose boshnjake (Sanxhak) sollën deri në përpjekje më pak ose më shumë të marrjes së pushtetit mbi institucionet fetare islame. Në vitin 2000 kjo parti luftarake e solli Maqedoninë deri në krizë të thellë të institucioneve fetare. Në Sanxhakun serb, përkundrazi, e favorizonin përhapjen e tyre si bashkëfolës të privilegjuar të autoriteteve serbe.

Në pesë deri dhjetë vitet e ardhshme parashihihen struktura të reja të marrëdhënieve mes islamit dhe politikës në Ballkanin Perëndimor.

- Hipoteza për formimin e një ose më shumë shteteve islamike në Ballkanin Perëndimor është opsion i pabazë dhe i hedhur poshtë nga aktorët lokal islamik dhe mbështetësit e tyre të jashtëm. Gjithashtu, idea për “transversalen e gjelbër” e cila e lidhë popullatën myslimane të Ballkanit Perëndimor nuk ka bazë reale, për shkak se kjo popullatë është më shumë nën kërcënimin nga “getoizimin” në kuadër

të një entiteti territorial me status të pacaktuar. Përkundrazi, dukuria e dy entiteteve shtetërore ose huazi shteteve me shumicë myslimane (Kosova dhe Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës) do të sjellë deri te rikompozime të mëdha gjeopolitike dhe identitete (ndarja e bashkësisë boshnjake dhe riislamizimi i identitetit kombëtar boshnjak, paraqitja e Kosovës me shumicë sunitë, si qendër e re e nacionalizmit shqiptar dhe kontestimi i karakterit laik të ideologjisë nacionaliste shqiptare);

- Rënia e lëvizjes islamike në Bosnjë dhe Hercegovinë, përhapja e debatit për lidhjen mes islamit dhe identitetit kombëtar shqiptar në Kosovë dhe Maqedoni dhe riinvestimi i përgjithshëm nga sfera publike nga ana e institucioneve fetare islame, pa dyshim do të shkojnë drejt afrimit mes situatave të sotme lokale shumë të ndryshme. Ateizmi i elitave politike shqiptare, si dhe ndarja e fuqishme ideologjike mes elitave politike boshnjake me orientim fetar dhe laik duhej të zhduken në dobi të një udhëheqje oportuniste të raporteve mes religjionit dhe politikës. Në këtë kontekst, lëvizja islame do të mbetet pakicë, e organizuar nën formë të partive islamike dhe islamike-nacionaliste me aftësi të zvogëluara zgjedhore, ose nga fraksione të brendshme të partive kryesore nacionaliste.

4.2. Evoluimi i institucioneve fetare islame

Studimi për evoluimin e institucioneve fetare islame në Ballkanin Perëndimor lejon të parashtrohen tre evolucione kryesore:

- Si pasojë e shkatërrimit të Bashkësisë Islame të Jugosllavisë në vitin 1993, formohen pesë bashkësi të ndryshme islame (Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Serbi dhe Mali i Zi), kufijtë administrativ të cilave dhe marrëdhëniet reciproke ende nuk janë stabile. Kjo është flagrante në rastin me Serbinë, dhe veçanërisht me Sanxhakun serb (marrëdhëniet me *reis-ul ulemanë* e Sarajevës dhe/ose myftiun e Beogradit, marrëdhëniet mes Sanxhakut serb dhe Sanxhakut malazez etj.);
- Institucionet fetare islame shënojnë zhvillim të shpejtë të infrastrukturës së tyre (hapka e institucioneve sekondare dhe të larta arsimore, rritja e numrit të objekteve fetare etj.) dhe aktivitetet e tyre (shkuarja në haxhillëk dhe tubimet masive, arsimimi fetar në shkollat në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Serbi etj.). Njëkohësisht, monopoli i tyre për jetën fetare është sjellë në pikëpyetje me paraqitjen e aktorëve të ri (organizatat rinore, predikuesit për përhapjen e neosalafizmit, vëllazëritë sufite dhe shoqatat neosufite etj.);
- Lidhjet e ndërthurura mes institucioneve fetare islame dhe partive të caktuara politike ose sektorët e aparatit shtetëror e sqarojnë, në disa raste, aftësinë e tyre për riinvestim në fushën publike (Bosnjë dhe Hercegovinë, Sanxhak). Në çdo rast, përpjekjet për instrumentalizimin politik të institucioneve fetare i kanë shkatërruar kryesisht ndarjet e tyre të brendshme (divergjenca doktrinale, konflikti i interesave, i gjeneratave ose personaliteteve etj.) dhe ndonjëherë kanë shkaktuar kriza të rrezikshme të brendshme (Maqedoni, Lugina e Preshevës).

- Në pesë deri dhjetë vitet e ardhshme, institucionet fetare islame të Ballkanit Perëndimor rrezikojnë të konfrontohen me sfidat e reja:
- Pluralizmin politik që aktualisht e përjeton popullata myslimane në Ballkanin Perëndimor (kalimi nga një parti hegjemoniste në më shumë parti konkurruese) duhet të ndiqet nga përpjekjet e përtërira të instrumentalizimit politik të institucioneve fetare islame. Atje ku këto institucione ende janë të dobëta (Maqedoni, Sanxhak), këto përpjekje mund të sjellin deri e kriza të hapura, të dhunshme, dhe ta lehtësojnë krijimin e aktorëve të tjerë fetar neoinstitucional. Atje ku këto institucione me anë të konsolidimit, mund të përfitojnë fragmentim të rritur dhe delegjitimim të elitave politike të transferohen në institucione nacionale në substitucion (Bosnjë dhe Hercegovinë) ose të nacionalizmit laik të elitave politike kundërshtojnë një të folur islamike-nacionaliste;
- Zhvillimi i shpejtë i institucioneve fetare islame, të cilës i bashkëngjitet edhe ardhja e tregut të punës së kuadrove të shumtë fetar, të arsimuar në vend ose jashtë, rrezikon t'i konfrontojë për shkak të problemeve financiare. Përtëritja e vakëfeve (*waqfs – fondacion fetar*), të nacionalizuara në vitin 1947, institucionet fetare përpiqen t'i gjejnë, pa dyshim, mjetet e reja financiare, ose tek institucionet publike (institucionet arsimore etj.) ose te populli dhe diaspora (xhami etj.). Një krizë e tillë financiare te institucionet fetare rrezikon ta forcojë varësinë e tyre nga financimi nga bota myslimane dhe të ndizen konflikte të brendshme, si dhe zhgënjimet te gjeneratat e reja të kuadrit fetar.

4.3. Krijimi i lëvizjes neosalafiste

Çështja e neosalafizmit të Ballkanit Perëndimor duhet të trajtohet ndryshe, sipas tipave të neosalafizmit, rajoneve dhe periudhave:

- Në Bosnjë dhe Hercegovinë përhapja e lëvizjes neosalafiste nga tipi i xhihadit është e lidhur me ardhjen e muxhahedinëve. Nga kjo lëvizje dalin shumë organizata rinore nga fundi i luftës, por ndikimi i tij stabilizohet në fillimit të vitit 2000 dhe procesi i diferencimit të brendshëm është në rrjedhë. Në vendet tjera të Ballkanit Perëndimor kjo lëvizje u paraqit më vonë nëpërmjet studentëve të cilët ktheheshin nga bota myslimane dhe nëpërmjet internet faqeve. Ndikimi i tij këtu është marginal dhe zhvillohet në mënyrë joformale;
- Është vërtetuar se ekziston lidhje mes lëvizjes neosalafiste të tipi të xhihadit dhe “Al-kaedës”. Në përgjithësi, kjo lëvizje e llogarit Ballkanin Perëndimor si bazë për veprim dhe vend për misione, prandaj ka kujdes të mos vije në kundërshtim me interesat perëndimore në rajon. Por, faktikisht kjo ishte përzier në një sërë atentatesh anti-kroate nga fundi i vitit 1990, disa përpjekje për atentate anti-perëndimore të cilat nuk patën sukses në Bosnjë dhe Hercegovinë ose në diasporë dhe të cilat llogariten si vepra të personaliteteve të izoluar;

- Nga fillimi i vitit 1990 mbështetja financiare e monarkive nga Gjiri Persik, përkthimet e autorëve neosalafist dhe kthimi i studentëve nga universitetet në botën myslimane, e sqarojnë ngritjen e neosalafizmit të tipit të devotshëm në kuadër të institucioneve fetare. Kjo solli deri te elaborimi i kompromiseve të reja doktrinar, siç e vërteton edhe evoluimi i pozitës së *reis-ul ulemasë* Mustafa Ceriq në Bosnjë e Hercegovinë, dhe në masë më të vogël, ndryshimet që ndodhën në kreun e institucioneve fetare islame në Kosovë dhe në Malin e Zi.
- Më në fund, vendosja e lëvizjes neosalafiste në Ballkanin Perëndimor do të ketë pasoja të mëdha në këtë rajon dhe më gjerë:
- Institucionet fetare islame në Ballkanin Perëndimor do të miratojnë, pa dyshim, qasje bukëvale të islamit, duke e kontestuar vlefshmërinë e zakoneve të caktuara popullore (duke i toleruar si shenjë e identitetit), duke i minimizuar specifikat e *madhhabit* hanefist (duke e riafirmuar njëkohësisht monopolin) dhe duke kërkuar përtëritje eventuale të statusit islam nga natyra fakultative (marrëveshje nga e drejta private). Këto evolucione doktrinar i shtohen dukurisë së shteteve ose entiteteve të kuazi-shteteve me shumicë myslimane dhe të rrallimit të gjendjeve të bashkëjetesës mes popullatës myslimane dhe jomyslimane, të cilat tërheqin ndryshime të thella dhe të qëndrueshme të islamit ballkanik, specifikat e të cilit nga fundi i shekullit 20 ishin rezultat i një shekulli e gjysmë të përvojës si pakicë dhe gjysmë shekulli të sekularizmit komunist;
- Në nivel evropian, dy çështje do të mbeten gjithnjë e më të rëndësishme. E para ka të bëjë me pjesëmarrjen e institucioneve fetare islame në rrjeta të ndryshme panevropiane – si duket nga ky moment *reis-ul ulemaja* nga Bosnja dhe Hercegovina, Mustafa Ceriq afrohet me lëvizjen e vëllazërive myslimane në Evropë, deri sa institucionet fetare në Kosovë dhe në Maqedoni rekomandojnë marrëdhënie me dijanetin turk. Çështja e dytë ka të bëjë me evoluimin fetar të diasporës myslimane me prejardhje ballkanike: ekzistimi në kuadër të tyre në rrjetet me inspirim neosalafist është dëshmuar kohëve të fundit se shumë personalitete janë arrestuar për shkak të involvimit të tyre në veprimtari terroriste, edhe pse, marrë në përgjithësi, kjo diasporë edhe më tej përfiton shumë qëndrime legale dhe diskrete dhe eventualisht do të luajë rol pozitiv në vendosjen e institucioneve të cilat e prezantojnë kultin mysliman.

Mes nacionalizmit laik dhe instrumentalizimit të institucioneve fetare islame

Bashkim Iseni¹

4 . Islami dhe politika në Kosovë

Nga viti 1980 Kosova pësoi valëvitje të mëdha politike. Qëllimi ynë është t'i analizojmë marrëdhëniet mes sferave politike dhe religjioze dhe ta studiojmë evolucionin e jetës fetare myslimane në këtë krahinë të pavarur të Republikës së Serbisë, e administruar nga ana e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (MKBK) nga viti 1999.

1.1. Evolucionet politike dhe religjioze në Kosovë 1990-1998

1.1.1. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe projekti i pavarësisë

Pas ndryshimeve kushtetuese në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) në vitin 1974, Kosova dhe Vojvodina fituan statusin e krahinave të pavarura në kuadër të Serbisë. Ky status i ri u jep autonomi të zgjeruar, që i përcakton krahinat si bashkësi socio-politike të cilat i gëzojnë të drejtat e njëjta kushtetuese si edhe gjashtë republikat të cilat e përbënin Jugosllavinë.

Çështja për statusin e krahinave të pavarura shërben si katalizator për protestat nacionaliste shqiptare në Kosovë në vitin 1981, do të thotë një vit pas vdekjes së Josip Broz Titos². Kërkesa kryesore e shqiptarëve të cilët protestonin bazoheshin në fitimin e Kosovës me status të republikës, në kuadër të federatës jugosllave. Ngjarjet që vijonin do ta shënojnë fillimin e paraqitjes së serishme të nacionalizmit në gjithë territorin e Jugosllavisë.

.....
1 Bashkim Iseni është studiues dhe këshilltar për Evropën Juglindore dhe mërgimtarët në Zvicër, me prejardhje nga ky rajon. Botimet e tij kryesore janë: *Çështja kombëtare në Evropën Juglindore. Gjeneza, paraqitja dhe zhvillimi i identitetit kombëtar shqiptar në Kosovë dhe në Maqedoni*, Bern, Peter Lang (do të dalë nga shtypi në janar të vitit 2008); *Organizatat humanitare me inspirim religjioz në Maqedoni*, The Program for the Study of International Organization(s) (PSIO), Institut de Hautes Etudes Internationales, Geneve, 2007; *Tranzicioni dhe strategjitë për privatizimin në Evropën Lindore. Studim i rastit Maqedonia*, Lozanë, Librat e IDHEAP, 1999

2 Për evolucionin historik në Kosovë, shih te Mishel Ru (1992), Noel Malkolm (1998).

Në vitin 1989 në mënyrë arbitrare është marrë pavarësia e Kosovës dhe Vojvodinës nga ana e regjimit të Sllobodan Millosheviqit. Të ballafaquar me këtë realitet të ri, elita intelektuale dhe politike shqiptare në Kosovë u organizua rreth Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). E themeluar po atë vit, kjo parti politike u pri nga ana e shkrimtarit Ibrahim Rugova. LDK ishte për rezistencë të dhunshme kundër regjimit të Millosheviqit. Pastaj LDK u larguan nga qëllimi për republikë në dobi të projektit për pavarësi të Kosovës. Në korrik të vitit 1991 parlamenti i Kosovës, i cili nuk u njoh nga Beogradi, shpalli pavarësi të Kosovës. Pas shpalljes së rezultatit zgjedhor, parlamenti i njëjtë e zgjodhi shkrimtarin Ibrahim Rugova në funksionin kryetar të Kosovës dhe e emëroi Bujar Bukoshin për kryeministër. Elita politike shqiptare u angazhua për formimin e vërtetë të shoqërisë paralele në Kosovë dhe organizoi rezistencë pa dhunë kundër dominimit të regjimit të Beogradit. Popullata shqiptare në Kosovë besnikërisht e ndjek opsionin e rezistencës për të cilën angazhohej kreu politik shqiptar, edhe pse të ballafaquar me represionin sistemor të zbatuar nga aparati ushtarako-policor serb. Kjo politikë e represionit rezultoi me largimin masiv nga puna, mosrespektimin e të drejtave të njeriut, dënime arbitrare me burg, trajtim të keq, vrasje etj.³

Ibrahim Rugova udhëheq politikë pro perëndimore, duke kërkuar disa herë mbështetjen e Vatikanit.⁴ Ai vazhdimisht e thekson përkritjen evropiane të kosovarëve dhe afërsinë e tyre historike me botën perëndimore, duke e theksuar dimensionin e krishterë të shqiptarëve. Paralelisht me këtë, ai e minimizon dimensionin islam ë kulturës shqiptare dhe në mënyrë sistematike e thekson kontributin e figurave historike të krishtere shqiptare, si Pjetër Bogdani, Skënderbeu ose Nëna Terezë.⁵ Veçantia e konceptit të tij të nacionalizmit shqiptar bazohet në kërkimin e legjitimitetit që mbështetet në prezencën katolike shqiptare, që i ka paraprirë invazioneve slovene dhe osmane n Kosovë.⁶

Kryeministri Bujar Bokoshi gjithashtu është shumë aktiv në planin diplomatik me përfaqësitë konsullore perëndimore. Bukoshi është prodhim i elitës politike kosovare me bindje ateiste dhe pro perëndimore. Në aktivitetet e tija të lobimit diplomatik, Bukoshi u tregua më pragmatik se sa kryetari Rugova. Kështu, bindja e tij ateiste nuk e ndaloi të kërkojë mbështetje politike në Turqi dhe në vendet arabe-myslimane në dobi të Kosovës. Për shembull, ai në vitin 1992 ka marrë pjesë në një tubim të Organizatës së Konferencës Islamike (OKI).

.....
3 Shih te mari Fransuaz Alen dhe Ksavier Galmish (1994), si dhe një sërë raportesh tjera të përpiluara nga organizata ndërkombëtare për mosrespektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë të përmendura te Muhamedin Kulashi (1999).

4 Fotografia e tij me papën Gjon Pali i Dytë në mënyrë simbolike e zbukuronte zyrën ku ai i priste vizitorët e jashtëm. Rugova mbante kontakte me Bashkësinë Sh. Egidio, e cila përpigjeq të ndërmjetësonte mes Ibrahim Rugovës dhe Sllobodan Millosheviqit. Për informata më të hollësishme për aktivitetet ndërmjetësuese të kësaj organizate joqeveritare katolike në botë, shih te <http://www.santedigio.org>.

5 Ibrahim Rugova mbante lidhje sipërfaqësore me popullatën religjioze islamike në Kosovë. Megjithatë, nën dominimin e regjimit të Millosheviqit, medreseja në Prishtinë ishte vendi për mbledhjet e Parlamentit dhe Qeverisë së Kosovës

6 Pas vdekjes së Ibrahim Rugovës në janar të vitit 2006 mediat lokale dhe perëndimore flisnin për kalimin e tij të mundshëm drejt katolicizmit.

1.1.2 Zhvillimi i jetës fetare myslimane në Kosovë

Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) gjithashtu i bashkëngjitet projektit të pavarësisë së Kosovës. Historiku i këtij institucioni është i lidhur ngushtë me historikun politik të Kosovës dhe të Jugosllavisë. Në vitin 1919 Kosova ka qenë e integruar në Mbretërinë e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve. Institucionet islame të Kosovës në atë kohë vareshin nga myftiu i Beogradit. Në vitin 1929 këto institucione janë vënë nën ingjerenat e Këshillit të ulemave të Shkupit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, myftinitë⁷ e Prishtinës dhe Prizrenit iu bashkëngjitën Bashkësisë Islame të Shqipërisë. Në vitin 1945 territori i Kosovës përsëri u integrua në kuadër të Jugosllavisë territori i Kosovës përsëri u integrua në kuadër të Jugosllavisë territori i Kosovës përsëri u integrua në kuadër të Jugosllavisë.

Nga viti 1948 deri më 1993 institucionet islame në Kosovë vepronin nën ingjerenat e Kryesisë Supreme⁸ të Bashkësisë Islame të Jugosllavisë me seli në Sarajevë.

Vendosja e sistemit shumë partiak në Jugosllavi në vitin 1990 solli ndryshime në kuadër të *Bashkësisë Islame*. Ajo u riorganizua, deri sa instancat islame ekzistuese në nivel të republikave fitonin kompetenca të reja deri atëherë të rezervuara për “Rijasetin” në Sarajevë. Prej atëherë ato kanë mundur të ndërtojnë lidhje me shtete e jashtme. Në këtë kontekst, institucionet islame në Kosovë shprehën vullnet për autonomi, pas çka shpërthen konflikti i hapur me myftiun në Beograd, i afërt me regjimin e Millosheviqit. Në tetor të vitit 1990 klerikët myslimanë në Kosovë kërkojnë që emri “Bashkësia Islame e Serbisë” të transformohet në “Bashkësia Islame e Kosovës, Serbisë dhe Vojvodinës”. Qëllimi politik i kësaj kërkesë ka qenë zhvendosja e qendrës së vendimit islam nga Sarajeva dhe nga Beogradi në Prishtinë. Kjo kthesë në të vërtetë llogaritet për hap përpara drejt lidhjes së klerikëve myslimane të Kosovës me projektin politik shqiptar për pavarësi.⁹ Dhe më shumë se kjo, ky vullnet politik e sqaron vendosmërinë e kuadrove islamike kosovare ta shohin fjalën “Kosovë”, e cila do të figurojë në emrin e ri të këtij institucioni.¹⁰ Institucionet islame në Kosovë sa shkon e më shumë fitojnë autonomi, e si rezultat i kësaj shpëputja e tyre nga *Bashkësia Islame* jugosllave dhe shpallja e pavarësisë në nëntor të vitit 1993.¹¹

Institucionet islame në Kosovë, para së gjithash, e dëshmojnë autonominë e vet nëpërmjet themelimit të Fakultetit për Studime Islame në Prishtinë në vitin 1992 dhe inaugurimi i

7 “Myftinia” është term shqiptar i cili e përcakton njësinë administrative ku myftiu e ushtron pushtetin e tij religjioz.

8 Nga viti 1990 deri në vitin 1993 Kryesia supreme e Bashkësisë Islame të Jugosllavisë e mbante emrin “Rijaset”.

9 Në janar të vitit 1991 Rijaseti solli Rezolutë për Kosovën, me të cilën dënohej ashpër politika diskriminuese e udhëhequr nga serbët ndaj shqiptarëve në Kosovë (*Koha*, 30 janar 1991). Artikulli është ribotuar te Rexhep BOJA 92003) fq.44-51

10 *Kosovarja*, nëntor 1990, artikulli është ribotuar te Rexhep BOJA (2003) fq.31-37

11 *Bashkësia Islame e Jugosllavisë* do të ndahet në pesë bashkësi të ndryshme islame: Bosnja dhe Hercegovina (duke përfshirë edhe Sanxhakun), Kosova, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi.

klasës së re në medresenë në Prizren. Më parë nuk ekzistonte institucion për arsim të lartë fetar në Kosovë. Në të vërtetë, pikërisht me krijimin e medresesë Alaudin në Prishtinë, në vitin 1962 u arsimuan kuadrot e para fetare. Në periudhën 1970-1980, besimtarët shqiptarë studionin fenë islame në Sarajevë, por edhe në Egjipt, Irak, Sudan dhe në Libi që të kthehen pastaj në Kosovë dhe të kontribuojnë në forcimin e institucioneve islame.

Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) përbëhet prej 24 këshillave rajonale. Krahas kësaj, në përbërjen e saj hyjnë edhe rajonet albanofone të Serbisë Jugore (Presheva, Bujanoci dhe Medvegja), si dhe diaspora kosovare nga Evropa Perëndimore. Ajo udhëheq me më shumë se 550 xhami dhe me më shumë se 500 kuadro fetar – imamë. Gjuha e cila përdoret në xhamitë dhe institucionet islame është gjuha shqipe. Bashkësitë të cilat nuk janë albanofone e përdorin gjuhën turke në xhamitë në Prizren dhe në Mamushë, dy rajonet ku jeton pakica turke.¹² Gjuha boshnjake përdoret në rajonin e Dragashit dhe Vitomiricës. Këto dy rajone gjenden jo larg Prizrenit dhe janë të banuara nga bashkësia mjaft e madhe e goranëve dhe boshnjakëve/myslimanëve.

Nën regjimin e Millosheviqit, BIK mbijeton duke i falënderuar kontributit në zeqatë, të dhëna që grumbullohen në fund të muajit Ramazan (sadaqat-ul-fitr), nga organizata e haxhit - (hajj – haxhillëk në Mekë) dhe nga donacione të tjera. Nga pavarësia e saj në vitin 1993 BIK ka zhvilluar marrëdhënie me institucionet islame të Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi¹³ dhe të Turqisë.¹⁴ Ajo ka mbajtur dhe vazhdon të ketë lidhje të ngushta me xhamitë e diasporës shqiptare në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat kontribuojnë mes dhënies së ndihmës financiare.

Rexhep Boja, myfti i Kosovës prej vitit 1990 deri më 2003, luajti rol qendror në pozitën politike të BIK.¹⁵ Nga ardhja në funksion, ai shprehu pikëpamje shumë të fuqishme patriotike. Ai e shpalli sloganin “Pa atdhe, nuk ka religjion”. Por, në raport të vështrimit për identitetin, ai e ve theks dimensionit kombëtar, e jo atij fetar: “pa marrë parasysh përkatësinë fetare, shqiptarët kanë pasur dhe ende kanë vetëdije të zhvilluar për përkatësinë kombëtare. Te shqiptarët identiteti kombëtar është parësor lidhur me atë fetar, i cili është sekondar”.¹⁶ Myftiu i afrohet gjithashtu edhe klerikëve katolik në Kosovë.

.....
12 Në verë të vitit 2006 Parlamenti i Kosovës e refuzoi projektin ligjin me të cilin lejohet përdorimi i gjuhës turke si gjuhë e dytë zyrtare në Prizren.

13 Sot ekziston mendimi për krijimin e unionit të bashkësive islame shqiptare, i cili do t'i bashkonte institucionet islamike të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

14 Trajnimi i imamëve dhe besimtarëve në Turqi daton nga viti 1990. Ndikimi i Drejtorisë për çështje fetare (Diyanet) nga Turqia ka rëndësi për rajonin e Prizrenit, ku zyrtarisht ka përfaqësuesin e vet. sa i përket lëvizjes neosalafiste të fetullashive, janë hapur tre kolegje private në Kosovë (Prizren dhe Prishtinë). Lidhur me këtë lëvizje dhe ndikimin e saj në botë, duhet të shihet kontributi i Anne Solberg, „The Gülen Schools: A Perfect Compromise or Compromising Perfectly?“, dokument i prezantuar në konferencën “Feja dhe shkolla: Problemi i pluralizmit në sferën publike” (Kotor, 22-24 prill 2005), shih te <http://kotor-network.info/papers/2005/Gulen.Solberg.pdf>.

15 Me prejardhje nga Peja, Rexhep Boja ka studiuar në Universitetin e Medinës. Në qershor të vitit 1996 është emëruar për dekan të Fakultetit për Studime Islame në Prishtinë.

16 Rexhep Boja 92003) fq.47

Të përfundojmë, që nga vetë fillimi, BIK është ndërlidhur me agjendën politike të politikës elite kosovare. Edhe pse udhëheqësia politike kosovare nuk ka pasur program politik me konotacion fetar, BIK është angazhuar në mënyrë aktive në dobi të kauzës kombëtare shqiptare të Kosovës.

1.2. Zhvillimi politik dhe fetar në Kosovë nga viti 1998

1.2.1. Fillimi i luftës dhe intervenimi i bashkësisë ndërkombëtare

Nga koha e Marrëveshjes së Dejtonit në vitin 1995 rejtingu i Ibrahim Rugovës bie seriozisht te opinionin publik kosovar. Edhe nga njëra anë kjo marrëveshje i vuri fundin luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, nga ana tjetër, si pasojë e të njëjtit e la anësh çështjen e Kosovës. Duke iu falënderuar kësaj marrëveshjeje, Slobodan Millosheviqi u paraqit si njeri i paqes, ndërsa në të njëjtën kohë situata në Kosovë bëhej shpërthyes dhe atje sundonte politika e aparthejdit. Kjo situatë e porsakrijuar kontribuoi për paraqitjen e pakënaqësisë më të madhe, që e la nën pikëpyetje strategjinë pa dhunë që deri atëherë e udhëhiqte lideri i Kosovës. Paraqiten mospajtime të fuqishme politike, bile edhe mes Rugovës dhe kryeministrit Bujar Bukoshi, i cili sa shkon më shumë është për kryengritje të armatosur në Kosovë.¹⁷

Ky status quo nuk do të zgjatë gjatë. Përpjekjet për ndërmjetësim të Bashkësisë San Exhidio nuk do të japin rezultat. Mundësia për konflikt të mundshëm ngadalë bëhet realitet. Në nëntor të vitit 1997 rriten treguesit të cilët paralajmërojnë se po duket rezistenca e armatosur. Rezistenca në të vërtetë nuk paraqet zgjidhje as të Rugovës, as të Bukoshit, por të disa lojtarëve të ri politik të cilët paraqiten në skenën kosovare: vitin e ardhshëm vijon lindja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e cila ndërmerr aksione guerile kundër forcave serbe të sigurisë dhe kundër shqiptarëve, për të cilët dyshohet se bashkëpunojnë me autoritetet serbe.

Udhëheqësia e UÇK është nga radhët e diasporës. Në të vërtetë, aktorët e saj kryesor janë aktivistë të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK), organizatë nacionaliste e inspiruar nga marksizmi/leninizmi, e cila vepron në mënyrë ilegale në diasporë dhe në Kosovë. Edhe këtu bëhet fjalë për aktorë politik ateistë. Asnjë element nuk referon në përmbajtje fetare, e as në afinitet fetar në platformën dhe programin politik të UÇK.¹⁸ Luftëtarët e UÇK janë kosovar lokal, por në atë marrin pjesë edhe një numër i vullnetarëve nga diaspora kosovare, po edhe më gjerë nga diaspora shqiptare. Disa nga luftëtarët kanë luftuar nga ana e forcave kroate dhe myslimane/boshnjake gjatë luftërave në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë. Gjatë luftës në Kosovë, imamët gjithashtu kanë qenë të angazhuar në kuadër të UÇK, si dhe në mjediset fetare islame në Kosovë, ku në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në dhënien e ndihmës humanitare për popullatën civile.¹⁹ Ekzistojnë të dhëna të cilat

17 Si artar nga Kosova, Bujar Bukoshi ka pasur ndikim të madh mbi Ibrahim Rugovën. Ai gjithashtu ka qenë i angazhuar për krijimin e forcave të armatosura nga Shqipëria në Republikën e Kosovës (FARK).

18 Për pikëpamjet e organizatës, shih te: Patrick Denaud dhe Valerie Pras (1999); James Pettifier (2005).

19 Më shumë se 30 imamë dhe studentë nga medreseja dhe nga Fakulteti për Studime Islamike

flasin se muxhahedinët kanë kërkuar leje për inkuadrim në UÇK dhe për të luftuar në zonën operative perëndimore të Kosovës, por UÇK ka refuzuar t'i inkuadrojë.²⁰

Përgjigja e qeverisë serbe kundër shtimit të gueriles shqiptare ka qenë energjike, me çka Kosova së shpejti vihet në gjendje lufte. T'i përmendim konfliktet e armatosura me përmasa të mëdha, qindra mijëra shqiptarë t shpërngulur në brendi të Kosovës, vrasje të civilëve, shkatërrimi i shtëpive nëpër fshatra. Përkundër këtij keqësimi të situatës në Kosovë, Bashkësia ndërkombëtare së shpejti u mobilizua me qëllim që të gjejë zgjidhje për këtë konflikt. Në Rambuje (Francë) u organizua konferenca, në të cilën u takuan aktorët kryesor shqiptar (përfaqësues të UÇK dhe të forcave politike shqiptare në Kosovë) dhe delegacioni serb. Këto përpjekje patën mospasje. Forcat perëndimore ndërmorën aksione luftarake, qëllimi i të cilave ishte rënia e pushtetit të Millosheviqit. Aksionet u realizuan me bombardime të aviacionit kundër caqeve ushtarake dhe civile serbe në Serbi dhe në Kosovë. Gjatë bombardimeve, në Kosovë zhvillohej luftë e ashpër me pasoja dramatike lidhur me viktimat njerëzore.²¹

Pas bombardimeve disa javore, qeveria serbe lëshoi pe, duke e tërhequr tërësisht ushtrinë dhe policinë serbe nga territori kosovar. Paralelisht me tërheqjen, në Kosovë u vendosën pjesëtarë të shumtë të forcave ushtarake ndërkombëtare nën udhëheqësin e NATO-s (KFOR) dhe misionit civil ndërkombëtar, nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara (UNMIK), në kuadër të mandatit të dhënë me Rezolutën 1244, nga ana e Këshillit të Sigurimit. Njëkohësisht dhjetëra mijë serbë dhe romë e braktisën Kosovën, nga frika prej represionit shqiptar. Popullata serbe lëvizte drejt veriut (Serbi) ku një pjesë prej tyre u vendos në enklavat serbe në brendi dhe në veri të territorit kosovar (Mitrovicë). Numri më i madh i popullatës romë iku në Maqedoni dhe në Serbi.

Në tetor të vitit 2000 nën patronazhin e OSBE-së, në Kosovë u organizuan zgjedhjet lokale. Si rezultat i zgjedhjeve, u formua Parlamenti i Kosovës, cili e zgjodhi Ibrahim Rugovën në funksionin kryetar i Kosovës, si dhe Qeverinë, të udhëhequr nga bajram Rexhepi (PDK).²² Në mars të vitit 2004 shpërthyen trazira të fuqishme në Kosovë. Bashkësia serbe dhe kisha ortodokse u bënë caqe të ekstremistëve shqiptarë.²³ Këto ngjarje dolën në opinion se në

ishin viktimat të luftës në Kosovë.

20 Informatë e marrë nga shumë dëshmi të aktorëve politik në Kosovë dhe Maqedoni.

21 Për këtë temë shih te: Organization for Security and Cooperation In Europe (1999).

22 LDK e fiton shumicën e 58% të votuesve, pas saj vijnë PDK (Partia Demokratike e Kosovës), formacion politik i dalë nga UÇK me 27,3% dhe AAK (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, gjithashtu e dalë nga UÇK) me 7,7%. Në nëntor të vitit 2001 u organizuan zgjedhjet parlamentare dhe LDK fitoi me 45,6% të votave, PDK 25,7%, ndërsa AAK 7,8%. Partia politike serbe "Koalicioni për kthim" fitoi 11% të votave. Në zgjedhjet lokale në vitin 2002 LDK fitoi me 44,6% të votave, PDK 29,6%, ndërsa AAK 8,8%. Bashkësitë etnike fituan 2,2% (këto zgjedhje u bojkotuan nga ana e bashkësisë serbe në Kosovë). Në fund, në zgjedhjet e fundit parlamentare në tetor të 2004 LDK fitoi me 45,4% të votave, PDK 28,9% të votave, AAK me 8,4% dhe partia e re ORA me 6,2% (partia qytetare e themeluar nga pronari i media grupit "Koha", veton Surroi). Më shumë se 10% të vendeve në parlament u rezervuan për bashkësinë serbe të Kosovës, e cila i bojkotoi edhe këto zgjedhje.

23 Për të parë detajisht shkaqet dhe kronologjinë e trazirave, shih te: International Crisis Group (2004).

Kosovë ekziston tendencë e fuqishme, ku ekstremizmi dhe feja paraqesin dy terme shumë pak të kushtëzuara njëra nga tjetra. Në të vërtetë, djegia e objekteve fetare ortodokse nuk i përgjigjen logjikës së urrejtjes fetare, por më shumë në kuadër të urrejtjes nacionaliste-etnike, pasi që kishat ortodokse ndërlidhen me serbët. Kjo në të vërtetë e sqaron faktin se objektet katolike dhe protestante (lidhur me prejardhjen e shqiptarëve) nuk kanë qenë cak, e as nuk janë dëmtuar nga demonstruesit shqiptarë.

Ngjarjet e mëparshme historike treguan se islami ka luajtur rol minimal në Kosovë. Këtë situatë të njëjtë e hasim edhe në nivelin politik. Sot, përveç një partie të vogël politike, Partia e Drejtësisë, në territorin e Kosovës nuk është identifikuar formacion tjetër politik shqiptar me orientim fetar, qoftë në nivel të programit politik, ose në aksione konkrete. Islami, e veçanërisht BIK, edhe më tej vazhdojnë të jenë në pozitë të marginalizuar përkundër elitës politike dhe intelektuale në Kosovë.²⁴

Nëse elita kosovare edhe më tej shpreh respekt të vogël lidhur me çështjen e islamit, ose bëhet jotolerante ndaj të njëjtës, duhet të shihet zhvillimi i jetës fetare myslimane, si dhe marrëdhëniet e popullatës me islamin në periudhën e vënies së Kosovës nën mbrojtje ndërkombëtare në vitin 1999.

1.2.2. Zhvillimi i jetës fetare myslimane në Kosovë nga viti 1999

Pas përfundimit të luftës, vërejmë ndryshime në planin fetar në Kosovë. Lëvizja neosalafiste është e pranishme në mënyrë aktive në shumë qytete dhe fshatra të Kosovës. Paralelisht me këtë, mund të konstatohet përtëritja fetare te popullata, e cila sqarohet me nevojën nga dialogu për rekonfiguracion të lidhjes mes identitetit kombëtar dhe fetar.

a) Paraqitja e rrymave neosalafiste

Pas përfundimit të luftës, në Kosovë u paraqitën aktorë të ri fetar islam. Bëhet fjalë për dukuri në xhami dhe qendra të caktuara islame për predikim dhe besimtarë pjesëtarë të lëvizjes neosalafiste. Ithtar të kësaj lëvizjeje e marrin epitetin “vehabistë”, të cilin ua dhanë mediumet lokale. Dukuria e tyre është e pazakonshme për rajonin dhe karakterizohet me mjekra të gjata ose pantallona tre çerek. Gjithashtu ata dallohen edhe sipas mënyrës së praktikizmit të lutjeve, të cilat kryhen sipas ritualeve të ndryshme nga ato të zakonshmet të besimtarëve tradicional. Përveç kësaj, fitojnë sjellje të vetmitarëve, funksionojnë në rreth të mbyllur dhe veçanërisht solidarizohen mes vete.

Karakteristikë që habit për ata është fakti se këta aktorë mbajnë fjalime ku predikojnë praktikizmin e islamit jotolerant. Këto fjalime janë pak të pazakonshme për rajonin, pasi që predikojnë praktikizmin e rreptë të një islami, i cili është pastruar nga tradita lokale. Këta aktorë fetar i takojnë kategorisë *neosalafistë të tipit të devotshëm* të cilët i përshkruam në hyrjen e tekstit. Ata përhapin version të shtrembëruar për shoqërinë dhe nxisin kuptimin të fjalëpërfjalshme të Kuranit. Rajoni dhe qytetet në Kosovë të cilat janë më së shumti të përfshira me këtë fenomen janë Mitrovica dhe Prizreni, por gjithashtu edhe Vuçitërna, Prishtina, Gjilani dhe Kaçaniku.

.....

24 Për këtë temë, shih te Bashkim Iseni (2005).

Për shumicën e vëzhguesve dhe aktorëve politik në Kosovë, paraqitja e kësaj lëvizjeje sqarohet me vendosjen e organizatave bamirëse në Kosovë nga vendet e Gjirit. Numri më i madh i organizatave joqeveritare islame arritën të vendosen në rajonet e Kosovës pas përfundimit të Luftës. Në këtë periudhë pas lufte u ndërmorën projekte për meremetim nga ana e agjencive të Kombeve të Bashkuara, qeverive të vendeve perëndimore dhe organizatave joqeveritare me qëllim që t'u përgjigjen situatave emergjente të shkaktuara nga lufta në Kosovë. Por, nevojat për ndihmë ishin të mëdha, duke u mundësuar në këtë mënyrë organizatave joqeveritare islame, nëpërmjet aksioneve humanitare të vendosen në Kosovë. Të përkujtojmë se lufta në Kosovë shkaktoi viktima të shumta njerëzore, shkeljen e të drejtave të njeriut, si dhe dëme të mëdha materiale.²⁵

Aktivitetet e këtyre organizatave joqeveritare islamike në Kosovë janë të shumta: “rekonstruktion” të një numri të caktuar prej 218 xhamive që ishin shkatërruar ose dëmtuar gjatë luftës²⁶, rekonstrukcioni i shtëpive dhe objekteve tjera nëpër fshatra, ndihma humanitare, kurset për gjuhë dhe informatika. Në të vërtetë, organizatat joqeveritare islamike financin përkthimin, shtypin dhe distribuimin e veprave të autorëve të afërt me neosalafizmin dhe besnikërisht i përkushtohen dhënies së ndihmës financiare.

Në vitin 2003 Rexhep Boja i kritikoi aktivitetet e organizatave joqeveritare islamike në Kosovë: “Këtu erdhën njerëz të cilët dëshirojnë të na tregojnë se si të punojmë. Ne jemi myslimanë tashmë 600 vite dhe nuk ka nevojë dikush të na tregojë se çfarë do të thotë islami. Ne këtu kemi historinë dhe traditën tonë, kulturën tonë islame dhe arkitekturën. Dëshirojmë ta përtërimë bashkësinë tonë dhe xhamitë tona, por dëshirojmë këtë ta bëjmë në mënyrën tonë”.²⁷

Ky qëndrim i shprehur publikisht, qartë e shpreh refuzimin për predikimin e islamit të ndryshëm nga ai i *madhabit* hanefist (shkolla juridike). Në të vërtetë, përkatësia e madhabit hanefist është regjistruar në Kushtetutën e BIK.²⁸

Qëndrimi i shprehur publikisht nga ana e myftiut të Kosovës e reflekton edhe frikën se jeta religjioze i ka ikur kontrollit nga BIK. Prandaj është e nevojshme të kuptojmë pse BIK ka vendosur t'i ndalojë këto organizata të mbajnë orë për mësimin fetar.²⁹

.....

25 Për temën pasojat njerëzore dhe materiale nga lufta në Kosovë, shih te: Organization for Security and Co-operation in Europe (1999).

26 Në emër të politikës së “restaurimit”, xhamitë osmane tradicionale (të zbkuruara me freska) janë shkatërruar nga ana e disa organizatave joqeveritare islamike në Kosovë. Në Gjakovë këto veprime kanë shkaktuar kundërshtime të fuqishme te popullata. Për këtë temë shini te: International Crisis Group. (2001 b).

27 Stephen Schwartz (2002.).

28 Me nenin 2 të Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Kosovës vërtetohet se “Bashkësia Islame e Kosovës punon në bazë të mësuarit të Kuranit, Syneetit, sipas rregullave të dalura nga shkolla juridike hanfite, të kushtetutës ekzistuese dhe në pajtim me ligjin”. Shihni te: Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë; Kushtetuta e bashkësisë islame (2002) fq.6

29 Edhe krahas ndalesave, këto organizata joqeveritare islamike vazhdojnë të ligjërojnë mësim fetar në kuadër të shkollave të ku mësohet Kurani, të cilat i kanë themeluar në Kosovë.

Njëkohësisht të përmendim se brengosja shprehur nga ana e Rexhep Bojës pastaj do të nuancohet nga ana e myftiut të ri të Kosovës, Naim Tërnavës.³⁰ Ai e relativizon peshën e lëvizjes së re në Kosovë dhe thotë se asnjë besimtar që i takon këtyre tendencave islamike nuk është i përzier në BIK.³¹

Myftiu e theksoi rolin që e ka luajtur BIK dhe bashkësitë tjera islame nga rajoni për ruajtjen e islamit “autokton” përkundër të gjitha “indoktrinimeve” që kanë prejardhje nga Lindja, por edhe nga Perëndimi. Sipas tij, qëndrimet e njëjta kritike duhet të merren në raport me organizatat joqeveritare perëndimore me bazë fetare të cilat janë prezent në Kosovë. Ato kanë për qëllim t’i konvertojnë myslimanët e Kosovës në të krishterë.³² Për çdo rast, disa kryetar fetar në Kosovë mendojnë se një pjesë nga jeta fetare myslimane i ka ikur kontrollit të BIK. Disa imamë predikojnë fjalime me ton fundamental, duke shprehur bindje të cilat i bëjnë të ndryshëm në thelb nga qëndrimet zyrtare të BIK.

Sipas një vëzhguesi, çështjet fetare për Kosovën, dukuria dhe forcimi i shpejt i neosalafizmit lidhen me kthimin e studentëve kosovar të trajnuar në universitetet saudite. Sipas tij, këta studentë kanë qenë të financuar nga organizatat joqeveritare islamike saudite të pranishme në Kosovë.

Pasi që të bëhen imam dhe teolog, këta studentë promovojnë të lexuarit puritan të islamit, duke e forcuar rrjetën e trajnimeve të dedikuara për studentët e ri kosovar të cilët do të studiojnë në Universitetin e Medinës. Më tej, studentët e ri rekrutohen nga ana e neosalafistëve lokal.³³ Lidhur me numrin e studentëve të trajnuar jashtë kanaleve institucionale të BIK ka mendime të ndryshme.³⁴

Në këtë mënyrë organizatat joqeveritare islamike bëhen platforma, me ndërmjetësimin e të cilëve ndikimi religjioz saudit hyn në Kosovë. Analisti Isa Blumi e kritikon bashkësinë ndërkombëtare për shkak të tolerancës së vendosjes së pakontrolluar të organizatave joqeveritare islamike në Kosovë. Sipas tij, bashkësia ndërkombëtare është përgjegjësi më i madh për këtë situatë. Blumi mendon se kjo situatë në të vërtetë i përgjigjet bashkësisë ndërkombëtare, pasi që vetëm organizatat joqeveritare islamike i janë përgjigjur kërkesave për ndihmë materiale ndaj popullatës fshatare, që UNMIKU nuk ua ka dhënë.³⁵

.....
30 Naim TËRNAVA e ndjek Rexhep Bojën në vitin 2003. Ai është edhe zëvendës-kryetar i Këshillit Islam Euroaziatik të mbështetur nga Dijaneti (Diyanet). Rexhep Boja nuk kandidohet përsëri për myfti, pasi që Kushtetuta e BI parasheh vetëm dy mandate për këtë funksion. Rexhep Boja, me përjashtim, ka pasur tre mandate nga viti 1993-2003, për shkak të gjendjes së luftës në Kosovë.

31 Bisedë në Prishtinë në nëntor 2006.

32 Fakti, 17 korrik 2006. Për temën proselitizmi në Kosovë, shih te: Suzana Bytiqi (2006).

33 Sipas një profesori të Fakultetit për studime islamike në Prishtinë, nxënësit që kanë studiuar në medresenë në Prishtinë nuk janë pranuar në Universitetin e Medinës. Në të vërtetë, janë pranuar vetë ata nxënës që kanë mbaruar shkollë të mesme shtetërore. Sipas tij, bëhet fjalë për strategji të rekrutimit, qëllimi i të cilëve është larja e trurit dhe indoktrinimi i të rinjve, pa arsimit të mëprashëm teologjik.

34 Numri i këtyre studentëve është mes 30 dhe 40. BIK nuk e kontrollon dhënien e bursave për në Arabinë Saudite. Ajo nga ana e saj jep bursa për studime dhe qëndrim në Turqi, Egjipt, Libi, Malezi dhe Jemen (bursa të financuara nga vendet nikoqire).

35 Isa Blumi (2003). Pikëpamje vërtetuar nga politikan me ndikim në Kosovë.

Shumicës së besimtarëve të Kosovës këto dukuri të reja në islam u pengojnë, ndërsa është vërejtur edhe averzion i madh ndaj të njëjtave.³⁶ Neosalafistët janë llogaritur për trup të huaj që paraqet kërcënim për traditën dhe zakonet e shoqërisë kosovare.³⁷ Këto aktorë janë akoma të paktë në shoqërinë kosovare që edhe më tej është shumë laike. Megjithatë, vërehet anim i besimtarëve të rinj që u afrohen këtyre predikuesve të ri. Kjo është shenjë se paraqitet hendek i caktuar mes gjeneratave në kuadër të bashkësisë fetare në Kosovë.

Në Kosovë kjo lëvizje është e krahasueshme me sektet. Kjo është si “peshku në akua-rium”, na deklaroi një studiues kosovar. Sipas tij, kjo lëvizje mund të ndikojë vetëm në një pjesë të popullatës. Pjesëtarët e rinj të shtresave të varfra janë të disponuar për pranimin e këtyre predikimeve, por njëkohësisht vazhdojnë të kenë mënyrë pro perëndimore të jetës. Sipas këtij studiuesi, “fundamentalistët në Kosovë nuk mund të krijojnë elitë”. Këta janë të ashtuquajturit intelektualë të cilët luajnë rolin e avokatit të dimensionit islam në shoqërinë e Kosovës. Elita ndjek rrugë të tjera. Në të vërtetë, intelektualët kosovar të cilët e mbrojnë dimensionin islam të shoqërisë kosovare, janë të paktë.

Gjithashtu duhet të përmendet fakti se ndjenjat pro perëndimore dhe pro amerikane bëhen më të fuqishme në Kosovë. Gjatë sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 në Nju Jork, kosovarët u solidarizuan me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Disa kosovarë bile edhe demonstruan në Prishtinë në dobi të intervenimit amerikan në Irak.

b) Përtëritja fetare dhe debati rreth identitetit kombëtar

Edhe pse lëvizja e neosalafistëve është minore në Kosovë, megjithatë vërehet rritje e se-rishme e interesimit për fenë. Ky kthim ndaj fesë sqarohet mes shkuarjes së shpeshtë të rinjve në xhami, agjërimi tek të rinjtë gjatë muajit të Ramazanit, distribuimi masive i publikimeve dhe emetimi i emisioneve për islamin në kanalet e televizionit dhe radios, ose mes organizimit të tribunave të ndryshme të cilat trajtojnë tema fetare. Sipas myftiut të Kosovës, të flitet për reislamizimin nuk ka kuptim, pasi që “Kosova ka qenë myslimane dhe është e natyrshme që njerëzit të orientohen drejt religjionit të tyre pas pesëdhjetë vjet komunizëm”. Analisti kosovar Blerim Latifi vëren “zgjim” te popullata e Kosovës si pasojë e islamit. Ai këtë fenomen e sqaron nëpërmjet mungesës së perspektivës për të rinjtë dhe nëpërmjet krizës së thellë socio-ekonomike kundër së cilës duhet të luftojë shoqëria kosovare. Sipas tij, religjioni për këta të rinj paraqet mekanizëm psikologjik si ngushëllim dhe e ushqen shpirtin.³⁸ Politikologu Shkëlzen Maliqi thotë se konflikti me Serbinë e ka forcuar ndjenjën fetare te kosovarët. Ai thotë se trashëgimia komuniste është e lidhur me popullatën me trashëgiminë e dominimit serb të cilit duhet t’i kundërvihen, e prej atje është edhe kjo ndjenjë religjioze e cila deklarohet si antikomuniste dhe antiserbe.³⁹ Për çdo rast, ky zgjim i serishëm i interesimit sqarohet me politikës për riinvestim në sferën

.....
36 **Da** shihet për shembull qëndrimi i imamit shqiptar për këtë temë: Zeqirja Idrizi: “Kujdes: ve-habistët e kalojnë tokën tonë”, shkrim që mund të gjendet në faqen e internetit <http://www.lajmet.com>. Nga 14 tetori 2005 mund të gjendet edhe në: <http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=63098&page=4>.

37 I quajnë “mjekrrat”, ose “tre çerek”.

38 Pjesëmarrje në emisionin e Radiotelevizionit të Kosovës “Jta në Kosovë”, 8 dhjetor 2006.

39 Bisedë në Prishtinë në nëntor të vitit 2006.

publike nga ana e kuadrove fetare nga Kosova dhe nga organizatat joqeveritare islamike të huaja, të cilat janë shumë aktive në planin lokal. Por, përsëri të theksojmë se nuk mund të flitet për islamizim të serishëm në Kosovë, duke pasur parasysh se kjo shoqëri edhe më tej mbetet shumë laike.

U paraqitën polemika në Kosovë, si dhe në rrethet shqiptare, për atë se cili është roli i religjionit mysliman në historinë shqiptare. Këto debate, të publikuara në javoren *Java* dhe revistën periodike *Gazeta besa*, i ndërroi zërat e atyre që kërkojnë rehabilitimin e rolit të islamit në historinë kombëtare shqiptare.⁴⁰ Autorët e këtyre teksteve kërkonin që të merret parasysh roli i personaliteteve myslimane në librat shkollor nga lënda e historisë. Ata e mohojnë embargon kundër islamit që sipas tyre d të vihet nga ana e elitës kosovare në sferën publike në Kosovë. Autorët e njëjtë deklarohen kundër jotolerancës së shtuar ndaj grave të mbuluara në administratën publike dhe në Universitetin e Prishtinës.

Në gjithë këtë luftë të kundërtënëve, i shtohen edhe reagimet kundër iniciativës për ndërtimin e kishave katolike dhe protestante në disa fshatra të Kosovës.⁴¹ Sipas këtyre aktorëve, ku numërohen edhe pjesëtarë të BIK, nuk mund të ndërtohen kisha në fshatrat ku nuk ka asnjë të krishterë. Ata thonë se bëhet fjalë për iniciativa me nënvetëdije të madhe. Polemika e njëjtë u paraqit lidhur me iniciativën për ndërtimin e kishës katolike në Prishtinë. Ndrëtimi i një objekti të tillë katolik në kryeqytet u kritikua ashpër nga ana e mjdesit fetar islam. Sipas tyre, e papranueshme është mundësia që të ngritet katedrale katolike atje ku ka vetëm një grusht katolikë, të cilët janë banorë të Prishtinës, e nga ana tjetër autoritetet lokale ta mohojnë projektin për ndërtim të qendrës islamike.⁴² Myftiu Naim Trnava me këtë rast ka deklaruar: “Unë them se ka vend për t gjithë në Prishtinë. Ka vend për Nënë Terezën, për Skënderbeun, për katedralen, siç është dashur të ketë edhe për qendrën islamike, që do të ndërtohet përballë katedrales dhe kishës serbe. Do të ishte mirë, në kuadër të mundësive, këto objekte të jenë më larg universitetit”.⁴³ Kjo çështje për rolin e islamit në kulturën shqiptare ishte qendra e diskutimeve të rrepta intelektuale në vitin 2006 mes shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare dhe shkrimtarit kosovar Rexhep Qosja.⁴⁴

40 Të shihen gjithsesi debatet publike në revistën “Java” dhe publikimet e botuara nga 9 qershori, 21 qershori, 23 qershori dhe 21 korriku të vitit 2005 në <http://www.gazetajava.com> dhe numrin e parë të *Gezat besa* nga 5 tetori 2005 në <http://www.gazetabesa.com>.

41 Myftiu i Kosovës, për shembull fuqishëm e kundërshtoi projektin për ndërtimin e kishës katolike në fshatin Kuçishtë (rajoni i Rugovës). Për Nexhmedin Oxhën, kryetar i bashkësisë islame në Pejë, bëhej fjalë për “kishë politike” pasi që ajo do të ndërtohej në vendin ku nuk ka asnjë katolik (Lajm 21 korrik 2005).

42 Salla për lutje e hapur pranë Universitetit të Prishtinës pas luftës u mbyll nga ana e drejtorit të këtij institucioni. Kështu, ai ka shkaktuar protesta në radhët e myslimanëve të cilët edhe më tej shkonin të luten jashtë bibliotekës. Në tetor 2006 kishte sulm të armatosur nga ana e policisë në xhaminë në Gjilan. Qëllimi i sulmit ishte që besimtarët të cilët nuk e respektonin ndalesën të sjellë nga ana e kryetarit të komuns për vizitë xhamisë, të ndërtuar pa lejen komunale. Këshilli i bashkësisë islame të Gjilanit reagoi ashpër ndaj intervenimit të këtyre (kumtesa për shtyp e Këshillit të bashkësisë islame të Gjilanit, nr.185/06, 19 tetor 2006).

43 Java, 30 tetor 2003. Në vitin 2006 kryetari i rendit botëror të bektashinjve, Haxhi Dede Reshat Bardhi dhe 32 intelektualë me ndikim nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia kanë shkruar letër të hapur në dobi të ndërtimit të katedralës katolike Nëna Terezë në Prishtinë. Sipas tyre, kjo katedralë do të bëhet simbol i pjekurisë etatiste në Kosovë.

44 Ismail Kadare paraqet shkrimtarin më të madh bashkëkohor shqiptar. Ai është përkthyer në më

Kjo përtëritje fetare dhe debatet e paradokshme rreth vendit të islamit në shoqërinë kosovare/shqiptare vendosen në ndryshimet socio-politike që ndodhën në Kosovë pas vitit 1999. Por, edhe krahas të gjithave, këtyre pikëpamjeve nuk do t'i ndërrojnë hierarkitë identike predominante në shoqërinë kosovare. Me fjalë të tjera, ndjenja kombëtare është veçanërisht e fuqishme në Kosovë dhe ndjenja fetare nuk mund ta zë vendin e tij. Te popullata ndjenja e përkatësisë në Evropë është shumë e fuqishme.

Mashttrimet e kosovarëve të rinj, përkundër situatës së vështirë politike dhe ekonomike në Kosovë vazhdojnë të shprehen politikisht nëpërmjet aktiviteteve me karakter nacionalist, e jo fetar.⁴⁵ Por, ndryshimet e dukshme të mundshme në planin fetar te popullata mund të ndikojnë te elita politike dhe intelektuale dhe të sjellin ndryshime të mendimit për identitetin kombëtar të Kosovës me imponimin e serishëm të religjionit mysliman në historinë e Kosovës. Dimensioi kulturor mysliman është lënë anash në historinë zyrtare të Kosovës, pasi që ideologjia kombëtar shqiptare e Kosovës ka qenë veçanërisht e theksuar në një fjalim antiserb dhe antiosman.

1.3. Përfundim

Në rezymenë mund të pohojmë se klasa politike në Kosovë mbetet anësh religjionit dhe mjedisit fetar islam. Deri më tani, qoftë që është bërë fjalë për bindje ose oportunizëm, nuk vërenim kurrfarë instrumentalizimi ose përdorim të islamit ose institucioneve islame në dobi të strukturave politike të Kosovës. Asnjë aktor politik në Kosovë nuk ka marrë pjesë në polemikat e nivelit më të lartë. Të vërejmë se feja myslimane të cilës i takon shumica e popullatës së Kosovës përjetohet si handicap nga ana e elitës politike dhe intelektuale kosovare, pasi që ajo do të mund të paraqesë ngarkesë politike në procesin e pranimi të statusit të Kosovës si kërcënim i ardhshëm “xhihad” për Evropën.⁴⁶ Kjo pa dyshim e sqaron interesimin e dobët të klasës politike të Kosovës që ta pranojë rolin e religjionit në shoqëri. Refuzimi i autoriteteve kosovare që të lejojnë arsimim fetar në shkollat publike duhet të kuptohet në kontekstin e njëjtë. Më së fundi, mosekzistimi i lidhjeve mes paraardhësve kosovar dhe botës arape-myslimane⁴⁷ mund të sqarohet me frikën që të shihet lufta

shumë se 40 gjuhë botërore. Rexhep Qosja gjithashtu është një ndër kritikët më të shquar letar në Kosovo dhe në mjediset kulturore shqiptare. Është i njohur për shkak të pikëpamjeve të tij nacionaliste lidhur me çështjen kombëtare shqiptare. Lidhur me polemikën mes Kadare dhe Qosjes, shihni te Ismail Kadare: “Identiteti evropian i shqiptarëve”, Shekulli, 27 mars 2006. Rexhep Qosja “Vështrim kritik i pikëpamjeve të shkrimtarëve në librat e tyre” (Vështrim kritik i pikëpamjeve të shkrimtarit Ismail Kadare në veprën e tij “Identiteti evropian i shqiptarëve”, Shqyp ndryshe, 13 maj 2006

45 Shihni për shembull “Aktivitetet e ndryshme nacionaliste të organizatës Vetvendosje” dhe internet faqen e saj <http://www.vetvendosje.org>.

46 Në këtë temë, të shihen gjithashtu qëndrimet e një delegacioni të deputetëve serb në Parlamentin evropian në nëntor të vitit 2005.

47 Gjatë një tribune të organizuar në korrik të vitit 2004 në Shkup nga ana e Qendrës për Hulumtime dhe Dokumentacion Strategjik “Forum” në temën: “Religjioni a është faktor për ardhmërinë e Kosovës?”, Qemal Morina, dekan i Fakultetit për studime islame në Prishtinë, theksoi se vetëm dy delegacione nga vendet myslimane kanë qenë të regjistruara në Kosovë (Turqi dhe Malezi), se asnjë delegacion zartar nga këto vendet nuk e kavituar Kosovën dhe asnjë delegacion nga Kosova nuk i ka vizituar këto vende. Të theksojmë se kjo situatë do të mund të ndryshohet në rast

politike për statusin e Kosovës e njollosur si islamike.

Partia e Drejtësisë, e përmendur më lartë, e cila llogarit për një vend deputeti në Kuvendin e Kosovës, është përjashtim për skenën politike të Kosovës. Deputeti i saj i vetëm, Ferid Agani, refuzon ta identifikojë përkatësinë e vet politike me atë fetare.⁴⁸ Kjo parti politike tani për tani është e parëndësishme. Megjithatë, duke pasur parasysh profilin e saj të veçantë ideologjik, që ka për qëllim të bëjë bashkim mes identitetit kombëtar dhe fetar, si dhe vullneti i tij politik për modernizimin dhe hapjen ndaj botës perëndimore, do të mund ta rrisë ndikimin e tij në Kosovë në vitet që vijnë.

Në tetor të vitit 2006 u themelua Forumi Mysliman i Kosovës.⁴⁹ Themelues të këtij forumi janë aktorë të afërt të gazetës *Gazeta besa*.⁵⁰ Ata kanë për qëllim të promovojnë debat të ri për lidhjen mes identitetit kombëtar dhe fetar në Kosovë dhe ta sensibilizojnë mendimin publik kosovar lidhur me skenën politike të Lindjes së Mesme. Ata janë me profil islamik, por pesha e tyre politike është me të vërtetë marginale. Shumë pak i janë të njohura opinionit politik dhe atij medial në Kosovë. Sipas mendimit të një kuadri të lartë të BIK, ata nuk kanë ardhmëri në Kosovë. BIK është kundër çdo lloj lidhshmërie në bazë fetare, e cila do të mund ta sillte ndryshime fetare në kuadër të shoqërisë kosovare.

Sa i përket BIK, ky institucion si duket është i bashkuar dhe stabil në krahasim me interesat e kundërta të cilat sundojnë në institucionet tjera islamike në rajon (Maqedoni, Sanxhak). Ky stabilitet mundëson edhe paprekshmëria lidhur me ndikimet politike dhe përpjekjet e mundshme për instrumentalizimin e saj për qëllim politike. Aktiviteti politik i organeve religjioze është e ndaluar me Kushtetutën e BIK. Edhe krahas kësaj, ajo vazhdon ta afirmojë fuqishëm angazhimin e pakushtëzuar për pavarësi të Kosovës.⁵¹ Më në fund, te myftiu Trnava vërehet ndryshim thelbësor në tonin i cili është i ndryshëm nga toni i matur i paraardhësit të tij dhe roli i tij për islamin në Kosovë. Për shembull, BIK reagoi në mënyrë energjike kundër largimit të ligjëruesve të mbuluara në shkollat publike në Kosovë ose studentet e mbuluara në Universitetin e Prishtinës.

Pozita e BIK mund të forcohet me rritjen e religjiozitetit të popullata në Kosovë. Deri tani ky institucion ishte para së gjithash i magjinalizuar nga ana e klasës politike në Kosovë, qoftë në planin financiar, ose simbolikisht. Ndryshimet e dukshme në planin e “zgjimit fetar”

se vetoja ruse pranë Këshillit të Sigurimit të KB kundër rezolutës për statusin e Kosovës. Kërkesa për pranimin e pavarësisë së Kosovës do të bëhet nëpërmjet rrugëve diplomatike me çdo vnd në botë. Kjo do të thoshte se është e nevojshme lobim diplomatik të udhëheqësisë kosovare te vendet arape-myslimane që të përfitohet njohja nga ana e tyre.

48 Bisedë e bërë në Prishtinë në gusht të vitit 2005. Ferid Agani është psikiatër i njohur në Kosovë dhe një nga themeluesit e Partisë së Drejtësisë.

49 Organ për të cilin BIK nuk ka mendim të mirë, pasi që do të jetë në kundërshtim të plotë ndaj politizimit të religjionit në Kosovë. Rezolutë e tillë do të përgatitet.

50 Bëhet fjalë për Nexhat Ibraimi (kryetar i Bashkësisë Islame në Prizren), Halim Ibraimi, Zeqirja Ibraimi dhe Mexhit Iveysi. Shkrimet në këtë revistë periodike vazhdimisht janë të mbushura me mendimet e Abdi Baleta (komunist, bashkëpartiak) i Enver Hoxhës dhe promovues i vizioneve nacionaliste dhe tendencave islamike.

51 Të shihet gjithashtu deklarata e myftiut Naim Tërnavë me rastin e muajit të Ramazanit në vitin 2006 (Zëri, 23 tetor 2006).

mund ta tërheqin vëmendjen e klasës politike në Kosovë lidhur me këtë institucion. Nëse ky skenar realizohet, në atë rast klasa politike në Kosovë do të mund të shprehte interesim nëpërmjet oportunizmit të zgjedhur dhe të vendos marrëdhënie me kuadrot fetare islamike në Kosovë, qoftë në planin kombëtar, ose në atë lokal. Imamët me ndikim më të madh do të mund të mbeten aktorë të pashmangshëm në zhvillimin e politikës të Kosovës. Pasojat nga kjo do të ishin të paparashikuara për BIK, pasi që ai do të bëhet institucion i politizuar, i cili rrezikon të ballafaqohet me mospajtimet mes ithtarëve.

Më në fund, dukuria e neosalafizmit e shqetëson seriozisht opinionin e gjerë në Kosovë. Puna e kësaj lëvizjeje është e kufizuar tani për tani në indoktrinimin ideologjik (radikalizëm ideologjik) të besimtarëve të rinj. Duke u përqendruar te të rinjtë, këta animatorë kanë qëllim të qartë, e kjo është të mbeten përgjithmonë në Kosovë. Vëzhgues të ndryshëm, si aktorët politik dhe fetar në Kosovë, nuk e përjashtojnë mundësinë që t'i shohin të rinjtë kosovarë si ithtarë të kësaj lëvizjeje fundamentaliste si kryes të akteve terroriste.

2. Islami dhe politika në Maqedoni

Maqedonia e shpalli pavarësinë e saj në vitin 1991. Ajo është një ndër republikat e fundit e cila e braktisi federatën jugosllave. Ka rreth 2 milionë banorë, ku ka më shumë grupe etnike: maqedonas, shqiptarë, turq, romë, serbë, myslimanë/boshnjak/, torbesh (sllavofon) dhe pakica tjera. Rreth 65% E popullatës janë ortodoks (maqedonas, serb), deri sa rreth 30% janë myslimanë të cilët i përbëjnë shqiptarët, turqit, romët, boshnjakët dhe torbeshët. Bashkësia rimokatolike përfshin 1% të popullatës.⁵²

Me fitimin e pavarësisë, vendi u ballafaqua me kriza të mëdha, si në planin ndërkombëtar, ashtu edhe në atë të brendshëm. Në planin ndërkombëtar, për shumicën e shteteve fqinje, veçanërisht për Greqinë, Serbinë, Bullgarinë, çështja e identitetit kombëtar maqedonas dhe shtetëror paraqet problem të karakterit legjitim. Në planin e brendshëm, edhe krahas stabilitetit relativ dhe procesit të pavarësisë, të fituar në mënyrë paqësore, vendi kaloi nëpër një sërë trazirash të pandërprera ndëretnike dhe politike. Zhvillimi maqedonas në planin politik la pasoja për zhvillimin e jetës fetare myslimane në vend.

2.1. Zhvillimi politik dhe fetar në Maqedoni mes viteve 1990 dhe 2001

2.1.1. Pavarësi, kriza e pranimit dhe tensionet ndëretnike⁵³

Procesi i cili solli deri te pavarësia e Maqedonisë hasi në shumë pengesa. Konteksti politik rajonal e ngadalësoi seriozisht procesin e pranimit ndërkombëtar të vendit si shtet i pavarur.⁵⁴ Megjithatë, shpallja e pavarësisë duhet të shqyrtohet përsëri në kontekst të marrëdhënieve konfliktuale mes autoriteteve maqedonase, të prira nga maqedonasit (ortodoks) dhe bashkësisë së shqiptarëve (myslimanë) në vend.⁵⁵ Nga demonstratat në Kosovë në vitin 1981 shqiptarët nga Maqedonia janë ekspozuar diskriminimit politik dhe socio-kulturor. Në emër të luftës kundër “tendencave nacionaliste, irredentiste dhe kundërrivolucionare shqiptare”, qeveria maqedonase në vitin 1980 zbatoi embargo të vërtetë arsimore, si dhe largimin nga puna dhe arrestimet politike (të cilat karakterizohen me dënime burgu bile edhe më të rrepta se ato në Kosovë) kundër kësaj bashkësie.⁵⁶

.....
52 Pesë bashkësi fetare kanë status zyrtar të “bashkësive fetare” në Maqedoni. Kisha Ortodokse Maqedonase, Bashkësia Islame e Maqedonisë, Kisha Katolike, Bashkësia Hebraike dhe Kisha Ungjillore-Metodiste. Bashkësitë tjera fetare thjesht kanë statusin e “grupeve religjioze”, pasi që ligji nga viti 1997 njih vetëm një fe zyrtare. Shih nën: “Ligji për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze”, Gazeta zyrtare, nr.35 nga 23 korriku 1997 fq.1426-1429. Propozim projekti i ri për mësimin fetar në shkollat publike në moment gjendet në fazën e diskutimit.

53 Këto tema janë përpunuar te Bashkim Iseni (1996).

54 Maqedonia u pranua nga KB në vitin 1993 nën emrin Ish republika jugosllave e Maqedonisë (Former Yugoslav Republic of Macedonia – FYROM).

55 Sipas regjistrimit nga viti 2002 shqiptarët kanë përbërë 25,1% të popullatës. Sipas regjistrimit nga viti 1994 ky numër ishte 22,9%.

56 Mbyllja e shkollave të mesme në gjuhën shqipe, si dhe institucioni i vetëm i lartë arsimor për arsimimin e arsimtarëve shqiptarë në Shkup. Nga kjo pikëpamje, zvogëlimi i numrit të fëmijëve shqiptarë në shkollat e mesme në këtë periudhë është e madhe : nga 8.200 në vitin 1981 në

Paralelisht me mbylljen e shkollave publike në gjuhën shqipe, qeveria e inkurajoi arsimimin fetar të popullatës, duke lejuar hapjen e medresesë Isa beu në Këndovë në vitin 1984 (periferi e kryeqytetit të Shkupit). Kjo politikë agresive u plotësua në prill të vitit 1989 me miratimin e ndryshimeve në Kushtetutë, me të cilat popullata etnike jo maqedonase fiton statusin e pakicës. Atëherë, Republika e Maqedonisë u shpall për shtet kombëtar i popullit maqedonas. Ky përcaktim në thelb dallohet nga preambula e mëparshme kushtetuese, e cila e përcaktonte Maqedoninë si shtet të popullit maqedonas dhe kombësive shqiptare, turke, rome etj.⁵⁷ Këto masa të ndryshme etatiste-nacionaliste në Maqedoni numërohen në dëshirën për krijimin e shtetit unitar etnik maqedonas në hapësirën multi-etnike. Ky nacionalizëm shtetëror pa dyshim kontribuoi për nxitjen e nacionalizmit shqiptar në Maqedoni. Lufta e përhershme mes këtyre dy nacionalizmave solli deri në padurim ndëretnik e cila ekziston edhe sot.

Në një klimë të tillë të tendosur të mosbesimit ndëretnik diku në nëntor-dhjetor të vitit 1990 u organizuan zgjedhjet e para të lira dhe demokratike.⁵⁸ Referendumi për pavarësinë e vendit që u mbajt në shtator të vitit 1991 u bojkotua masovikisht nga ana e popullatës shqiptare, e cila nuk dëshironte ta pranojë statusin e pakicës e cila i ishte dhënë. Pak më vonë, më 11 dhe 12 janar 1992 në vendet e banuara me shqiptarë etnik u organizua referendumi i fshehtë për autonomi territoriale dhe kulturore të shqiptarëve në Maqedoni (e quajtur Ilirida). Shumica e madhe, 99% nga votuesit u deklaruan pro. Ky projekt nacionalist nuk pati përmbajtje religjioze dhe nuk u përmbajt nga institucionet islamike në Maqedoni. Një pjesë e përfaqësuesve politik shqiptarë gjithashtu ishin kundër kësaj ideje dhe vazhduan edhe më tej të marrin pjesë në punën e qeverisë.

Rritja e përfaqësimit të shqiptarëve në planin qendror (Parlament, Qeveri) nuk la gjurmë pozitive në planin e dialogut ndëretnik. Mungesa e ndryshimeve në planin politik, kulturor dhe ekonomik, edhe krahas kërkesave të shqiptarëve (qasje deri te institucionet sipërore në gjuhën shqipe, rritja e përfaqësimit të shqiptarëve në administratë, në polici dhe në armatë) solli deri te polarizimi në vetë bllokun shqiptar.⁵⁹ Kështu, pas mbajtjes së kongresit të partisë së parë shqiptare të porsaformuar, Partia për Prosperitet Demokratik (PPD), në shkurt të vitit 1994 u paraqit çudi, partia e dytë shqiptare: Partia për Prosperitet

vetëm 4.221 në vitin 1989. Kësaj politike diskriminuese i ndërlidhen edhe masat tjera të pazakonshme, si për shembull shembja e 6.000 mureve tradicionale të shtëpive të shqiptarëve, përgatitja e listave të zeza me emra në gjuhën shqipe të cilat nuk kanë mundur t'i jepen foshnjave (nën pretekstin se kanë domethënie "nacionaliste" dhe krijimin e klimës së përgjithshme të ksenofobisë dhe jotolerancës nga ana e mediave maqedonase ndaj anëtarëve të bashkësisë shqiptare. Për këtë, shihni te: Hugh Poluttion (1993); Bashkim Iseni (1995); Isa Blumi (1997); Bashkim Iseni (1998).

57 Është interesante të ceket se këto ndryshime kushtetuese janë bërë një muaj pas shkeljes së Kushtetutës së imponuar të Kosovës nga ana e Sllobodan Millosheviqit. Këto ndryshime kushtetuese janë rezultat i tensioneve ndëretnike që u paraqitën në vend në vitet e ardhshme. Prej atëherë, çdo kërkesë politike, edukative ose kulturore të pakicave janë refuzuar në mënyrë sistematike në emër të Kushtetutës së Maqedonisë, duke e bërë në këtë mënyrë dialogun ndëretnik të rëndë, të mos them të pamundshëm.

58 Të gjitha grupet etnike jo maqedonase kanë themeluar parti politike në bazë etnike.

59 Ndarjet të cilat tashmë u përmendën në temën për projektin e autonomisë territoriale.

Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH), e cila më vonë e ndërroi emrin në Partia Demokratike Shqiptare (PDSH). Anëtarët e PDSH udhëhiqnin politikë pro nacionaliste.

Në nëntor/dhjetor të vitit 1994 ose disa muaj pas ashpërsimit të marrëdhënieve politike, u inaugurua ideja për universitetin e parë shqiptar në Tetovë, qytet me shumicë shqiptare. Këtë ide ashpër e kundërshtuan maqedonasit etnike dhe organet shtetërore u përgjigjën me intervenim të ashpër kundër këtij universiteti të ardhshëm.⁶⁰ Intervenimi i forcave policore u përsërit në vitin 2005, me rastin e hapjes zyrtare të Universitetit, që u pagua me një viktimë njerëzore. Disa ditë pas incidentit, rektori i Universitetit, Fadil Sulejmani, u arrestua dhe u dënua me dy vjet e gjysmë burgim.⁶¹

Në korrik të vitit 1997 forcat speciale të policisë ndërmorën intervenim të fuqishëm në qytetin e Gostivarit pas insistimit të kryetarëve të komunave të qytetit të Gostivarit dhe Tetovës t'i valojnë flamujt shqiptarë mbi godinat e komunës.⁶²

Ky intervenim pati pasoja të paparashikuara: tre shqiptarë etnik u vranë, dhe qindra të tjerë u plagosën, u munduan dhe u arrestuan. Kryetarët e komunave të Gostivarit (Rufi Osmani) dhe i Tetovës (Alajdin Demiri) u arrestuan dhe dënuan.⁶³ Marrëdhëniet ndëretnike u keqësuan, veçanërisht pas këtyre ngjarjeve. Në muajt e ardhshëm vijuan sulem me mjete shpërthyes në Gostivar, Prilep dhe Kumanovë. Këto ngjarje paraqesin para shenja të konfliktit që e kaploi vendin disa vite më vonë. Në vitin 1998 u krijua koalicioni mes forcave nacionaliste të Organizatës së Brendshme revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Nacional Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe PDSH dhe ajo erdhi në pushtet. Gjatë kohës së kësaj qeverie, është realizuar avancim i caktuar lidhur me kërkesat e shqiptarëve. Për shembull në Tetovë u hap universiteti i parë privat në gjuhën shqipe, i cili u financua nga bashkësia ndërkombëtare. Edhe krahas kësaj, në vitin 2000/2001 ose dy vjet pas luftës në Kosovë, filloi konflikti i armatosur në Maqedoni.

Në periudhën 1991-2001 nuk hasim në kurrfarë përmbajtje religjioze në programet e partive politike shqiptare. Elita shqiptare në Maqedoni i ndan pikëpamjet e njëjta kombëtare dhe nacionaliste si dhe elita shqiptare në Kosovë – dhe kërkesat e tyre janë me tendenca laike dhe pro perëndimore. Kjo ndoshta sqarohet me faktin se kjo elitë ka qenë e arsimuar në Universitetin e Prishtinës. Megjithatë, ekzistojnë dallime në krahasim me Kosovën. Në të vërtetë, disa përfaqësues politik shqiptarë dhe anëtarë të PPD në planin lokal i kanë mbajtur lidhjet me besimtarët islam në Maqedoni. Strategjia e PPD përbëhej

.....
60 Policia përdor makina për rrënimin e ndërtesave. Këtij akti i paraprijnë demonstratat e studentëve etnik maqedonas nga Universiteti i Shkupit, të cilët e kundërshtojnë themelimin e Universitetit të Tetovës.

61 Pastaj është liruar nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare.

62 Ligji për simbolet kombëtare sa u votua nga parlamenti maqedonas. Ai lejoi valëvitjen e flamujve kombëtar të bashkësive jo maqedonase (do të thotë etnike), vetëm me rastin e festave kombëtare. E drejta për përdorimin e simboleve kombëtare nga ana e bashkësive etnike të pakicave ishte e garantuar me ish Kushtetutën e Maqedonisë.

63 Rufi Osmani u dënua me 13 vjet e tetë muaj burg, ndërsa Alajdin Demiri me 3 vjet. Në gjykimet e mëtejshme, këto dënime u ndryshuan. Këta të dy protagonistë politik u liruan pas vuajtjes së dënimit prej disa muajsh. Bashkësia ndërkombëtare bënte presion për lirin e tyre. U organizuan më shumë demonstrata shqiptare në disa qytetet të Maqedonisë për lirin e tyre.

në mbështetjen e Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë (BIM) me qëllim që të mbetet në pushtet dhe t'i fitojë zgjedhjet duke pasur parasysh faktin se shqiptarët në Maqedoni janë besimtarë të mëdhenj dhe më të devotshëm se sa të tjerët në Ballkan.⁶⁴ Që këtu, e kuptuam arsyen për përzierjen e personaliteteve politike nga PPD gjatë zgjedhjes së funksionit reis-ul ulema. Për shpërbllim, edhe ata u bënë mbështetës lojal të PPD.⁶⁵ PPD u gjet në pozitë të pavoritshme gjatë zgjedhjeve në vitin 1998, pasi që punën e vet duhej ta vë në dobi të partisë politike rivale.

Sa i përket popullatës turke, ajo është e përqendruar para së gjithash në rajonin e Gostivarit dhe në kryeqytetin e Shkupit dhe është e dyta sipas numrit popullatë myslimane në Maqedoni. Marrë në përgjithësi, partitë turke politike angazhohen për promovimin dhe mbrojtjen e gjuhës, kulturës turke dhe fesë myslimane në Maqedoni. Asociacione dhe organizata të ndryshme turke me përgjegjësi i morën mbi vete të gjitha obligimet. Kjo bashkësi politike është e mobilizuar rreth Partisë Demokratike të Turqve (*Türk demokratik partisi* - TDP). Gjatë zgjedhjeve në vitin 1994 një kandidat i kësaj partie është zgjedhur për deputet në parlamentin maqedonas. Në vitin 1994 u botua botimi lokal i gazetës turke "Zaman", që më vonë të botohet edhe në gjuhën shqipe. Në vitin 1997 u hap shkolla e mesme private Jahja Qemal, që është e inspiruar nga inspirime fetare.⁶⁶ Kjo shkollë mbetet e rezervuar për fëmijët e elitës myslimane në shtet. Më së shumti në shkollë mësojnë turq, por edhe shqiptarë, goranë, torbeshë dhe boshnjakë/myslimanë.

Popullata boshnjake-myslimane në Maqedoni është politikisht e organizuar rreth Partisë për Aksion Demokratik (PAD). Kjo parti në fillim kishte ndikim të madh nga PAD e Bosnjë dhe Hercegovinës. Pastaj ajo ideologjikisht u orientua drejt bindjeve politike personale të aktorëve të ndryshëm politik, qoftë që bëhet fjalë për myslimanë/boshnjak/, turq, shqiptarë, goranë ose torbeshë.

Sa i përket popullatës rome, shumica është myslimane, sipas drejtimit, ata janë sunitë dhe sofistë. Në planin politik janë tubuar në dy parti: Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve (PEPR) dhe Partia Progresive Demokratike e Romëve (PPDR). Në fund, popullata gorane ose torbeshe nuk ka krijuar parti politike deri më tani. Ata mbeten "instrument" në duart e autoriteteve maqedonase prej të cilëve lindi ideja për marrjen e identitetit të tyre kombëtar.⁶⁷

2.1.2. Zhvillimi i jetës fetare myslimane

Me shkatërrimin e Bashkësisë Islame të Jugosllavisë,⁶⁸ BIM u formua organizatë e pavarur fetare. Që atëherë ajo paraqet instancë zyrtare e cila i përfaqëson interesat e myslimanëve sunit në Maqedoni. Institucionet që i përfaqëson interesat e myslimanëve të cilët nuk janë

.....
64 Në mënyrë simbolike, nga ana e ish kryetarit të saj, Abdurrahman Aliti, urime me rastin e festave fetare u dërguan në xhamitë në vend dhe diasporën shqiptare në Zvicër.

65 *Vardar*, shkurt 1996, cituar në : Nathalie Clayer (2001), fq. 202.

66 Gazeta "Zaman", si dhe shkolla Jahja Qemal, janë të lidhura me lëvizjen e: *Fethullahchis*.

67 Nathalie Clayer (2001) fq. 191.

68 Jakub Selimoski, reis-ul ulemaja i fundit i Bashkësisë Islame të Jugosllavisë, ishte me prejardhje nga Maqedonia.

sunitë janë: Bashkësia religjioze e Fronit të artë dhe kurorë e bashkësisë fetare erenlere tarikate fetare dhe bashkësia religjioze Bektashi – ata kanë status të grupeve religjioze.⁶⁹

Gjatë periudhës së komunizmit, institucionet zyrtare islame funksiononin si aktor i rëndësishëm për kontrollin social dhe politik të popullatës myslimane në Maqedoni. Predikimet e imamëve përcilleshin nga afër nga ana e pushtetit, duke marrë parasysh ndikimin që e kanë imamët në krijimin e mendimit të popullata myslimane në Maqedoni. Institucionet islame dhe xhamitë gjithashtu të instrumentalizuara nga ana e regjimit në betejën ideologjike kundër “separatizmit” dhe “ideologjisë” shqiptare. Megjithatë, duke marrë parasysh diskriminimin arsimor, qëllimi i të cilit ishte kjo popullatë, njëkohësisht xhamia fiton funksionin e vendstrehimit identik të bashkësisë shqiptare. Kjo e shpjegon pa dyshim prirje të fuqishme fetare që e karakterizon këtë popullatë.

Me demokratizimin e vendit në vitet 1990, u demokratizua edhe BIM. Ky institucion fiton liri të cilat nuk i ka pasur deri atëherë. Më konkretisht, ndryshimi manifestohet mes fitimit të lirive të shprehjes së klerikëve fetar, me investimin në sferën publike nga ana e rrethëve fetare, botimin e publikimeve dhe përkthimin e librave për islamin, emetimin e emisioneve me përmbajtje religjioze në mediat elektronike dhe të shkruara, me ndërtimin e xhamive dhe tjera. Por, edhe krahas këtyre ndryshimeve, “vakëfet” (pronësi personale) të cilat u konfiskuan nga ana e shtetit gjatë komunizmit nuk janë kthyer.⁷⁰

Në vitin 1997 Qeveria u përgjigj pozitivisht kërkesës për hapjen e Fakultetit të Shkencave Islame në periferinë e Shkupit, për dallim nga viti 1995, kur ashpër e kundërshtoi iniciativën për universitet shqiptar (laik) në Tetovë. Strategjinë të cilën e aplikonin autoritetet politike maqedonase ishte që t’i jepen BIM institucionet e saja për arsim fetar dhe në këtë mënyrë t’i kundërvihen ndikimit të BIK (Bashkësisë Islame të Kosovës) dhe ideologjive politike në Kosovë mbi popullatën shqiptare në Maqedoni.⁷¹ Në pikëpamje të formimit të kuadrove fetare në Maqedoni, të theksojmë se paralelisht me arsimimin teologjik që e ofron ky institucion, studentët gjithashtu shkollohen edhe jashtë. Kjo sjell deri te një “hiperprodhim” të kuadrove fetare. Ky institucion kontribuon për rritjen e numrit të teologëve islam të papunë, pasi që Maqedonia paraqet tlo shumë të vogël që të mund t’i absorbojë gjithë këta imamë të ardhshëm.

Në periudhën 1992-1996 BIM u ballafaqua me shqetësime të fuqishme të brendshme. U krijua krizë në momentin kur myftiu i Tetovës dëshiron ta mbajë pavarësinë e tij jashtë nga BIM. Për këtë qëllim, disa kryetar fetar nga rajoni përpiqeshin të krijojnë organizatë të tyre të vet. Por PPD e pengoi këtë iniciativë.⁷² Në të njëjtën kohë, ish reis-ul ulemaja

69 Para disa viteve, Teqeja në Tetovë u uzurpua me dhunë nga ana e një grupi të sunitëve, të cilët e llogarisnin bektashizmin si herezi. Ky akt i privoi besimtarët bektashinj nga vendi i tyre i kultit. Bektashizmi ngadalë kthehet në disa regjione të Maqedonisë (veçanërisht në Kërçovë dhe në Shkup).

70 Prona që i ka takuar Kishës Ortodokse Maqedonase ishte ndarë, si dhe vakëfet nga Gostivari që i janë ndarë BIM.

71 Një numër i madh i studentëve shqiptar nga Maqedonia u regjistruan në Fakultetin për Studime Islamike në Prishtinë.

72 Nathalie Clayer (2001) fq. 194

i Jugosllavisë, Jakub Selimoski, përpiquej të krijojë bashkësi tjetër islame në Maqedoni: “Bashkësia islame e myslimanëve në Maqedoni”. Por, kryetarët fetar nga Tetova nuk e përmbajtën dhe gjetën gjuhë të përbashkët me BIM.⁷³

Jashtë nga aktivitetet fetare, BIM në periudhën 1990-2001 është aktive edhe në planin humanitar. Në vitin 1991 ajo e themeloi organizatën humanitare “El Hilal”. Zhvillimi i kësaj organizate është e lidhur me ardhjen e mijëra refugjatëve myslimanë/boshnjak me prejardhje nga Bosnja dhe Hercegovina në vitin 1992. Në periudhën e luftës në Kosovë (1997-1999) “El Hilal” në mënyrë energjike u angazhua në ofrimin e ndihmës qindra mijëra refugjatëve kosovar në Maqedoni.

Nga vendosja e ndryshimeve demokratike, ndryshimet në planin fetar në Maqedoni sqarohen me ndryshimet e doktrinës fetare. Paraqiten rryma të reja fetare islame. Mund të vërehet paraqitja e lëvizjes neosalafiste të predikuesve politiko-fetar dhe të përkthimeve të veprave me karakter rigoroz fetar. Kjo lëvizje paraqet sfidë të re për bashkësinë e besimtarëve të Maqedonisë, e cila e irrituar nga praktikat e reja dhe simbolet e reja fetare të promovuara nga aktorët e ri.

Këta predikues të ri i morën gradualisht rajonet e Shkupit dhe Kumanovës. Edhe më tej vendoseshin në rajonet tjera të Maqedonisë, si dhe në vendet fqinje (Kosovë dhe Shqipëri). Protagonistët kryesor të kësaj lëvizjeje janë kuadrot fetar të arsimuar në universitetet e Lindjes së Mesme, por edhe në Turqi.

BIM nuk shihte me miratim ndaj këtyre lëvizjeve, por as ndaj kushtueshmërisë së organizatave të jashtme joqeveritare islame ndaj refugjatëve nga Bosnja dhe Hercegovina të pranishëm në Maqedoni. Në vitin 1994 organizatat e jashtme joqeveritare islame u dëbuan nga ana e autoriteteve maqedonase.⁷⁴

2.1. Zhvillimi politik dhe fetar nga viti 2001

2.2.1. Fillimi i konfliktit dhe Marrëveshja kornizë e Ohrit

Në vitin 2001 u kryen sulme të shumta mbi forcat maqedonase të sigurisë. Si autor i sulmeve u paraqit Ushtria Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni (UÇK-M). Situata u bë brengosëse. Vitin e njëjtë Maqedonia hyri në konflikt të armatosur me forcave qeveritare dhe UÇK-M. Qeveria e Maqedonisë e kualifikoi UÇK-M si “organizatë terroriste”⁷⁵ dhe e prezantoi këtë kryengritje të armatosur si agresion i jashtëm, që ka për qëllim krijimin e “Shqipërisë së Madhe”. Të përkujtohem, kjo qeveri e përbërë nga partitë politike të VMRO-DPMN dhe PDSH, e zgjodhi opsionin për luftë të rreptë kundër UÇK-M. Armata maqedonase ndërmori bombardime të fuqishme kundër vatrave të UÇK-M në rajonin Tetovës. Gradualisht, konflikti u transferua drejt pjesës veri-perëndimore të vendit, më saktë në fshatrat e Kumanovës ku UÇK-M kishte vatrën e veta.

.....
73 Ibid.

74 Për këtë temë, shih te: Bashkim Iseni (2007)

75 Kualifikimi “terrorist” nuk u pranua as SHBA, as nga vendet e Unionit Evropian.

Marrë në përgjithësi, situata u bë shumë e tendosur. Në vend përhapjeje historia nacionaliste, duke përfshirë edhe opsionin për sigurinë. Valë me refugjatë vinin nga të gjitha anët. Raportohej për raste të zhdukjeve, torturave dhe vrasjeve të civilëve.⁷⁶ Kur konflikti u zgjerua drejt kryeqytetit të Shkupit, armata maqedonase ishte e pamundur t'i kundërvihet gueriles. Për shkak të situatës së tillë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Unioni Evropian, në mënyrë energjike u angazhuan për gjetjen e zgjidhjeve për konfliktin. Qëllimi i tyre kryesor ishte të shmanget zgjerimi i konfliktit mbi popullatën civile dhe të mos transformohet në konflikt të pakontrolluar ndëretnik. Në këtë mënyrë, të nxitur nga vendet perëndimore, të gjithë personalitetet politike me ndikim në vend u takuan në bregdetin e Liqenit të Ohrit. Edhe pse UÇK-M nuk ishte fizikisht e pranishme në bisedimet, qëndrimet e saja u përcollën nga partitë politike shqiptare. Negociatat ishin shumë të vështira, por ndërmjetësuesit arritën të gjejnë kompromis mes palëve të prekura. Marrëveshja parashihte ndërprerjen e zjarrit, demobilizimin e UÇK-M, amnisti për luftëtarët e saj, ruajtja e karakterit unitar të shtetit, por për kthim decentralizim të fuqishëm. Që të arrihet e gjithë kjo, ishin paraparë ndryshime në Kushtetutë në dobi të bashkësive jomaqedonase. Përveç kësaj, me Marrëveshjen parashihej përfaqësim më i madh i shqiptarëve në institucionet maqedonase. Marrëveshja kornizë e Ohrit u nënshkrua më 14 gusht 2001 në pani të aktorëve kryesor politik në vend dhe të përfaqësuesve të lartë nga vendet perëndimore evropiane.

Atëherë UÇK-M u transformua në parti politike e quajtur Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI). Kjo parti e re politike e fitoi shumicën e votave shqiptare në zgjedhjet e vitit 2002. BDI hyri në koalicion me Lidhjen Socialdemokratike të Maqedonisë (LSDM), e cila ishte fituese e paprekshme te elektorati etnik maqedonas.

U formua qeveria ndëretnike. Ajo më parë u udhëhoq nga Branko Crvenkovski, e pastaj nga Vllado Buçkovski⁷⁷, të dy politikanë pjesëtarë të LSDM. Nga emërimi i qeverisë së re, ministrat shqiptar investuan përpjekje të mëdha të fillojnë me realizimin e Marrëveshjes kornizë të Ohrit. Në vitin 2002 Parlamenti votoi ligj në dobi të arsimit të lartë të bashkësive jomaqedonase. Pak më vonë, u legalizua Universiteti i Tetovës.

Siç përmendëm më parë për UÇK e Kosovës, konflikti nga viti 2001 nuk pati kurrfarë konotacioni fetar në kuadër të UÇK-M. Krijues dhe lider kryesor të UÇK-M janë persona nga diaspora evropiane e LPK me profil ideologjik nationalist-komunist. Ky kuadër politik dallohet me ateizëm të fuqishëm, idetë e tyre janë nacionaliste, e jo fetare. Sa i përket BIM, ajo ishte kundër luftës së UÇK-M dhe apelonte “Leni armët”. Ky apel e reflekton qëndrimin personal të reis-ul ulemasë Rexhep Sulejmani, i cili është i afërt me PDSH, i cili nuk është qëndrim zyrtar i të njëjtës. Të nënvizojmë se disa personalitete fetare i vënë vulë zhvillimit të konfliktit në Maqedoni. Si për shembull mulla Jakupi, imam nga fshati Sllupçan (Kumanovë), në fillim të konfliktit nga inspirimi patriotik simbolikisht e veshi uniformën e UÇK-M.

76 Për këtë temë, shihni te: Bashkim Iseni (2005 b).

77 Për shkak të vdekjes tragjike të ish kryetarit, Boris Trajkovski, në verën e vitit 2004, u organizuan zgjedhjet e parakohshme presidenciale. Lideri i Lidhjes Socialdemokrate, Branko Crvenkovski, atëherë u zgjodh për kryetar shteti.

2.2.2. Pafuqi e bashkësisë islame në Maqedoni

Ndryshimet politike të cilat vijonin pas nënshkrimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit përmbajnë një pjesë që ka të bëjë me ndryshimet kushtetuese për statusin e religjioneve kryesore në Maqedoni. Kushtetuta e vjetër e njihte vetëm Kishën Ortodokse Maqedonase. Këto ndryshime të cilat dolën nga Marrëveshja kornizë e Ohrit paraqet ilaç për problemin e dhimbshëm. Por ato zgjuan edhe tensione ndërfaqetare në kuptimin e keqësimit të marrëdhënieve mes bashkësisë islame në Maqedoni dhe Kishës Ortodokse Maqedonase. Ajo ashpër e kundërshtonte vënien nën pikëpyetje të statusit të saj të privilegjuar.

Pas miratimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit, në kuadër të kontekstit të ri politik vijuan ndryshime edhe në kuadër të BIM.

Të themi sinqerisht, ajo tashmë gjendej në situatë krize edhe para konfliktit në vitin 2000. Kjo krizë filloi me zgjedhjen e res-ul ulemase së ri Arif Emini. Sipas përfaqësuesit të lartë fetar nga Shkupi, zgjedhja e tij ka shkaktuar pakënaqësi, pasi që komisioni zgjedhor ka qenë i përbërë nga anëtarë të cilët nuk kanë qenë të autorizuar të votojnë. Përveç kësaj, kandidati i propozuar nuk ka qenë i aftë ta kryejë këtë detyrë. Zgjedhja e tij ka qenë drejtpërdrejt vepër e Sulejman Rexhepit. Ai e ka mbështetur zgjedhjen e Eminit, duke pasur parasysh faktin se ka pasur ndikim mbi atë. Sipas këtij burimi, kandidimi i Eminit është mbështetur me qëllim që të pamundësohet zgjedhja e një kandidati tjetër të jashtëm, pasi që keqpërdorimet e mundshme financiare në llogari të BIM një ditë do të mund të shpallen.⁷⁸

Nën udhëheqjen e reis-ul ulemasë së ri, Arif Emini, BIM bëri ndryshime të rëndësishme institucionale. U miratua Kushtetuta e re në dhjetor të vitit 2003. Me këtë parashihej edhe centralizimi i financimit të BIM. Përveç tjerash, me atë pezullohej autonomia financiare e myftinive dhe tejkalohen dallimet në mënyrën e pagesës, të cilat ekzistojnë mes të punësuarve në nivel qendror të BIM dhe imamëve nëpër xhamitë.⁷⁹ Këto ndryshime gjithmonë nuk patën efekt pozitiv, edhe krahas pranimi të rregulloreve të reja për funksionimin e BIM. Kjo situatë është tejet irrituese për një numër të caktuar të imamëve, të cilët gjendeshin në pozitë të pavolitshme materiale.

Në mars të vitit 2004 organizimi i zgjedhjeve për myftinitë e ri në Maqedoni shkaktoi krizë të madhe, që e tundi BIM gjatë shumë viteve të ardhshme. Zgjedhja e myftive të Shkupit dhe të Resnjës u pezulluan nga ana e komisionit zgjedhor dhe nga një grup imamësh. Pak më vonë nga kjo ngjarje kontroverse, reis-ul ulemaja u vu nën presion për çka ishte i obliguar ta thirri nga detyra myftium e e zgjedhur nga Shkupi Zenun Berisha. Ai, nga ana e tij, e refuzoi largimin nga detyra. Sipas tij, procedurat e ndërmarra për zgjidhjen e tillë nuk janë respektuar. Megjithatë, u organizuan zgjedhje të reja në myftininë e Shkupit. Taxhedin Bislimi u zgjodh në vend të Zenun Berishës. Këto zgjedhje u kontestuan ashpër nga Berisha dhe nga ithtarët e tij.

.....
78 Biseda u bë në Shkup në nëntor të vitit 2006.

79 Deri më tani, të punësuarit në instancat qendrore të BIM pagehishin drejtpërdrejt nga ata, ndërsa imamët para së gjithash pagoheshin nga kontributet vullnetar të besimtarëve. Ky sistem i lë imamët në pozitë të pavolitshme.

Situata u keqësua mes dy grupeve. Edhe krahas marrëveshjes së lidhur mes dy palëve, me ndihmën e ndërmjetësimit personal të liderit të BDI, Ali Ahmeti, persona të armatosur dhe të maskuar për një kohë të shkurtër futën në Kuvendin e BIM. Reis-ul ulemaja dhe deputetët e tij sulmuan fizikisht. Pas këtyre ngjarjeve, Arif Emini u bë cak i frikësimeve dhe e braktisi funksionin. Kjo episod është përcjellë me sulme fizike nga ana e grupit të armatosur, të Taxhedin Bislimit, myfti i Shkupit, i zgjedhur para do kohe.⁸⁰ Dyshojmë se ish myftiu ka qenë i përzier në këto incidente, por ai kategorikisht e hodhi poshtë çfarëdo involvimi. Zgjedhja e kandidatëve tjerë për funksionin reis-ul ulema, si Ruzhdi Lata (myfti i Dibrës) dhe Isa Ismaili (Prilep) nuk zgjati shumë. Nën presion dhe kërcënime të dy dhanë dorëheqje vetëm disa ditë pas emërimit të tyre.

Këto ngjarje të ashpra e tronditën thellë bashkësinë fetare në Maqedoni. Mediat e vendit, por edhe nga Kosova dhe Shqipëria e ndiqnin nga afër zhvillimin e situatës. Këto episoda paraqisnin shprehje të kundërshtimeve mes dy blloqeve të BIM: njëri i “rrymave tradicionale”, ndërsa tjetri i lëvizjes së “vehabistëve” nën udhëheqjen e Zenun Berishës. Sipas mediave, kjo lëvizje ka inspirime ideologjike-fetare dhe ka për qëllim ta marrë nën kontroll myftininë e Shkupit. Këtu bëhet fjalë për cak strategjik, pasi që kjo myftininë është më e madhja në vend dhe mes saj mund të merret kontrolli mbi gjithë BIM.

Ky mendim shkaktoi revolt te Zenun Berisha dhe rrethimi i tij. Ata kategorikisht e hodhën poshtë etiketën “vehabistë”. Sipas një vëzhguesi të situatës, Berisha qartë udhëhiqet sipas traditës hanefiste, edhe pse disa aktorë të afërt me UÇK-M e shtynin të kalojë në lëvizjen neosalafiste, ndërsa si shpërblim të zgjidhet në funksionin myfti. Qëllimet e kësaj mbështetje nuk ishin ideologjike, por thjesht materiale. Bëhet fjalë për marrjen e kontrollit mbi vakëfet, të cilat i posedon myftinia e Shkupit, më saktë shumica e dhjetëra dyqaneve, të cilat u jepen me qira tregtarëve në pjesën e vjetër të qytetit. Përveç kësaj, çështja për punësim pranë myftinisë është shkaku më i madh me të cilën mund të sqarohen tensionet.

Secili klan i imamëve ose kuadrove religjioze mbështet një kandidat për zgjedhje si myfti, me qëllim që të fitojë kontroll mbi punësimet e shumta, duke marrë parasysh faktin se numri i të papunësuarve me diploma për arsim të përfunduar të lartë është i madh.⁸¹

BIM gjendet në situatë të anarkisë dhe bllokimit të plotë, si në planin e legjitimitetit, ashtu edhe në planin funksional. Në shtator të vitit 2005, Ali Ahmeti përsëri u angazhua për zgjedhjen e organit të përkohshëm udhëheqës në BIM, duke besuar në stabilizimin e situatës. Ai propozoi gjithashtu mbrojtje të plotë të kushteve nën të cilat do të zhvillohet diskutimi kuvendar në BIM. Diskutimi u mbajt në qytetin e Strugës. Gjatë këtij diskutimi kuvendar u zgjodh reis-ul ulemaja i ri i përkohshëm, Bahri Aliu, nga Struga dhe kryetar i kuvendit të BIM.⁸²

.....
80 Koha ditore, 4 korrik 2005.

81 Për papunësinë e teologëve, shih te: Ramadan Ramadani “Ringjallja islame, instalimi i njerëzve nëpër institucione, hiperproduksioni i hoxhallarëve...” Lobi internet arkiva, mund ta merrni në <http://www..lobi.com.mk/?ItemID=2FECC7BD84F2384A88154DC270C0EA98>.

82 Koha ditore, 26 shtator 2005.

Bahri Aliu e udhëhoqi BIM deri në shtator të vitit 2006, deri në zgjedhjen e serishme të Sulejman Rexhepit, në funksionin reis-ul ulemaja “i ri”. Të përkujtohem, Rexhepi e kryente këtë funksion deri në zgjedhjen e Emin Arifit nga fundi i vitit 2000. Më shumë tregues qartë flasin për atë se kthimi i Rexhepit në këtë funksion ka qenë vendim i PDSH, e cila u kthye në pushtet pas zgjedhjeve parlamentare në verën e vitit 2006.⁸³ Sipas burimeve të shumta, para zgjedhjes së reis-ul ulemasë, aktivistë të PDSH “shkuan për vizitë” te votuesit e kuvendit të BIM, “duke u thënë” se cili është kandidati që duhet të zgjidhet.⁸⁴ Sipas shumicës së politikanëve dhe gazetarëve nga vendi, zgjedhja e Rexhepit u mbështet edhe nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Maqedoni. Në personalitetin e fortë të Rexhepit, SHBA shohin garanci për vendosjen e rendit në këtë institucion. Qëllimi është që të rregullohet situata anarkiste, që të pengohet infiltrimi i mundshëm i elementeve neosalafiste bë BIM. Megjithatë, sipas mendimit të një njohësi të rasteve islame në Maqedoni, zgjedhja jodemokratike e reis-ul ulemasë së ri dhe personalitetit të tij autoritativ sërish do të mund të shkaktonte tensione në radhët e BIM.⁸⁵

2.2.3. Rasti i Këndovës dhe paraqitja e lëvizjes neosalafiste

Një rast tjetër “fetar” islam e mobilizoi opinionin publik në Maqedoni. Ai është i lidhur me takimin që u realizua në gusht të vitit 2005 mes Ali Ahmetit dhe kryeministrit të Shqipërisë, Fatos Nano. Gjatë këtij takimi, mes të dyve kishte “shkëmbim të informatave” rreth supozimit të ekzistimit të qelizave “fundamentaliste” të lidhura me grupin e Al-Zarqauit në Këndovë, fshat i vendosur në rajonin e Shkupit. Ky rast është zbulim i keqpërdorimit të kualifikimit “fundamentalist” ose “terrorist” që të arsyetohen mjetet e ndryshme të politikës së brendshme ose të jashtme. Në Maqedoni vëzhgues të ndryshëm pohojnë se në të vërtetë ekziston grup i armatosur në këtë fshat, por se ata nuk janë aktivistë fetar. Në rastin konkret, është treguar se klasa politike maqedonase (shqiptare dhe etnike maqedonase) e shfrytëzoi etiketën “fundamentaliste” që të njolloso grupin e caktuar të armatosur të afërt me PDSH.

Lideri i grupet quhet Agim Krasniqi, person me dosje të trashë policore dhe gjyqësore. Asnjë tregues nuk flet për atë nëse ai ka lidhje me rrjetet e neosalafistëve. Përkundrazi, bëhet fjalë për aktor të afërt të udhëheqësish së PDSH. Kjo tezë është e mbështetur me faktin se gjatë zgjedhjeve në korrik të vitit 2006 ai figuronte në listën e kandidatëve kryesor të kësaj partie politike. Por, PDSH dhe udhëheqësia e saj janë të njohura për qëndrimin e tyre nacionalist,

.....
83 Në korrik 2006 BDI e fiton shumicën e votave të elektoratit shqiptar, por VMRO-DPMNE e zgjodhi PDSH për partner koalicioni në qeveri. Ky akt solli deri në krizë të thellë politike në Maqedoni në verën e vitit 2006. E pakënaqur nga zgjedhja politike e VMRO-DPMNE, BDI në janar të 2007 vendosi ta bojkotojë parlamentin maqedonas.

84 Sulejman Rexhepi do ta fitonte mbështetjen me votat e dymbëdhjetë myftinive. Paar zgjedhjeve, selia e BIM ishte gjuajtur me kalashnikovë. Rasti u sulmua ashpër nga reis-ul ulemaja i ri pas zgjedhjes së tij. Për temën e zgjedhjeve shihni shkrimet faktike në gazetatat lokale Fakti, Shpic, Dnevnik, Lajm, shtator 2006.

85 Mendim i shprehur nga shumë analistë shqiptar nga Maqedonia. Për temën e zgjedhjes së reis-ul ulemasë së fundit, shihni (Tamara Çausidis) “Zgjedhjet përpiqen t’i amortizojnë mospajtimet në Maqedoni”, Lobi, 2 tetor 2006. Kjo mbledhje u mbajt pas një vizite të shpejtë të deitorit të CIA në fund të muajit qershor në Tiranë. Ai pati takim me shefat e shërbimeve sekrete nga rajoni dhe nga Maqedonia (Gazeta Shqiptare, 10 gusht 2005).

neosalafist ose pro perëndimor. “Identiteti kombëtar nuk ka asgjë të përbashkët me atë fetar. Popujt të cilët kanë identitet të vërtetë kombëtar nuk kanë nevojë ta krijojnë të njëjtin nëpërmjet bindjeve fetare”, deklaroi për revistën “Lobi”, Arben Xhaferi, lideri karizmatik i PDSH, i cili është personalitet shumë aktiv në skenën mediave në Maqedoni, por edhe në Shqipëri dhe Kosovë.⁸⁶ Ai dha një vështrim kritik lëvizjes neosalafiste.⁸⁷ Por sa vjen e më shumë, siç theksuam më lartë, PDSH e luajti rolin vendimtar në rizgjedhjen e reis-ul ulemasë së tanishëm, Sulejman Rexhepi. Ai ka qëndrim jashtëzakonisht të fortë lidhur me grupacionet neosalafiste në vend: “U shpall luftë pa kompromis atyre që e keqpërdorin islamin në Maqedoni”.⁸⁸

Sa i përket lëvizjes neosalafiste nga pikëpamja pietetike, pohojmë qartë se kjo ishte shumë e përfaqësuar në Maqedoni. Shumë imamë nga Shkupi dhe Kumanova janë pjesë të kësaj lëvizje. Neosalafistët përhapen vazhdimisht në territorin e Maqedonisë. Duke marrë parasysh mendimet e njëjta të shumë vëzhguesve nga vendi, kjo lëvizje merr përfitime financiare nga Arabia Saudite, duke promovuar në këtë mënyrë ideologjinë politike-fetare në Maqedoni. Tashmë disa vite me radhë zhvillojnë edhe aktivitete tregtare, me të cilat i financojnë aktivitetet e tyre predikuese: përkthime, botim dhe distribuim i veprave ideologjike, të orientuara armiqësisht ndaj shteteve moderne perëndimore, promovimin e fjalimeve me përmbajtje të prapambetur dhe jotolerante përkundër vlerave demokratike dhe liberale. Qëllime të tyre të privileguara janë besimtarët e rinj.

Zëdhënësi i neosalafistëve të tipit të devotshëm, e konteston epitetin “vehabistë” i cili iu etiketua nga ana e mediave dhe klasës politike në shtet: “ne nuk jemi “vehabistë”, por dëshirojmë t’i kthehemi rrënjëve tona. U themi myslimanëve që ta lexojnë Kuranin në mënyrën se si e kanë bërë këtë paraardhësit tanë, me qëllim që të shmanget komentimi i tij i shtrembëruar (...) Ne jemi islami shkencor, ne jemi islami i argumentuar”. Sipas tij, gjithnjë kur do të paraqiten lëvizje të reja fetare në shtet, menjëherë pa arsye njollosen me qëllim që në atë mënyrë të diskreditohen në sytë e opinionit. “Nëse përfaqësojmë organ të jashtëm të shoqërisë, ajo do të na hidhte. Ne jemi cak i liderëve politik shqiptar, pasi që ata janë të ngashëruar me fenë e tyre. Puna jonë është t’i mbrojmë interesat e popullit të cilat atyre u pengojnë. Ne krijojmë të menduarit kritik. Ky është obligimi jonë, pasi që askush tjetër nuk do ta bëjë këtë (...)”⁸⁹

Ky aktor neosalafist e kritikon korrupsionin dhe nepotizmin e klasës politike në Maqedoni. Ai deklarohet kundër krijimit të partive politike islame, pasi që “e paraqesin islamin në dritë të keqe” dhe më shumë se kjo, sipas tyre, parti të tilla nuk duhet të themelohen, sepse ne jemi në Evropë. Ai nuk e kundërshton orientimin pro evropian të Maqedonisë. Përkundrazi, sipas tij “myslimanët e Ballkanit janë ata që më shumti e ngadalësojnë procesin e evropeizmit”. Për atë, “kjo qasje drejt Unionit Evropian dhe NATO do t’i përmirësojë të

86 Arbër Xhaferi “Shqiptarët vitalë, por shpenzojnë energjitë në debatet e kota”, Lobi, internet arkivi, mund ta lexoni në: <http://www.lobi.com.mk/?ItemID=FD685B37B74A624991822F60348DF13F>.

87 Bisedë e zhvilluar në Tetovë në nëntor 2006.

88 Intervistë e reis-ul ulemasë dhënë gazetës Fakti, mund ta gjeni në internet faqen: <http://www.lajmet.com> nga 26 tetori 2006.

89 Bisedë e zhvilluar në Shkup në nëntor 2006.

drejtat demokratike dhe fetare. Popullata do të mund të ketë dobi nga aspektet pozitive të modernizimit, pasi që aspektet negative janë ende të pranishme”.

Përfundim

Studimi i problematikës së islamit në Maqedoni mundëson analizë të llojeve të ndryshme të konstalacioneve, të cilat do të mund të vendosen mes aktorëve politik dhe aktorëve fetar islam. Sa i përket BIM, imponohet pohimi se ky institucion është instrumentalizuar nga ana e klasës politike me qëllim që t'i fitojë votat e popullatës me besim mysliman në Maqedoni. Liderët e BIM ua japin mbështetjen e vet partive dominuese politike, që t'i fitojnë votat dhe të vijnë në pushtet, e kur do të ndodhë kjo, për kundër shpërblim do të llogarisin në votat e tyre.⁹⁰ Të theksojmë se ky afrim i interesave mes mjediseve politike dhe fetare nuk do të thotë se në masë të madhe ekziston harmonizim i interesave ideologjike mes dy sferave. Pikërisht e kundërta: të gjitha partitë politike shqiptare janë me orientim laik dhe nacionalist. Por, ata janë të bindur se bile edhe mbështetja simbolike e mjediseve fetare mund t'u ndihmojë shumë në garën për pushtet.

Sa i përket krizës së thellë në të cilën gjendet BIM, kjo vështirë mund të sqarohet me kundërshtimet mes “islamit tradicional” dhe “islamit të importuar”. Këto tensione duhet të kuptohen si rezultat i tre faktorëve. Faktori i parë përbëhet në pamundësinë për absorbimin e masës së studentëve teologjik nga ana e BIM, të cilët janë arsimuar viteve të fundit në shtet dhe jashtë saj. Faktori i dytë është lufta mes fraksioneve të brendshme dhe të jashtme në vetë BIM për shkak të kontrollit mbi resurset materiale të institucionit. Më në fund, faktori i tretë është i lidhur me kundërshtimet mes gjeneratave të vjetra dhe të reja të imamëve. Në të vërtetë BIM është peng i funksionarëve të vjetër të pakualifikuar sa duhet, të cilët e pengojnë rrugën e personave kompetent të ri dhe kuadrove mirë të trajnuara. Në të kundërtën me realitetin, përdoren të gjitha llojet e epiteteve për shkak të diskreditimit të këtyre personave dhe largimi i tyre nga institucionet islame. Këto konflikte u shkojnë në dobi lëvizjes neosalafiste, që rekruton kuadro të reja fetare të frustruar për shkak të mospasjes së perspektivës profesionale në sistemin e tanishëm.

Marrë në përgjithësi, viteve të fundit në Maqedoni vërejmë praktikizmin e shpeshtuar të religjionit. Kjo ngritje e religjiozitetit sqarohet gjithsesi nëpërmjet faktorëve historik. Por, situatat e përgjithshme politike, korrupsioni i cili i han elitat politike dhe degradimi jetësor i popullatës myslimane të goditur nga varfëria, ndihmon për ngatërrimin e fijeve për identitetin dhe fenë. Më shumë e më shumë vendin që e merr kisha ortodokse në skenën publike dhe lidhja e saj me liderët qeveritarë të maqedonasve etnik në masë të madhe e irritojnë popullatën myslimane në vend. Në këtë situatë të pas luftës, zhvillohet logjika e shënimit etnik dhe fetar të territorit. Ky fenomen sqarohet nëpërmjet ndërtimit të xhamive dhe kishave ortodokse në gjithë territorin e shtetit.⁹¹

90 Sipas një imami nga Shkupi, ky lojalitet nuk është motivuar vetëm e argumente oportuniste, por gjithashtu edhe nga frika. Biseda e zhvilluar në Shkup, nëntor 2006.

91 Në vitin 2000 kryqi i gjatë 50 mera u vendos në majën e malit Vodno, që gjendet mbi Shkupin. I ndriçuar edhe në mbërmje vërehet nga lagjet myslimane shqiptare në Shkup. Rreth kësaj teme mund të përmendet edhe ndërtimi i dy minareve më të mëdha pranë çdo xhamie në fshatra të caktuara shqiptare në Maqedoni.

Në fund, sa i përket ndikimit të jashtëm islam në Maqedoni, është e rëndësishme të theksohet ekzistimi i konkurrencës mes aktorëve të cilët përpiqen ta promovojnë ndikimin turk dhe arap të islamit. Në të vërtetë, duke pasur parasysh afinitetet kulturore, politike, ekonomike dhe religjioze me botën turke, prania e Turqisë dhe islamit të saj të matur hanefist llogaritet për mjet për t'i kundërvënë ndikimit arap islam, si dhe për t'ua penguar rrugën lëvizjeve fundamentaliste në vend dhe në rajon.

3. Islami dhe politika në Luginën e Preshevës

Lugina e Preshevës, në jug të Serbisë, paraqet kalim rrugor strategjik drejt Evropës Juglindore (hekurudha dhe magjistralja Beograd – Shkup – Selanik). E vendosur në udhëkryqin mes Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë, ajo përmban tre komuna me përbërje shqiptare-myslimane: Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Komunitat janë të banuara me shqiptarë, serbë, romë dhe boshnjak/myslimanë.

Qëllimi i kësaj analize është ta kuptojmë zhvillimin aktual të tendencave politike dhe fetare në rajon, i cili është i përbërë me popullatë ku shumica është me fe myslimane me prejardhje shqiptare ose myslimane/boshnjake. Sipas regjistrimit nga viti 2002, popullata shqiptare numëron rreth 57.000 dhe atë më së shumti në komunën e Preshevës (95%) dhe Bujanoc (55%). Sa i përket komunës së Medvegjës, 26% nga popullata e përbëjnë shqiptarë.⁹²

3.1. Zhvillimi i situatës politike në Luginën e Preshevës prej vitit 1990 e këtej

Zonat ku jetojnë shqiptarët në luginë janë vendosur në sferën hapësinore të tërësisë kulturore shqiptare në Ballkan. Kështu, rrjedhat bashkëkohore politike të cilat kanë të bëjnë me shqiptarët në Luginën e Preshevës janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e situatës në Kosovë dhe në Maqedoni. Lidhjet politike, ekonomike dhe kulturore (familjare) mes popullatës së këtushme dhe popullatës shqiptare në Kosovën lindore ose në Maqedoninë veriore (Kumanova) janë tradicionalisht të fuqishme: Kosova, nëse e shohim politikisht, është qendra e tyre për lidhje në planin politik, kulturor, ekonomik dhe arsimor. Shumica e elitës nga këto tre komuna janë arsimuar dhe vazhdojnë edhe më tej të arsimohen në Universitetin e Prishtinës dhe në universitetet në gjuhën shqipe në Tetovë.⁹³ Edhe pse në krahasim me ata në Kosovë, marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve në Luginën e Preshevës historikisht janë më të mira,⁹⁴ megjithatë integrimi politik dhe administrativ të rajonit të Serbisë në vitin 1946 u kuptua si padrejtësi ndaj popullatës shqiptare. Kjo ndjenjë u forcua në vitet 1980, gjatë tensioneve të fuqishme politike që ndodhën në Kosovë. Në të vërtetë, zhvillimi i ngjarjeve në Kosovë ndikoi sistematikisht në marrëdhëniet ndëretnike mes shqiptarëve dhe serbëve në Luginën e Preshevës. Pas rënies së regjimit të Slllobodan Millosheviq, popullata shqiptare ishte nën presion të madh nga ana e politikës së fuqishme mediale dhe fushatës nacionaliste të drejtuar kah “separatizmi” shqiptar. E gjithë kjo la pasoja në këto komuna – me zvogëlimin e vazhdueshëm të kompetencave të tyre lokale, si rezultat i pezullimit të autonomisë së Kosovës dhe masat kushtetuese qendrore të

92 Numrat janë marrë nga Grupi ndërkombëtar i krizës (International Crisis Group) (2003) fq. 3. Qyteti i Bujancit edhe në përqindje disponon me numra realtivisht të plotë lidhur me popullatën serbe, shqiptare dhe rome; Shqiptarët gjithnjë kanë qenë shumicë e fuqishme në disa fshatra nga kjo komunë, si: Tërnovci i Madh, fshat me 10.000 banorë si seli më e rëndësishme tregtare në Ballkan për tregtinë me çfarë do lloj malli.

93 Universitet shtetëtor dhe Universiteti i Evropës Juglindore.

94 Vërejmë gjithashtu se marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovën Lindore, si dhe ato në Luginën e Preshevës, nga pikëvështrimi historik janë të mira.

votuara në Serbi kundër popullatës së saj shqiptare në fushën e arsimit, informimit dhe punësimit.⁹⁵ Në të vërtetë, politika e tillë ishte aplikuar me qëllim që përpilohet plani socio-ekonomik sipas të cilit gjatë shumë viteve të ardhshme Lugina e Preshevës do të duhej të bëhet rajoni më i pazhvilluar në Serbi.

Me ndryshimet politike që ndodhën në Serbi në vitet e nëntëdhjeta, në tre komunat formohen parti shqiptare, mes të cilave edhe Partia për Veprim Demokratik (PVD). Prej atëherë ata marrin pjesë në zgjedhjet republikane në Serbi dhe vazhdimisht kanë nga një ose dy vende deputeti në parlamentin serb. PVD imponohet gjatë zgjedhjeve lokale në vitin 1992 dhe lideri i saj Riza Halimi u zgjodh për kryetar komune të Preshevës. Përndryshe, në mars të vitit 1992 u bë pastrim i madh politik, pasi që udhëheqësia politike shqiptare në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë organizoi referendum (i cili nuk u pranua nga ana e Beogradit) për autonominë kulturore dhe politike në Luginën e Preshevës dhe bashkimin e saj me Kosovën.⁹⁶ Por, ky projekt nuk u realizua dhe në vitin 1993 partitë shqiptare në Luginën e Preshevës u kandiduan përsëri në zgjedhjet në Serbi.⁹⁷

Embargoja ekonomike kundër Serbisë në vitin 1992 si dhe izolimi i saj ndërkombëtar politik lanë pasoja edhe në Luginën e Preshevës. Në të vërtetë, nga paraqitja e UÇK në Kosovë në vitin 1997 u rrit presioni mbi popullatën shqiptare në Serbi. Ajo u rrit edhe më shumë gjatë bombardimeve të NATO në vitin 1990. Atëherë raportohej për shkelje të drejtave të njeriut nga ana e ushtrisë paraushtarake serbe dhe vrasjet e shumta të civilëve shqiptarë⁹⁸ Pas miratimit të marrëveshjes ushtarake-tekniqe në Kumanovë, me të cilin u formalizua tërheqja serbe nga Kosova, në qershor të vitit 1999 trupat e shumta (mes të cilave edhe korpusi i 3 i Prishtinës) u vendos në Luginën e Preshevës.⁹⁹ Ky pozicionim i serishëm i armatës dhe frika nga presionet paraqisnin bazë për ikjen e 25.000 refugjatëve shqiptarë në drejtim të “zonës së demilitarizuar” dhe drejt Kosovës.¹⁰⁰

Në vitin 1990 guerili i cili pohoi se është përfaqësues i shqiptarëve në Luginën e Preshevës kreu disa sulme të armatosura, caku i të cilave ishin policët dhe ushtarët serb. Kjo armatë për lirim e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (Ushtria Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc – UÇPMB), e cila numëronte mes 800 dhe 1.500 ushtarë furnizohej me armë nga Kosova dhe e shfrytëzonte kuadrin e veteranëve të UÇK, e cila ishte e financuar nga diaspora. Këto sulme caku u shpeshatuan edhe kundër forcave të sigurisë dhe nxitën aksione të forcave ushtarake serbe. Situata së shpejti u nxeh dhe pati viktimë civile dhe ushtarake në të dy anët. Vetëm me involvimin e NATO në mars të vitit 2001 u gjet zgjidhje

.....
95 Për këtë temë, shih te: Humanitarian Law Center (2003).

96 Në retorikën nacionaliste shqiptare, rajoni i Preshevës quhet “Kosova Lindore”.

97 Rast i shfaqes analoge për referendumin e organizuar vitin e njëjtë në Maqedoni është përcjellë me pjesëmarrje të shtuar të partive politike shqiptare në Maqedoni.

98 Shih te: Humanitarian Law Center (2003).

99 Ai i mori botimet publike, shkollat, sipërmarrjet e vjetra shtetërore etj.

100 Me rreze prej 5 km dhe gjatësi prej 150 km. GSZ (“Ground Safety Zone – GSZ) u krijua sipas marrëveshjes nga Kumanova për shkak të ndarjes së forcave serbe nga ato të KFOR. E shfrytëzuar so bazë sporadike e UÇPMB (shih më poshtë) GSZ më vonë u ndërmorr nga forcat serbe të sigurisë me leje, por edhe nën kontrollin e NATO.

mes luftëtarëve shqiptarë dhe forcave zyrtare ushtarake. Kjo “deklaratë për demilitarizimin” e nënshkrua në maj të vitit 2001

Mes UÇPMB dhe NATO Me atë parashihej demobilizimi dhe çarmatimi i UÇPMB, si dhe amnisti për anëtarët e saj. Për shpërblim, në Luginën e Preshevës u parapa krijimi i policisë me përbërje të përzier, si dhe përfaqësim më të madh të shqiptarëve në administratën publike. Korniza e dytë e rëndësishme për marrëveshjen është gjithsesi garanci e dhënë nga ana e UÇPMB për kthimin e ushtrisë jugosllave në “zonën e sigurisë”, e cila shtrihet gjatë kufirit.

Vetëm disa ditë pas nënshkrimit, armata jugosllave u kthye në këto zona të ndjeshme. Edhe krahas disa incidenteve të izoluar për shkak të mendimeve të kundërta mes liderëve të UÇPMB dhe marrëveshje së nënshkruar me NATO, situata u kthye në një normale.¹⁰¹ Me qëllim të stabilizimit të rajonit, nga ana e qeverisë serbe u formua policia multietnike, si dhe “Qendra për koordinimin e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit”.¹⁰² Megjithatë, Qendra për koordinim nuk i mbajti premtimet e saja. Sipas vëzhguesve nga vendi, situata gradualisht përmirësohej në komunën e Preshevës.¹⁰³ Është vërejtur përparim në fushën e policisë, mediave, përfaqësimit të shqiptarëve në administratë dhe në institucionet gjyqësore. Por situata mbeti edhe më tej e vështirë në Bujanoc, ku nuk ka përparim të dukshëm në planin ndëretnik dhe në raport me përfaqësimin e shqiptarëve në institucionet komunale.¹⁰⁴ Sa i përket Medvegjës, numri i shqiptarëve në fshatra u zvogëlua në mënyrë drastike, veçanërisht pas kthimit të ushtrisë në kufirin me Kosovën.¹⁰⁵

Duhet të theksohet se të gjitha partitë politike shqiptare në Luginën e Preshevës nuk morën pjesë në zgjedhjet në Serbi në janar të vitit 2007 edhe krahas vendimit të miratuar për nënshkrimin e marrëveshjes gjithë shqiptare për dalje me listë të përbashkët të quajtur “Koalicioni i shqiptarëve – Lugina e Preshevës”.¹⁰⁶ Tre partitë e dala nga UÇPMB gjithashtu e braktisën koalicionin dhe vendosën t’i bojkotojnë zgjedhjet, edhe krahas apelit për pjesëmarrje të njëjtave nga ana e udhëheqësish së Kosovës dhe Shqipërisë.¹⁰⁷

.....
101 Për këtë temë shihni te: International Crisis Group (2006).

102 Programi i këtij organi quhet “Plani Çović” (Çović) sipas emrit të iniciatorit, zëvendës-kryeministrit Nebojsa Čović.

103 Bisedë e zhvilluar në Luginën e Preshevës në nëntor 2006.

104 Sipas Bob Çurçer (Bob Churcher), nuk janë përjashtuar aktivitetet e serishme paraushtarake, pasi që strategjinë që e ndërmori NATO nuk kontribuoi për pajtimin e përhershëm në këtë zonë (Bob Churcher, 2003). Platforma politike e miratuar nga Këshilli i partive politike shqiptare në Luginën e Preshevës në qershor të vitit 2004 e shprehte pakënaqësinë dhe lidhur me statusin e vlerës së tij të vërtetë dhe bënte thirrje për ndryshim të situatës ekzistuese në rajon (shihni te: „Këshilli konsensual politik i partive politike shqiptare të luginës së Preshevës, Platformë – Parimet”), 21 qershor 2004. Bile edhe i politikani i matur Riza Halimi dërgoi thirrje alarmante deri te përfaqësuesit serb të orientuar nga perëndimi për përmirësimin e gjendjes politike dhe socio-ekonomike të shqiptarëve në këtë rajon (Bota sot, 26 qershor 2006).

105 Në vitin 2004 rreth 6.000 refugjatë nga Medvegja ikën në Kosovë. Ekziston mundësi e madhe që ata asnjëherë të mos kthehen në fshatrat e tyre, për shkak të perspektivës së vogël për punësim.

106 E përbërë nga PVD e Riza Halimit dhe Unioni Demokratik i Luginës (UDL) të Skender Destanit.

107 Disa ditë pas shpërbërjes së Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH) të Ragmi Mustafës, Lëvizja e

Edhe krahas mospajtimeve, shqiptarët nga Lugina e Preshevës ngadalë kuptojnë se ardhmëria e tyre është në Serbi, edhe krahas dëshirës së tyre të fuqishme që t'i bashkëngjiten Kosovës. Por, megjithatë kanë qëllim të llobojnë dhe të bëjnë presion mbi elitën kosovare, që ata në kuadër të mundësive ta barazojnë statusin e tyre me atë të serbëve në Kosovë, duke e theksuar mundësinë për bashkimin e Luginës së Preshevës drejt Kosovës, nën hipotezën se e njëjta do të ndahet dhe shumica serbe do të kthehet në Serbi. Në të vërtetë komandanti i KFOR para do kohe pohoi se në rast të trazirave në veriun e Kosovës, nuk përjashtohet mundësia që të aplikohet efekti i dominos në Luginën e Preshevës.

Sa i përket kërkesave politike dhe ideologjike të UÇPMB ose të partive politike shqiptare në këtë rajon, të theksojmë se asnjë manifest, deklaratë ose aksion politik nuk përmban në vete çfarë do qoftë përmbajtje ose mesazhi religjioz.

Por është interesante të vërehet se hamendje të caktuara dhe ngrirja e marrëdhënieve mes liderëve politik shqiptar lidhur me pjesë marrjen e tyre ose mospjesëmarrjen në jetën politike në Serbi e hasim edhe në institucionet islamike në Luginën e Preshevës. Ata po ashtu janë të ndarë në varësi nga qëndrimet e tyre ndaj institucioneve islamike në Serbi. Por, para se ta prekim këtë çështje, të shohim së pari si ka qenë zhvillimi i jetës fetare dhe institucioneve fetare në Luginën e Preshevës.

3.2. Zhvillimi i jetës fetare myslimane dhe institucioneve islamike

Me shpërbërjen e Jugosllavisë, institucionet islamike në Serbi u ndanë në tre tërësi të veçanta administrative: myftinia në Prishtinë, myftinia¹⁰⁸ në Beograd dhe ajo në Sanxhak. Institucione islamike në Luginën e Preshevës, më saktë Bashkësia Islame e Preshevës, Bashkësia Islame e Bujanocit dhe Bashkësia Islame e Medvegjës ende paraqesin pjesë e partisë së BIK.¹⁰⁹ Në këtë mënyrë ata i ruajtën marrëdhëniet e vjetra me BIK, të cilat i kanë pasur para vitit 1990, edhe pse nga pikëpamja territoriale, administrative dhe politike, Lugina e Preshevës është pjesë e Republikës së Serbisë.

Në vitin 2003 pa pas lidhjes së marrëveshjes për demilitarizimin e rajonit, u themelua organizata e re islamike nga ana e një grupi të vogël imamësh: bëhet fjalë për Bashkësinë Islame të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës (BIPBM). Ky institucion u dënua ashpër nga

Progresit Demokratik (LPD) e Jonuz Musliut vendosi të tërhiqet nga gara zgjedhore. Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDK) me seli në Bujanoc, Nexhmedin Saqipi, gjithashtu i bojkotoi zgjedhjet dhe u tërhoq për shkak të rrethanave edhe nga pjesëmarrja në fletë votimet e partive tjera politike. Të gjitha partitë të cilat abstenonin, qartë u deklaruan në dobi të riaktivizimit të projektit për autonomi nga viti 1992. Që të kuptohen argumentet e njëjës apo palës tjetër për (mos)pjesëmarrje në këto zgjedhje, duhet të shihet ritranskripcioni i emisionit televiziv “Shqip” të televizionit shqiptar Top Channel, ku në janar 2007 në një vend i tuboi Ragmi Mustafa, Jonuz Musliu, Riza Halimi dhe Skender Destani. Mund ta gjeni në: <http://www.presheva.com/press/2007/shqip-170107.html>.

108 „Myftinia” është e ekuivalente në gjuhën boshnjake/kroate/serbe, ndërsa në gjuhën shqipe përdoret fjala “myftin” (shih fusnota 6).

109 Bashkësia Islame e Preshevës udhëheq me 24 xhami, ajo në Bujanoc me 18, ajo në Medvegje me 2 xhami.

ana e BIK dhe bashkësive ekzistuese islamike në Luginën e Preshevës. Promotor të saj u trajtuan si “imam shtetëror” ose “bashkëpunëtor të shërbimeve sekrete serbe”.¹¹⁰

Sipas aktorëve të afërt me bashkësinë islame të Preshevës, BIPBM e kishte përkrahjen e qeverisë serbe, pasi që ajo ishte mbështetës i tubimit të institucioneve islame në Luginën e Preshevës dhe të atyre nga Sanxhaku, nga Beogradi dhe nga Vojvodina, në kuadër të strukturës institucionale komunale islame në Serbi. Sa i përket përfaqësuesve të BIPBM, ata e pranojnë faktin se jeta fetare nuk mund të organizohet për shkak të “manipulimeve” të BIK. ¹¹¹

Ish myftiu i Bujanocit, Nexhmedin Saqipi, luajti rol të rëndësishëm në këtë proces. I afërt me Qendrën për Koordinimin me Preshevën, Bujanocin dhe Medvegjën, ai kishte ambicie të cilat para së gjithash ishin politike.

Në të vërtetë, në mars të 2006 ai zyrtarisht e braktisi funksionin myfti që ta krijojë PDK dhe të dalë si kandidat i komunës së Bujanocit. Saqipi theksoi se partia e tij “nuk ka karakter fetar, por politik (...) në të vërtetë, feja nuk duhet të politizohet dhe unë këtë nuk do ta bëj. Feja duhet të ketë ndikim mbi politikën dhe jo anasjelltas”¹¹². Ai i forcon qëndrimet e tija politike, duke e promovuar idenë për autonomi të asaj që quhet “Kosova lindore”,¹¹³ duke e thirrur popullatën të mos marre pjesë në zgjedhjet e fundit në Serbi.

Nga shpartallimi i Jugosllavisë, institucionet islame në Luginën e Preshevës kaluan nëpër krizë të karakterit administrativ dhe fetar. Krijimi i BIPBM reflekton brengosje lidhur me statusin, por gjithashtu, në kuptimin më të gjerë lidhur me situatën e përgjithshme në Luginën e Preshevës. Ishin paraparë edhe zgjidhje tjera në planin fetar, dhe atë: propozim-plane për dy plane me qëllim që të gjendet ndonjë model pas ngjarjeve politike në vitin 1990. I pari, ai i myftiut të Beogradit, ku është përmbajtur institucionalizimi i bashkësisë islame të Serbisë e ndarë në tre rajone, Sanxhak, Lugina e Preshevës dhe rajoni i tretë ku merr pjesë Beogradi, Novi Sadi dhe Nishi. Ky plan u refuzua nga ana e përfaqësuesve të Luginës së Preshevës. I dyti, ai i myftiut të Sanxhakut, parashihte ndarjen në katër rajone, me themelimin e myftinisë së Vojvodinës.

Plani i propozuar nga myftiu i Sanxhakut ishte i pranueshëm për përfaqësuesit fetar shqiptar nga Lugina e Preshevës, por njëkohësisht edhe i hedhur poshtë nga ana e Beogradit, i cili e kontestonte statusin e tërësisë autonome të Vovodinës. Sipas një udhëheqësi të bashkësisë islame në Preshevë, myftiu i Sanxhakut i ka pranuar të gjitha kërkesat e tyre: tërësi territoriale për “Bashkësinë islame të Luginës së Preshevës”, autonomi e gjerë e aktiviteteve të tyre, e drejta për organe të tyre ekzekutive dhe mbajtja e marrëdhënieve të veçanta me BIK. Ky pranim pozitiv i kërkesave shqiptare nga ana e myftiut të Sanxhakut i ngjante qëndrimit të tij personal përkundër Beogradit dhe lidhjet që i kishte me Bashkësinë

.....
110 Belgezim Kamberi, “Njësitë myslimane në Serbi: drejt unifikimit?”, e botuar në Hapi, shtator 2006, e përkthyer nga „ Courier des Balkans “ dhe mund ta gjeni te: <http://balkans.courriers.info/article7023.html>.

111 Ibid.

112 Intervista mund të merret në internet faqen <http://www.bujanocionline.tk> nga 10 marsi 2006.

113 Shih te fusnota 96.

Islame të Bosnjës dhe Hercegovinës. Këtë qëndrim të tij ai e sqaron me nevojën që ta shfrytëzojë mbështetja e bashkësive islame nga Lugina e Preshevës në kuadër të ambicieve të veta që të avancohet në strukturat e ardhshme islamike të përbashkëta të Serbisë. Edhe më shumë, mbështetja e dhënë në këtë plan nga ana e përfaqësuesve fetar shqiptar duket në masë të madhe se ishte e mundur nga BIK, nga shumica e liderëve komunal të klasës politike në luginë, si dhe nga ekipi negocues kosovar për statusin e Kosovës. Në shtator të vitit 2006 në Novi Pazar u mbajt mbledhja e parë në këtë temë me prani të përfaqësuesve të Luginës së Preshevës, atyre të Sanxhakut, nga Beogradi dhe nga Vojvodina.

U dhanë shenja të qarta në kuptimin e zgjerimit të lidhjeve mes bashkësive islame në Luginën e Preshevës dhe pushtetit serb. Tregues i parë donte të thotë kthesë në pozitën e Qeverisë përkundër BIPMB, e cila dukej inkurajuese që nga vetë themelimi. Treguesi i dytë është financimi shtetëror i orëve plotësuese nga lënda religjioni islam, në shkollat shtetërore, të cilat do t'i kryejnë arsimtarë të caktuar nga institucionet lokale islamike.¹¹⁴ Sipas përfaqësuesve të Bashkësisë Islame të Preshevës, më shumë se 90% të nxënësve i ndjekin orët teorike dhe praktike nga feja islame. Këta nxënës shërbehen me doracak të përgatitur nga myftinia e Sanxhakut, e pastaj të përkthyer në gjuhën shqipe. Informata e fundit shkakton nervozë për shkak të bashkëpunimit mes institucioneve islamike në Serbi, qëllimi i të cilave është krijimi i një strukture të decentralizuar në Serbi.

3.3. Përfundim

Ky përfundim, zhvillimi i institucioneve islamike në Luginën e Preshevës tregojnë se zhvillimi në planin politik në Kosovë dhe në Serbi kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi zhvillimin e institucioneve fetare dhe jetën fetare myslimane në përgjithësi. U vërtetua se përfaqësuesit fetar shqiptar i kanë hartuar pozitat e tyre lidhur me ardhmërinë institucionale për zgjedhje të partive dominuese politike.

Mbetet të shihet cili do të jetë fati i BIPMB, e cila është e marginalizuar pas ngjarjeve të fundit. Nëse mbijeton, është e mundur instrumentalizimi i saj nga ana e subjekteve politike shqiptare të cilat përpiqen ta ngjallin projektin për autonomi nga viti 1992. Kjo varet në masë të madhe nga zgjidhja e statusit të Kosovës. Ai pa dyshim do të ndikojë mbi ardhmërinë e Luginës së Preshevës, integrimin e popullatës shqiptare dhe institucionet e saja fetare nën rendin politik-juridik serb. Zhvillimi i këtij procesi është me rëndësi për zhvillimin dhe stabilizimin e skenës politike të Beogradit.

Më në fund, lëvizja neosalafiste duket se shumë e marginalizuar në Luginën e Preshevës, për dallim nga ajo që do të kishim menduar në shikim të parë, duke e shqyrtuar këtë zonë strategjike të transitit dhe kufijve mes shteteve. Një imam i vetëm i cili është shkolluar në Universitetin e Medinës dhe i cili punon në Bujanoc është i lidhur me këtë lëvizje. Predikimet e tija sistematikisht janë përcjellë nga ana e personave përgjegjës pranë bashkësisë islame lokale. Në rast të interpretimit të shtrembëruar të madhhabit hanefist, marrëveshja e tij prej tre deri në gjashtë muaj nuk do t'i vazhdohet (procedurë identike me atë në BIK).

.....
¹¹⁴ Financim i mundur me miratimin e ligjit të ri nga 2004 i cili ka të bëjë me bashkësitë fetare në Serbi.

Fundi i hegjemonisë të PAD-it dhe rrënjëzimi institucional i neosalafizmit

Gzavje Bugarel¹

1 . Evolucionet politike dhe fetare të bashkësisë myslimane/boshnjake deri te Marrëveshja e Dejtonit

Bosnja dhe Hercegovina nuk i iku valës së mobilizimeve nacionaliste të cilat e kapluan hapësirën jugosllave në vitet e '80, siç edhe tregon fitorja e tre partive kryesore nacionaliste na zgjedhjet e nëntorit 1990 (30,4% të votave për PAD-in mysliman/boshnjak², 25,2 % për PDS-n³ serbe dhe 15,5 % HDZ-n⁴ kroate, përkundër 20,5% për partitë qytetare⁵).

-
- 1 Gzavje Bugarell është hulumtues pranë Qendrës Nacionale për hulumtime shkencore (CHRS, UMR 8032 Studime turke dhe islamike, Pariz). Publikimet e tij kryesore janë *Bosnja, anatomia e konfliktit*, (Paris, 1996); Mozaiku i ri boshnjak, identiteti, kujtime dhe kërkesa morale në vendin a pasluftës, Aldershot: ashgate "2006).
 - 2 Në shtator të vitit 1993 një kuvend boshnjak i cili punonte në Sarajevë vendosi ta ndryshon emrin nacional Mysliman me boshnjak. Prandaj e shfrytëzojmë emrin mysliman/boshnjak për periudhën e para luftës dhe asaj të luftës, ndërsa termin boshnjak për periudhën e pasluftës. Në fakt, termi boshnjak është i vetmi i cili referon vetëm në anëtarët e popullit mysliman/boshnjak dhe nuk duhet të përzihet me termin "boshnjak", i cili referon në të gjithë banorët e Bosnjës dhe Hercegovinës.
 - 3 Partia Demokratike Serbe në Bosnje dhe Hercegovinë e udhëhequr nga Radovan Karaxhiq nga viti 1990 deri në vitin 1996. Paraprakisht ai lidhet me partinë me emër të njëjtë në Kroaci dhe në fillim të viteve të '90 ai afrohet me Partinë socialiste të Serbisë (ish Partia Komuniste) të Slobodan Millosheviqit pas fitores së tij zgjedhore në dhjetor të vitit 1990. Në fillim ai deklaronte se është për ruajtjen e Bosnjës dhe Hercegovinës në kuadër të federatës jugosllave, por pas pavarësisë në vitin 1991 ai ishte për ndarjen territoriale të Bosnjës dhe Hercegovinës në bazë etnike.
 - 4 Bashkësia Demokratike Kroate (HDZ) në Bosnje dhe Hercegovinë është shumë e afërt me po të njëjtën parti në Kroaci e formuar në fillim të viteve të '90 nga Franjo Tugjman, e cila fitoi në zgjedhjet në Kroaci në prill. HDZ-ja në Bosnje dhe Hercegovinë u shpreh për pavarësi të kësaj republike, por nga vera e vitit 1992 angazhohet për ndarje territoriale.
 - 5 Në Bosnje dhe Hercegovinë partitë me parashtesën "qytetare" janë parti politike të cilat e kundërshtojnë ndarjen territoriale të Bosnjes dhe Hercegovinës dhe dëshirojnë institucionet boshnjake

Mobilizimi nacionalist i myslimanëve/boshnjakëve fiton forma të veçanta edhe at për dy shkaqe: nga njëra anë, identiteti i tyre nacional, zyrtarisht i pranuar kah fundi i viteve të '60, i cili kristalizohet rreth islamit si shenjë kryesore e identitetit dhe nga ana tjetër Bosnja dhe Hercegovina kishte tre popuj shtetformues (Mysliman/boshnjak, serbë dhe kroat⁶) dhe nga viti 1990 përsëri u bë cak i pretendimeve territoriale nga ana e republikave fqinje, Serbi dhe Kroate.

Këto pretendime së bashku me mospajtimet mes partive nacionaliste rreth ardhmërisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, e sqarojnë fillimin e konfliktit në vitin 1992 ku nacionalistët serb dhe kroat do të kryejnë “pastrim etnik” në mënyrë sistematike. Konflikti do të rezultojë me shpërnguljen e më tepër se gjysma e popullatës, do të shkaktojë 100.000 viktima (85% nga viktimat civile janë mysliman/boshnjak dhe do të mbarojnë në dhjetor të vitit 1995 me nënshkrimin e Marrëveshjes së Dejtonit. Kjo Marrëveshje parasheh ndarje të Bosnjës dhe Hercegovinës në dy pjesë, entitete, Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (e njohur si “Federate kroate-boshnjake”, pasi që ishte e ndarë në 10 kantone – pesë boshnjake, tre kroate dhe dy të “pëzier”) dhe Republika Serbe (RS).

1.1. Partia për Aksion Demokratik (PAD): nga margjina në hegjemoni

1.1.1. Lëvizja islamike në qendrën e bashkimit të elitave politike myslimane/boshnjake

Karakteristika kryesore e Partisë për Aksion Demokratik (PAD) është ajo se në maj të vitit 1990 ajo përbëhet nga anëtarë të lëvizjes islamike të cilët deri atëherë ishin marginal. Në fakt, shumë themelues të PAD-it, duke filluar nga vetë Alija Izetbegović⁷, janë anëtarë të organizatës panislame “Myslimanët e rinj”, e formuar kah fundi i viteve të '30 dhe e pushuar në vitin 1947. Ajo përsëri aktivizohet nga viti 1960 në kuadër të bashkësisë islame në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa kjo gjeneratë e re e islamikëve arin të rekrutojnë simpatizantë të ri mes nxënësve të medresesë së Sarajevës. Në vitin 1990, kapaciteti i kësaj lëvizjeje islame për ta udhëhequr mobilizimin nacionalist të bashkësisë myslimane/boshnjake shpjegohet, para së gjithash me mospajtimin e elitave politike për ta ndërprerë lidhjen me idenë jugosllave dhe me mungesën e institucioneve nacionale myslimane/boshnjake të natyrës laike. Atëherë Bashkësia Islame e mori rolën rolin e institucionit nacional.

të tipit konsociativ të zëvendësohen me tipin “qytetarë” (një qytetar një votë). Partitë kryesore “qytetare” në vitin 1990 janë Partia Socialdemokrate dhe Unioni i Socialdemokratëve boshnjak (USDB).

- 6 Në vitin 1991 Bosnja dhe Hercegovina numëronte 4.364.574 banorë, nga të cilët 43,7% mysliman/boshnjakë, 31,4% serbë, 17,3% kroat dhe 5,5% jugosllaven.
- 7 Alija Izetbegović (1925-2003) ishte anëtarë i “Myslimanëve të ri” dhe për at shkak ishte i dënuar në vitin 1946. Përsëri do të dënohet, së bashku me dymbëdhjetë persona tjerë në vitin 1983, për shkrimin dhe shpërndarjen e një “Deklarate myslimane” me inspirim panislam dhe për organizimin e vizitës së fshehtë të një delegacioni jugosllaven mysliman në Iran. Ai bëhet kryetar i PAD-it, e pastaj edhe kryetar i kryesisë së Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe këtë funksion e kryen deri në vitin 1996.

Në fillim, PAD-i kishte për qëllim ti mbledh të gjithë myslimanët (nga aspekti religjioz) në Jugosllavi, por formimi i partive shqiptare, turke dhe rome solli deri te mospajtimi i kësaj ideje. Në kuadër të popullatës myslimane/boshnjake, e në veçanti të elitave të saj dhe klasës punëtore, lidhja e fortë me idenë jugosllave dhe praktika e ulët religjioze shpjegojnë pse në fillim partia u ballafaqua me përgjigje të kufizuar. Por, pastaj bashkimi i liderëve lokal komunist, siç është Fikret Abdiqi në rajonin e Bihaqit, lidhja objektive e tre partive kryesore myslimane/boshnjake, serbe dh kroate kundër PDS-s dhe mënyra e tyre e inicimit të tensioneve mes bashkësive e shpjegon fitoren e tyre në zgjedhje.

Pasi që erdhën në pushtet, menjëherë pas zgjedhjeve në nëntor të vitit 1990, partitë nacionaliste i ndanë mes vete funksionet edhe vetëm në bazë të përkatësisë së njërës apo tjetrës bashkësi, që solli deri te shumë beteja për mbisundim dhe harxhim të shpejtë të aparatit shtetëror. Por, derisa PDS-ja dhe HDZ-ja e shfrytëzuan këtë për ti vendosur themelet e “republikave” të tyre të vetëshpallura, PAD-i u ballafaqua me kundërshtim të dyfishtë. Nga njëra anë, projekti i tyre nacional kalon nëpër një fazë të pranimit ndërkombëtar të Bosnes dhe Hercegovinës dhe duhet vetëm formalisht ti respekton institucionet ligjore. Nga ana tjetër, në strategjinë e vet për mbisundim PAD-i mbështetet në elitat administrative dhe udhëheqëse të dalura nga Lidhja Komuniste. Themeluesit e PAD-it atëherë janë të detyruar të vendosin rrjete paralele në pushtet, të cilat do tu mundësojnë ta ruajnë kontrollin mbi bashkimin ideologjik të elitave myslimane/boshnjake.

1.1.2. PAD-i vendosën dorën e vet mbi sektorët kryesorë të aparatit shtetëror

Kështu, shpërthimi i luftës në prill të vitit 1992, e pastaj edhe të konfliktit kroato-boshnjak një vit më vonë, e detyruan PAD-in të afrohet me PSD-n dhe me partitë tjera “qytetare”, anëtarët e të cilave hynë në kryesinë kolegjiale në maj të vitit 1992 dhe në qeverinë qendrore në shtator të vitit 1993. Por, faktikisht pushteti konfiskohet nga Alija Izetbegović dhe njerëzit e tij të afërt. Themeluesit e PAD-it, në veçanti, i monopolizojnë ambasadat nëpër botën myslimane apo në shtetet me diasporë të fuqishme boshnjake. Me këtë, ata i kontrollojnë lëvizjet e financimit të luftës, figurë qendrore në këtë punë është Hasan Çengić⁸. Distribucioni i armëve sipas kriterit të përkatësisë ideologjike, më vonë, e shpjegon kapacitetin e PAD-it për ti larguar oficerët që ishin kundër politikës së tyre dhe për ta marrë kontrollin mbi hierarkinë ushtarake.

Proces i ngjashëm ndodh edhe në sektorët tjerë strategjik, siç janë shërbimet sekrete, pastaj vendosja progresive e pushtetit qendror në kuadër të territoreve nën kontroll boshnjake dhe e njëjta shtrihet edhe deri te sektorë të ndryshëm të administratës dhe ekonomisë. Ky proces përshpejtohet akoma më shumë pas formimit të Federatës kroato-boshnjake në mars të vitit 1994. PAD-i atëherë e ndërpret koalicionin e vet me partitë “qytetare” dhe përsëri bën koalicion me partitë nacionaliste, në të cilin PAD-i dhe HDZ-ja, faktikisht, çojnë pushtet pa ndarjen e territoreve të tyre përkatëse. Njëkohësisht, PAD-i do ti bëjë ndryshim të shpejtë të kuadrove të vet, disa nga ato e ndërprejnë lidhjen e tyre me partinë për shkak të mospajtimeve strategjike (menaxhimi me marrëdhëniet kroato-boshnjake, aprovimi apo kundërshtimi i planeve të ndryshme për paqe, etj) apo thjeshtë

.....
8 Hasan Çengić është ish nxënës i medresesë në Sarajevë dhe një nga të akuzuarit në procesin gjyqësor të vitit 1983 (shih në fusnotën nr. 6).

për shkak të rivaliteteve personale, ato u zëvendësuan me profesorë universitar, drejtorë të ndërmarrjeve apo oficerë të lartë, të cilët në PAD shihnin mundësi për ngritje të tyre politike.

Derisa elitat e vjetra komuniste luajnë rol aktiv në shfaqjen e shtetit-parti, lëvizja islamike vazhdon të jetë shfrytëzuesi kryesorë. Nga njëra anë, përfaqësuesit e saj vazhdojnë të kontrollojnë organet kryesore të partisë, si edhe disa sektorë strategjik (diplomacinë, shërbimet sekrete, armatën, etj). Nga ana tjetër, përkatësia në lëvizjen e re islamike apo në vëllazërinë e sufistëve nakshbend⁹, lidhja reale apo e supozuar me ish lëvizjen “Myslimani i ri”, praktikë religjioze që është më e dukshme, janë garanci për hipje të shpejtë në kuadër të partisë dhe aparatit shtetëror. Periudha e luftës, njëkohësisht karakterizohet me përforcimin e hegjemonisë politike të PAD-it në territoret nën kontroll boshnjake dhe me përforcimin e pozitës qendrore të lëvizjes islamike në kuadër të kësaj partie, siç edhe dëshmon margjinalizimi i premierit Haris Sillajgjiq, i cili gjithnjë e më tepër është armiqësisht i kthyer kah praktikat joformale dhe zgjidhjet strategjike të forcave udhëheqëse në PAD.

1.2. Projekti nacional i PAD-it: mes integritetit territorial boshnjak dhe sovranitetit politik boshnjak

1.2.1. PAD-i përkundër përshpejtimit të krizës jugosllave

Gjatë formimit të vet, PAD-i deklarohet për ekzistimin e Jugosllavisë, sepse ajo mundëson përfshirjen e ambicieve islamike të themeluesvetë saj mendjen atë për jugosllavët e elektoratit potencial. Nga kjo epokë, PAD-i e aprovon projektin kroato-sllloven për “konfederalizim” të Jugosllavisë¹⁰. Si do qoftë, atëherë do të ndodh kriza e parë e brendshme, kur ata që angazhoheshin për pranimin e emrit “Boshnjak”¹¹ dhe për definimin laik të identitetit nacional mysliman/boshnjak u larguan nga partia dhe e formuan Organizatën myslimane boshnjake.

Gjatë vitit 1991, përshpejtimi dramatik i krizës jugosllave i detyroi liderët e PAD-it të koncentroheshin në formulimin e projektit të tyre nacional. Dilema e parë strategjike të cilën duhej ta zgjedhin ishte pozicionimi i tyre përkundër federatës jugosllave. Në pranverën e vitit 1991, Alija Izetbegoviqi dhe Kiro Gligorovi, kryetar i Republikës së Maqedonisë, deklarohen për “federatë asimetrike”, duke u pozicionuar në atë mënyrë në mes të projekteve kroato-slllovene dhe ato serbo-malazeze. Por, për liderët e PAD-it, para së gjithash, bëhet fjalë për blerje të kohës në plan të brendshëm dhe të poenëve në plan diplomatik në perspektivën e një konflikti të paevitueshëm. Dëshmi për këtë është ajo se kur PAD-i dhe MBO-ja në gusht

9 Vëllazëria nakshbendi është lëvizje sufiste që shfaqet në Azinë Qendore në shekullin e XIV dhe e cila shënoi zhvillim të dukshëm në Ballkan në shekullin XIX. Ajo është e afërt me besimin sunit dhe është vëllazëria më mirë e vendosur në Bosnje dhe Hercegovinë.

10 Në vitin 1989/1990 Sllovenia dhe Kroacia propozuan “konfederalizim” të Jugosllavisë, duke insistuar në zhdukjen e armatës federale, me çka do të lehtësohet ecja e tyre drejt pavarësisë, ndërsa Serbia dhe Mali i Zi insistonin për projekt federal, duke dashur të forcojnë autorizimet e veta në federatë.

11 Shih në fusnotën 1

të vitit 1991, nënshkruajnë “marrëveshje historike serbo-myslimane”, e cila parasheh që Bosnja dhe Hercegovina të ekziston në kuadër të Jugosllavisë së reduktuar me qëllim që të ruhet integriteti i saj territorial, e njëjta marrëveshje refuzohet nga strukturat qeverisëse të PAD-it. Prej atëherë, partia angazhohet për arritjen e pavarësisë (shpallja e sovranitetit në Parlament në tetor të vitit 1991, organizimi i referendumit për vetëpërcaktim në mars të vitit 1992), opsion që i siguroi përkrahje taktike nga HDZ-ja, por e solli në konflikt direkt me PDS-n. Më në fund, PAD-i kërkoi pavarësi territoriale për rajonin e Sanxhakut, që gjendet në kufirin mes Serbisë dhe Malit të Zi (shih në pjesën 4.2.1).

1.2.2. Konflikti boshnjak dhe sprova për formimin e shtetit nacional mysliaman/boshnjak

Shpërthimi i konfliktit në prill të vitit 1992, “pastrimi etnik” nga ana e forcave serbe, e pastaj edhe nga forcat kroate, pastaj bisedimet për planet paqësore, të cilat parashihnin formimin e disa kantoneve dhe/apo entiteteve etnike e ballafaquan PAD-in me perspektivë shumë më të shpejtë dhe më dramatike për ardhmërinë e popullit mysliaman/boshnjak, gjegjësisht ndarjen e Bosnjës dhe Hercegovinës. Në fillim, PAD-i dhe partitë “qytetare” i refuzojnë edhe planin Kutilero (prill 1992) edhe planin e Vensit dhe Ovenit (janar 1993) në emër të integritetit territorial të Bosnjës dhe Hercegovinës. Në fakt, PAD-i e ruan HDZ-n si partner qeverisës dhe zhvillon hegjemoni të vete në territoret nën kontroll boshnjake. Ky konfigurim do të jetë i kundërt, duke filluar nga pranvera 1993, sepse edhe pas hyrjes të partive “qytetare” në pushtet, liderët e PAD-it duket se i tërheq gjithnjë më shumë ideja për tu tërhequr nga mbrojtja e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ti kushtohen formimit të shtetit nacional mysliaman/boshnjak.

Por, duhet të theksohet se kjo ide nuk është sinonim me formimin e shtetit islamik në të cilën institucionet dhe ligjet do të bazohen në Sheriat. Të vetëdijshëm se mysliamanët në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Ballkan janë pakicë në Evropë, se shumica janë thellë të lidhur me identitetin e tyre evropian dhe në masë të madhe janë laik dhe se çdo orvatje për krijim të shtetit islamik do të ballafaqohet me pengesa të pakalueshme, liderët e PAD-it nuk planifikojnë seriozisht një ide të tillë. Nga ana tjetër, vazhdojnë të flasin për praninë e pakicës serbe dhe asaj kroate në kuadër të një shteti nacional mysliaman/boshnjak. Kjo nënkupton se nuk parashohin politikë të “pastrimit etnik” sistematik, për shkaqe strategjike (përkrahja nga ana e bashkësisë myslimane) dhe morale (përgjegjësia ndaj Kuranit për ti mbrojtur pakicat jomyslimane, etj).

Në këtë kontekst, konflikti i rëndë mes Alija Izetbegoviqit dhe Fikret Abdiqit në kuadër të PAD-it, nuk nënkupton edhe ide të ndryshme për ndarjen territoriale, por bazohet në finalizimin e ndarjes së tillë: Izetbegoviqi dhe njerëzit e tij, duke dëshiruar të formojnë shtet të qëndrueshëm dhe vetekzistues, duan që të kenë qasje në ujërat ndërkombëtarë (Brčko, Neum), Abdiqi, përkundrazi, synon në ndjenjën e besnikërisë të mysliamanëve/boshnjakëve ndaj fqinjëve serb dhe kroat dhe nuk u jep shumë rëndësi çështjeve territoriale. Konflikti mes Izetbegoviqit dhe Abdiqit nuk bazohet mbi principin e integritetit territorial të Bosnjës dhe Hercegovinës, nga i cili, si duket, të dy janë të gatshëm të heqin dorë, por mbi sovranitetin e popullit mysliaman/boshnjak. Dëshmi për këtë është ajo se kuvendi boshnjak i cili u mbajt në shtator të vitit 1993 në Sarajevë, të njëjtën ditë voton kundër planit Oven-Stoltenberg dhe aprovimit të emrit nacional “boshnjak”. Përkundrazi,

në projektin e tyre për formimin e shtetit nacional mysliman/boshnjak, themeluesit e PAD-it nuk ballafaqohen vetëm me partitë “qytetare”, por edhe me disa intelektual nationalist (Rusmir Mahmutqehajiq, etj) dhe oficerë ushtarak (Sefer Halilović, etj) si edhe me përfaqësues të popullatës e cila jeton në rajonet që duhet të ngelin nën kontroll serbe apo kroate. Madje pas formimit të federatës kroato-boshnjake në mars të vitit 1994, kryeministri Haris Sillajxhiq iu kundërshtua politikës së tyre të tejkalimit të institucioneve legale me formimin përsëri të koalicionit PAD-HDZ. Kjo është shkaku për kundërshtimet e fuqishme në kuadër të po asaj bashkësie myslimane/boshnjake për shkak të cilës themeluesit e PAD-it vazhdimisht duhej ta formulonin projektin e tyre nacional dhe të adaptohen në rrethanat e reja. Alija Izetbegovići në këtë kontekst luante rol të dyfishtë, si liderë harizmatik dhe si arbitër.

1.2.3. Integriteti territorial boshnjak dhe/apo sovraniteti boshnjak: riformulim i dilemës historike

Dilema me të cilat ballafaqohen themeluesit e PAD-it gjatë luftës, çojnë deri të një kundërtënie të madhe me të cilën ballafaqohen myslimanët/boshnjakët që nga fundi i kohës otomane dhe e cila i ballafaqon ruajtjen e integritetit territorial të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe afirmimin e sovranitetit politik i cili i takon bashkësisë myslimane/boshnjake. Duke u shndërruar në promotorë të pavarësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe të arritjes së statusit të popullit të boshnjakëve, themeluesit e PAD-it ndalojnë me praktikën e kujdesshme të paraardhësve të tyre. Kuptohet se projektet e tyre fillestare, pavarësia e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe sovraniteti i popullit mysliman/boshnjak shkojnë bashkë, madje edhe parashihen në perspektivën më të gjerë të unionit politik dhe territorial të myslimanëve në Ballkanin Perëndimor. Por, në realitet evolucion i marrëdhënieve të forcës ushtarake dhe bisedimeve për paqe vazhdimisht i detyrojnë të lëkunden apo të bëjnë zgjedhje të dhimbshme mes këtyre dy opsioneve. Në rastin e fundit, vazhdimisht e privilegjojnë termin e dytë, çka bën dallim kyç me partitë “qytetare” dhe nationalistët laik dhe sugjeron se përkatësia e tyre ideologjike, nuk mundet mos ndikon në disa qëllime strategjike.

Nga kjo pikëpamje, marrëveshja e Uashingtonit i cili solli deri të formimi i Federatës në mars të vitit 1994 për PAD-in paraqet një pikënisje shumë e mirë. Kuptohet, formimi i Federatës implikon heqjen dorë nga formimi i shtetit nacional mysliman/boshnjak. Kjo do të dëshpëron disa nga themeluesit e kësaj partie. Por, ajo, gjithashtu, u mundëson liderëve të PAD-it të kthehen kundërtënieve të veta personale, duke i bashkuar territoret nën kontroll boshnjak me perspektivën e reintegrimit institucional të Bosnjës dhe Hercegovinës, ringjalljen e praktikave të koalicioneve me HDZ-n dhe qetësimin e moskuptimeve strategjike me partitë “qytetare” dhe përkrahje diplomatike nga SHBA-t në nivel zyrtar dhe përfitimin e resurseve materiale nga bota myslimane nëpërmjet rrugës jozyrtare, siç edhe dëshmon mënyra e furnizimit me armë nga Irani. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Dejtonit në dhjetor të vitit 1995 nuk paraqet asgjë tjetër, veç një përfundim të procesit të filluar njëzet muaj më parë dhe e hap rrugën për dilema të reja dhe për plotësime të reja strategjike (shih në pjesën 2.2).

1.3. Evolucionet e islamit boshnjak: përforcimi i Bashkësisë Islame dhe implementimi i rrjeteve neosalafiste

1.3.1. Lëvizjet kryesore fetare pas mbarimit të periudhës komuniste

Nga viti 1989/90 një valë e kontestimeve të brendshme në Bashkësinë Islame solli deri te dorëheqja e personave kryesorë përgjegjës, të cilët ishin të lidhur me regjimin komunist dhe u mundëson anëtarëve të lëvizjes islamike të fitojnë një revistë zyrtare javore “Rilindje” (“Preporod”). Por, gjatë organizimit të zgjedhjeve pas kësaj krize, kandidatët të cilët i përkrahte kjo lëvizje hupën. Mustafa Ceriqi nuk arriti të rizgjidhet për reis-ul-ulema i Jugosllavisë përkundër Jakup Selimovskit, me prejardhje nga Maqedonia. Në Bosnje dhe Hercegovinë madje edhe Salih Çollakoviqi, i afërt me idetë neosalafiste, është zgjedhë në krye të institucioneve fetare islame dhe nga viti 1991 përsëri e merr kontrollin mbi “Rilindjen”. Ky mossakses i anëtarëve të lëvizjes islamike për të udhëhequr me institucionet fetare megjithatë duhet të relativizohet. Nga njëra anë, ai nuk e pengon fitimin e përkrahjes nga ulematë e shumtë (kuadrove religjioze) dhe instrumentalizimin e mbledhjeve fetare dhe simboleve gjatë fushatës zgjedhore. Nga ana tjetër, ardhja në pushtet e PAD-it, zhvendosja e Bashkësisë Islame të Jugosllavisë dhe shpërthimi i luftës i ndryshuan fuqitë në kuadër të institucioneve fetare. Në prill të vitit 1993 Selimovski dhe Çollakoviqi u tërhoqën nga funksionet e tyre dhe Ceriqi bëhet reis-ul-ulema i Bosnjës dhe Hercegovinës¹². Personat fetarë, të cilët nuk e dëshironin këtë ndryshim, të lidhur me ishin regjimin komunist apo të afërt me idetë neosalafiste, atëherë do të ndodhen në pozitë defanzive.

Bashkësia Islame në Bosnjë dhe Hercegovinë vazhdimisht ka qenë e goditur nga politikat e “pastrimit etnik” (vrasje të imamëve, shkatërrim sistematik të xhamive, etj) dhe përsëri ndodhet e mëkëmbur nga partia në pushtet, por nga ana tjetër ajo shënon përforcim të dukshëm të kapaciteteve të veta institucionale në territoret nën kontroll të boshnjakëve. Nga njëra anë, institucionet e saj shënojnë rilindje të dukshme, siç edhe tregon hapja e pesë medreseve të reja dhe dy akademive pedagogjike islamike në Zenicë dhe Bihaq, si edhe formimi i myftinjve rajonale. Nga ana tjetër disa ulema do të vendosen në pozita të rëndësishme në kuadër të Qeverisë, sepse premieri Haris Silajxhiq edhe vet ka qenë ish nxënës i medresesë në Sarajevë, në diplomaci, armatë dhe në shërbimet sekrete. Ky përforcim institucional reflektohet edhe në politikat e reislamizimit autoritar të cilat realizohen nga ana e PAD-it dhe Bashkësisë Islame, nëpërmjet implementimit të mësimi fetar nëpër shkolla, prania e imamëve dhe formimi i njësisë fetare në kuadër të ushtrisë apo nëpërmjet shpërndarjes së ndihmës humanitare dhe ndihmës tjetër në para (për familjet e martirëve, bonjakëve, etj) me ndihmën e fondeve që kanë të bëjnë me PAD apo OJQ-t islamike.

.....

12 Teorikisht autoriteti i Bashkësisë së re Islame në Bosnjë dhe Hercegovinë shtrihet prej Sanxhakut deri në Kroaci dhe Slloveni dhe deri te diaspora myslimane / boshnjake. Në praktikë, Bashkësia Islame e Malit të Zi kërkon që edhe ajo ta ketë autoritetin e vet mbi Sanxhakun malazez (shih në pjesën 4.3.1.). Myftinjtë nga Novi Pazari, Zagrebi dhe Lubjana veprojnë në mënyrë mjaft të pavarur dhe disa xhematë (bashkësi lokale fetare) nga diaspora refuzojnë ta pranojnë autoritetin e Bashkësisë Islame. Në vitin 1996 formohet një njësi për diasporën me qëllim që ti mbikëqyrë aktivitetet e xhematëve në diasporë.

1.3.2. Ndikimet fetare në botën myslimane para dhe pas luftës

Në këtë kontekst duhet të shqyrtohet ndikimi i aktorëve të jashtëm ndaj evolucionit të islamit boshnjak. Në fakt, në planin diplomatik, liderët boshnjak nuk hoqën dorë nga përkrahja e fuqive të mëdha perëndimore por edhe nga SHBA-t. Në këtë kontekst, bota myslimane nuk paraqet asgjë tjetër veç se një dorezë për ti nxjerrë nga frenimi i vet po këto fuqi të mëdha, si edhe një burim i madh për financim të luftërave të veta. Në plan ideologjik themeluesit e PAD-it nga viti 1980 mbajnë marrëdhënie ideologjike me Republikën Islame të Iranit, me vëllezërit mysliman sudanez dhe me islamikët turk. Njësitë fetare të armatës boshnjake ishin të furnizuara me rojtarët e revolucionit iranian dhe Fatih el Hasanejn, sudanez i afërt me regjimin në Kartum, i cili luan rol kyç në vendosjen e rrjeteve paralele për financim të PAD-it (shih në pjesën 1.1). Por, nëse Irani dhe Sudani në atë mënyrë kontribuojnë për konsolidimin e shtetit – parti të ri, ata nuk duan në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndikojnë në evoluimin e islamit boshnjak.

Për ti kuptuar ndikimet e botës myslimane në evoluimin e islamit boshnjak, duhet prej së afërmi ti kuptojmë konfigurimet e brendshme të Bashkësisë Islame. Në vitet e '80, për ndikimin e intelektualëve modern mysliman të cilët jetonin në Perëndim kanë dëgjuar disa ulema të ri boshnjak (Mustafa Ceriq, Enes Kariq, etj), ndërsa idetë neosalafiste janë prurur nga ulematë tjerë të rinj të lidhur me botën arabe (Salih Çollaković, Halil Mehtiq, etj). Duke filluar nga viti 1990, të parët politizohen dhe afrohen me lëvizjen islamike – Ceriqi është njëri nga themeluesit e PAD-it dhe do të bëhet reis-ul-ulema duke i falënderuar përkrahjes që i dha kjo parti, ndërsa Kariqi bëhet ministër i arsimit dhe kulturës, para se ta përkrahën Haris Silajxhiqin dhe të ndahet nga PAD-i në vitin 1996. Ndërsa neosalafistët, përforcohen në pozitat e tyre në kuadër të institucioneve fetare islame. Në atë mënyrë disa myftinj janë të lidhur me lëvizjen neosalafiste.

Njëkohësisht, neosalafistët boshnjak bashkohen me OJQ-t islamike dhe me rrjetet xhihadiste të ardhura në Bosnje dhe Hercegovinë, duke filluar nga viti 1992 me pëlqimin e liderëve të PAD-it dhe Bashkësisë Islame. Myftiu nga Zenica, Halil Mehtiq, në atë mënyrë bëhet mbrojtësi kryesorë i Bosnjës Qendrore dhe mbështetet në resurset e tyre materiale për ta zgjeruar ndikimin e vet personal. Ky lloj i lidhjeve me personat përgjegjës fetar lokal u mundëson aktorëve neosalafist me prejardhje nga bota myslimane ti realizojnë politikat e tyre për reislamizim – të bazuara në xhihadin e tyre, shpërndarjen e kushtëzuar të ndihmës humanitare, organizimin e mësimi fetar dhe promovimin e konceptit të vet për islamin. Por, kjo dëshirë për të ndikuar në islamin boshnjak pas një kohe të shkurtë do të shkakton tensione. Kështu, pas disa ndeshjeve rreth asaj se a duhet të lejohen disa praktika sufiste, muxhahedinët e huaj u tërhoqën nga njësitë fetare të armatës boshnjake dhe u grupuan në kuadër të njësisë “el-Muxhahed”. Madje edhe mënyra me të cilën disa rrjete xhihadiste dhe OJQ të caktuara e kontestojnë monopolin e institucioneve fetare dhe vlefshmërinë e *madhhabit hanbalist* (shkollës juridike) apo në kuptimin më të gjerë vërejtjet për disa shprehje, zakone (vendosja e thasëve me kafe tek ata që shesin alkool, sulm ndaj çifteve që puthen në vende publike, etj) shkaktojnë reaksione te forta në kuadër të Bashkësisë Islame dhe popullatës. Këto tensione rriten akoma më shumë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Uashingtonit dhe Dejtonit, sepse xhihadistët këto marrëveshje i shihnin si heqje dorë nga qëllimi i tyre për të formuar shtet islamik në Bosnje dhe Hercegovinë dhe si tradhti nga ana e liderëve të PAD-it. Fakti se Marrëveshja e Dejtonit parashihte largim të gjithë luftëtarëve të huaj vetëm i rriti zhgënjimet e tyre, edhe pse në muajt që vijuan pas mbarimit të konfliktit qindra muxhahedinë fitojnë shtetësi boshnjake.

2. Evoluimet politike të bashkësisë boshnjake pas Dejtonit

Në dekadën pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit, Bosnja dhe Hercegovina shënon evolucione të rëndësishme politike. Nga njëra anë, trupat e përbashkët gradualisht përforcohen (unifikimi i doganave dhe forcave të sigurisë, formimi i instancave qendrore dhe zgjerimi i autorizimeve të qeverisë qendrore, reforma kushtetuese e vitit 2002 me të cilën zgjerohet karakteri kushtetues i popullit boshnjak, serb dhe kroat në tërë territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës, etj), edhe pse entitetet dhe kantonet ruajnë një pjesë të madhe të autorizimeve dhe resurseve fiskale dhe se praktikat joformale që u paraqitën në fillim të viteve 90-ta e shënojnë funksionimin e institucioneve. Nga ana tjetër, peizazhi politik boshnjak copëtohet dhe bëhet i llojllojshëm, tre partitë më të rëndësishme nacionaliste e hupin pozitën hegjemoniste në kuadër të bashkësive që u përkasin. Por, megjithatë, jeta politike ngelën nën dominimin e ndarjes sipas bashkësive dhe nacionaliteteve.

Këto evoluime të peizazhit politik boshnjak nuk mundet të sqarohen duke mos u marrë parasysh dëshira e bashkësisë ndërkombëtare për të ndikuar në vendosjen e brendshme. Dëshmi për këtë është ajo se çdo përfaqësues i lartë paraqet asociacion për ndonjë strategji në këtë lëmi: mandati i Karl Bildit (1996-97) u shënua në atë mënyrë me leje relative për atë që ekziston, ndërsa mandati i Karlos Vestendorp (1997-1999) me ikje masive kah “autorizimet e Bonit” (imponim të masave ligjore, tërheqjen e të zgjedhurve, etj), mandati i Volfang Petriqit (1999-2002) me idenë e “pronësisë” (ownership) dhe përvojën e Lidhjes për ndryshime dhe mandati i Pedi Eshdaun (2002-2006) me shfrytëzimin e proceseve integruese dhe euroatlantike si mënyrë e re për kryerjen e shtypjes mbi partitë nacionaliste të cilat u kthyen në pushtet. Por, ata gjithashtu e reflektojnë edhe faktin se efektet sociale të luftës kanë tendencë të zbutjes (ringjallja e lirisë së lëvizjes, rindërtimi i pasurisë së patundshme, etj), por ata gjithashtu ngelin shenja të kohës. Numri i “kthimit të pakicave” zvogëlohet, në veçanti duke filluar nga viti 2003. Numri i tyre i përgjithshëm mes viteve 1996 dhe 2006 është më pak se një e katërta e personave të zhvendosur gjatë luftës.

2.1. Humbja zgjedhore e PAD-it dhe humbja e ideologjisë së zërit boshnjak

2.1.1. Humbja zgjedhore e PAD-it dhe copëtimi i peizazhit politik

Pas mbarimit të luftës, PAD-i shënon krizë të re të brendshme, Haris Silajxhiqi jep dorëheqje nga pozicioni premier dhe formon partinë e vet, Partia për Bosnje dhe Hercegovinë. Megjithatë, forcimi i PAD-it gjatë luftës do të jetë dëshmi se gjatë zgjedhjeve në shtator 1996 ata do të kenë dominim të dukshëm të trupi zgjedhor boshnjak: ai faktikisht do të fiton 54,3% të votave të Federatës, përkundër 7,4% për PBH, 7,9% për PSD-n dhe 25,5% për HDZ-n kroate.¹³ Në vitin 1998 ai e maskon rënien e vet duke i falënderuar koalicionit me CBH-n dhe partitë tjera më të vogla (49,2% në Federatë, përkundër 16,8% për PSD-n dhe 19,9% për HDZ-n), por pastaj do të shënon rënie të vërtetë, si në përqindje (26,8% në vitin 2000, 32,7% në vitin 2002 dhe 25,5% në vitin 2006), ashtu edhe në numrin e votave

.....
13 Këto përqindje janë njehësuar në bazë të rezultateve në zgjedhje.

të fituara, duke fituar vetëm 218.400 vota në Federatë në vitin 2006, përkundër 725.800 votave dhjetë vjet më herët. Madje PAD-i u gjet në opozitë prej vitit 2000 deri 2002, sepse atëherë Federate udhëhiqej nga ana e Aleancës për ndryshime, para se të kthehet në pushtet duke i falënderuar koalicionit me CBH-n dhe HDZ-n. Më në fund PAD-i bie edhe në Republikën Serbe, nga 16,3% të votave (177.400) në vitin 1996 në 3,4% (19.100) në vitin 2006.¹⁴ Në rastin e fundit, rezultatet zgjedhore e pasqyrojnë faktin se gjithnjë e më tepër refugjatë boshnjak nuk votojnë në RS me qëllim që përsëri të regjistroheshin në Federatë.¹⁵

Rënia zgjedhore e PAD-it, paralelisht me LSD-n dhe HDZ-n, mundet të lidhet me dy tendenca të mëdha: rritjen e shpejtë të numrit të votuesve që i bojkotojnë zgjedhjet nga njëra anë, në kontekst të mobilizimit të nacionalizmit dhe largimi i rritur i elitave lokale politike; dhe nga ana tjetër copëtimi i peizazhit politik i ilustruar me shumimin e ndarjeve të brendshme në tre partitë nacionaliste. Në rastin boshnjak, nga rënia e PAD-it përfiton së pari PSD-ja dhe PBH-ja, të cilët në vitin 2000 fitojnë 26,1% gjegjësisht 14,9% të votave. Por, pas humbjes së Aleancës për ndryshime e formuar rreth PSD-s dhe PBH-s, PSD-ja shënon ngecje të vazhdueshme (15,6% në vitin 2002, 15,2% në vitin 2006), ndërsa PBH-ja edhe më tutje shënon rritje (15,3 % në vitin 2002; 22,2% në vitin 2006). Kjo lëvizje duket më qartë gjatë zgjedhjeve të anëtarit boshnjak në kryesinë e përbashkët: Alija Izetbegoviqi në mënyrë triumfale zgjidhet në vitin 1996 (80,0% të votave) dhe në vitin 1998 (86,8%), por Sulejman Tihiqi (PAD) mezi e fitoi Haris Silajxhiqin (PBH) në vitin 2002 (37,3% përkundër 34,8%). Ky i dyti në mënyrë eklatante do ti hakmerret katër pesë vjet (62,8% përkundër 27,5%). Së fundi, duhet të ceket hyrja në pushtet e partive të vogla, siç janë Partia patriotike boshnjake (PPB), parti me orientim ultra-nacionalist (4,1% të votave në vitin 2006, të përqendruara në Bosnjën Qendrore), Partia Boshnjake (BOSS), parti e dalë nga PSD-ja dhe me orientim nacionalist (3,2% e votave në vitin 2006 të përqendruara në kantonet në Sarajevë dhe Tuzël), apo Bashkësia Demokratike popullore – BDP) e cila i mbledhi simpatizantët e Fikret Abdiqit (16,8% e votave në kantonin e Bihaqit në vitin 2006¹⁶).

2.1.2. Rënia e ndarjeve ideologjike dhe paraqitja e PBH-s si “parti nxitëse”

Pas mbarimit të luftës, ndarjet ideologjike në kuadër të bashkësisë boshnjake, dhe në forma të ndryshme, bashkësia serbe dhe kroate – ngelin të njëjta si edhe në vitin 1990, madje ka edhe ndarje mes partive nacionaliste dhe “qytetare” nga njëra anë, antikomuniste dhe neo-komuniste nga ana tjetër. Këto ndarje çojnë deri te kundërshtime të tipit sociologjik (popullatë rurale përkundër popullatës urbane, besimtarë përkundër mosbesimtarë, etj) apo deri në ndarje gjeografike (rajone malore përkundër luginave dhe baseneve industriale, rajone ku ka ndodhur masakrat e Luftës së Dytë Botërore përkundër rajoneve ku kanë ndodhur lëvizjet e partizanëve, etj). Mes viteve 1996 dhe 2006 ndarjet ideologjike kanë tendencë të komplikohen, siç dëshmon edhe ndryshimi i trupit zgjedhorë nga njëra

.....
14 Këto përqindje janë njehësuar në bazë të rezultateve nga zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës Serbe.

15 Madje edhe një numër i madh i boshnjakëve që jetojnë jashtë nuk marrin pjesë në zgjedhje dhe numri më i madh i njësive të PAD-it të themeluara jashtë vendit gjatë luftës më pas zhduken.

16 Këto parti të vogla, ekzistenca e së cilëve favorizohej nga rregullat e sistemit kompleks zgjedhor dhe nga akumulimi i zhgënjimeve mes popullatës, tregonin nacionalizëm dhe demagogji gjatë procesit zgjedhor para se të hynin në bisedime për tu dhanë përkrahje partive të mëdha.

anë dhe formimi i koalicioneve qeveritare në baza gjithnjë më pragmatike nga ana tjetër. Kushtetuta nga viti 2000 e Aleancës për ndryshime, e cila ish-komunistët e PSD-s i asocion me partitë e paraqitura nga ndarjet e brendshme të PAD-it dhe HDZ-s dhe me partitë e vogla ultranacionaliste, siç është PBP-ja, paraqet ilustrim të mirë për këtë proces. Orvatja e pasuksesshme e Sulejman Tihiqit gjatë vitit 2006 për promovim të koalicionit PAD-PSD, i cili është për reforma progresive të institucioneve (shih në pjesën 2,2), mundje të paraqet sukses, por u ballafaqua me rezistencë të vazhdueshme mes kuadrove dhe militantëve të PAD-it (shih në pjesën 2.3).

Prej atëherë, partitë të cilat më shumë kishin mundësi për përfitime nga situata komplekse e jetës politike në Bosnje dhe ti kanalizojnë zhgënjimet e bashkësive të tyre ishin ato që kishin mundësi ti bashkojnë lëvizjet nacionaliste dhe kërkesat e ndërkombëtarëve, kontestimin gjyqësor dhe shpërndarje klienteske të resurseve dhe të marrin pozicion “nxitës” në peizazhin politik. Në rastin me bashkësinë boshnjake, kjo pozitë “nxitëse” të cilën e ka PBH-ja, e cila edhe pse mori pjesë në koalicionet qeveritare të formuara në Federatë me PAD-in (1996-2000, 2002-2006) apo me PSD-n (2000-2002), dinte tu ikën “votimeve gjobuese” nga të cilat pësonin PAD-i dhe PSD-ja. Paralelisht, Haris Sillajxhiqi u imponua si lideri i ri harizmatik i bashkësisë boshnjake, kur ajo pozitë ngeli e zbrazët me tërheqjen e Alija Izetbegoviqit nga jeta politike në vitin 2001 dhe pas vdekjes së tij dy vjet më vonë dhe për shkak se Sulejman Tihiqi nuk arriti të imponohet si lider, madje edhe në kuadër të partisë së vet.

Veç kësaj, evolucioni i peizazhit politik boshnjak rezultoi gjithashtu edhe me rekonponime më të thella socio-ekonomike. Kështu PSD shënon ndryshime të bazës së vet tradicionale zgjedhore (klasa punonjëse dhe elitat urbane punonjëse) dhe u tregua si mjaftë e paaftë për tu imponuar te gjeneratat e reja. Madje edhe rritja e rejtingut të PBH-s sqarohet me faktin se shumica e funksionarëve të lartë, drejtorët e ndërmarrjeve dhe personat e ri afaristë kuptuan se kanë interes që të jenë me partinë “nxitëse”, e cila merr pjesë në të gjitha koalicionet qeveritare. Së fundi, zhgënjimet e akumuluar dhe roli kyç i organizatave ndërkombëtare në arbitrazhe të caktuara buxhetore, grupet e forta të interesit të përkrahura nga PAD-i pas luftës (refugjatë, ish luftëtarë, etj) distancohen nga partia dhe përqendrohen në mbrojtjen e interesave të vet statusorë. Humbja relative e ideologjisë së zërit boshnjak pasqyron edhe disa transformime të thella në shoqërinë boshnjake të pasluftës dhe hasi në mëshirën e evolucionit të zërit serb dhe kroat.

2.2. Dalja graduale nga toka e shtetit-parti dhe kthesa pragmatike e PAD-it

2.2.1. Etapat kryesore të kthimit pragmatik të PAD-it

Edhe pse ndarjet e periudhës komuniste gradualisht hupen, peizazhi boshnjak politik ngelën kryesisht i strukturuar rreth sfidave të luftës, partitë kryesore politike vazhdojnë ta kundërshtojnë ardhmërinë institucionale të Bosnjës dhe Hercegovinës. Nga viti 1996 PAD-i e zbulon kontekstin e ri të atëhershëm në strategjitë ambivalente të pasluftës karakteristike për periudhën pas krijimit të saj. Kështu, kjo parti e paraqiti jolegjitimitetin radikal të RS-s, por përsëri në Federatë çon koalicioni PAD-HDZ-PBH dhe kontribuon në ndarjen e shoqërisë

boshnjake nëpërmjet legalizimit të okupimit të pasurisë së patundshme dhe instalimin e refugjatëve nga Bosnja Lindore në Sarajevë. Gjithashtu, insistimi i tij për ta transformuar Bërçkon në zonë neutrale, apo ribashkimin e Mostarit mundet të interpretohet ose si reintegrim institucional gradual të Bosnjës dhe Hercegovinës ose si masë për ndjekjen e qëllimeve territoriale të definuar në vjeshtë të vitit 1993 (shih në pjesën 1.2.2).

Gjatë viteve të ardhshme derisa presioni ndërkombëtar mbi tre partitë kryesore nacionaliste rritet, PAD-i është i detyruar ti zbusë qëndrimet e veta. Nga njëra anë, përkrahja e tij për koalicionin *Sloga* i formuar në vitin 1998 rreth Milorad Dodiçit dhe Aleancës së social-demokratëve të pavarur dhe implikimi i tij në procesin e kthimit i filluar në vitin 1999 e detyruan, në mënyrë indirekte dhe të përkohshme, ta pranon ekzistimin e RS-s. Nga ana tjetër përforsimi i Federatës e detyron të tërhiqet nga pozita e vetë e përvetësimit të aparateve të sigurisë dhe disa shërbime fiskale, ndërsa PAD-i atëherë do të kënaqet me mbajtjen e ndarjes së rreptë sipas bashkësive në disa sektorë kyçë për afirmimin e identitetit boshnjak nacional (duke filluar nga arsimimi), si edhe hegjemoni në kantonet boshnjake. Kthesa pragmatike e filluar nga PAD-i, para së gjithash paraqet përgjigje të daljes progresive i shtetit-parti gjatë periudhës së luftës.

Kjo kthesë strategjike e PAD-it duket gjatë periudhës 2000-2006 gjatë kalimit të pushtetit mes Alija Izetbegoviçit dhe Sulejman Tihviçit në kuadër të kryesisë kolegjiale boshnjake por edhe në kryesinë e partisë (shih në pjesën 2.3.2). Kjo simbolizohet me pranimin e së paku bashkimit formal të institucioneve të sigurisë në nivel shtetëror dhe me transformimin e PAD-it në parti multi-etnike gjatë Kongresit të saj të katërt në vitin 2005. Dhjetë vjet pas mbarimit të luftës, PAD-i duket se e ka lënë për më vonë reintegrimin e tërësishëm institucional të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe afirmimin e tërësishëm të sovranitetit politik të popullit boshnjak, për ti privilegjuar reformat institucionale që i mundësojnë Bosnjës dhe Hercegovinës, domethënë vet boshnjakëve, të marrin pjesë në procesin e integrimi euro-atlantike. Ky evolucion njëkohësisht rezulton me vazhdueshmëri relative në disa pjesë të politikës së jashtme (shih në pjesën 1.3.2) dhe marrje parasysht të periudhës së pasluftës, e cila u bë e paevitueshme me mbarimin e procesit të kthimit. Ajo gjithashtu i pasqyron edhe marrëdhëniet mes bashkësisë ndërkombëtare, sepse PAD-i ngeli në margjinat e lojës politike nga Volfang Petriç mes viteve 2000 dhe 2002, pastaj u rehabilitua nga ana e Pedi Eshdaun, si bashkëbisedues i barabartë.

2.2.2. Nacionalizmi dhe fitorja zgjedhore e Haris Sillajxhiqit në vitin 2006

Evolucioni i PAD-it drejt qëndrimeve pragmatike dhe përkrahja e proceseve integruese euro-atlantike nuk ndryshojnë dukshëm nga partitë tjera politike në Bosnje dhe Hercegovinë, duke i përfshirë këtu edhe LSD-n dhe HDZ-n. Por megjithatë, sa i përket partive kryesore në Bosnje, disa dallime kontribuojnë për ti kuptuar rikomponimet zgjedhore mes viteve 1996 dhe 2006. Kështu, praktika politike e PBH-s është e afërt me atë të PAD-it, por fjalimet e saj bëhen të thata, sepse PBH-ha vazhdon të kërkon abolicion të entiteteve dhe në bazë të kësaj kërkesë realizohej edhe fushata zgjedhore në vitin 2006. Ky dallim ka të bëjë me dallimet strategjike në të cilët dallojnë Haris Sillajxhiqi dhe liderët e PAD-it kah fundi i luftës (shih pjesën 1.1.2). Por, ky dallim mundet të sqarohet edhe me çështje të thjeshta të strategjisë zgjedhore dhe oportunitetit politik: nga njëra anë, suksesi zgjedhor i PBH-s varet pjesërisht nga këto ide nacionaliste; nga ana tjetër, PBH-ja është parti “nxitëse” që

shpesh herë merret si parti e “qendrës” nga ana e aktorëve ndërkombëtar. Kjo parti nuk i nënshtrohet presionit të Përfaqësuesit të lartë, siç është rasti me PAD-in. Sa i përket PSD-s, ajo vazhdon të jetë partia më e lidhur për idenë e Bosnjës dhe Hercegovinës me shumë bashkësi dhe luan rol aktiv në procesin e kthimit. Por, orvatjet e saj për ruajtjen e përkrahjes nga ana e bashkësisë ndërkombëtare (në veçanti në epokën e Aleancës për ndryshime) dhe për gjetjen e partnerëve mes partive politike serbe në RS e detyrojnë të mban pozitë mjaft pragmatike, duke hapur kështu hapësirë për idetë nacionaliste të partive të vogla, siç është BOSS-i (shih në pjesën 2.1.1).

Në atë kontekst duhet të shihet edhe debati kushtetues i cili dominonte në fushatën zgjedhore në vitin 2006. Në vitin 1998, Alija Izetbegović, i cili atëherë ishte anëtar i kryesisë kolegjiale boshnjake, kërkoi reforma kushtetuese me çka do të zgjerohet karakteri kushtetues i boshnjakëve, serbeve dhe kroatëve ndaj tërësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, ky ndryshim në fund u imponua nga ana e Volfang Petriqit në vitin 2002. E përforcuar nga përkrahja e Izetbegovićit dhe për shkak se e favorizonte procesin e kthimit, kjo reformë përkrahej nga PSD-ja dhe PBH-ja. Në vitin 2006 projekti i ri reformues për të cilin bisedohej me ndërmjetësim të SHBA-ve, i cili kishte për qëllim ti përforcon autorizimet e institucioneve shtetërore duke mos e kontestuar ekzistimin e entiteteve, nuk fitoi konsensus. Ky propozim jo vetëm që u hodh poshtë nga ana e PBH-s, e cila në këtë propozim pa legjitimim indirekt të RS, por madje ajo shkaktoi edhe ndeshje të fuqishme në kuadër të PAD-it, duke e tërhequr njërin nga deputetët e vet. Debati rreth reformës kushtetuese në vitin 2006 pasqyron një rekonponim të dyfishtë. Në fakt, kthesa pragmatike e PAD-it e favorizon afrimin e saj me PSD-n, siç edhe dëshmon evokimi nga ana e Sulejman Tihiqit për koalicion të mundshëm PAD-PSD. Por, njëkohësisht akumulimi i zhgënjimeve ndaj bashkësisë ndërkombëtare dhe thellimi i dallimeve mes projektit fillestar dhe pragmatizmit të ri të PAD-it, i mundësoi PBH-s të tërheq një pjesë të trupit zgjedhorë të kësaj partie, para se të merr pjesë nga pozita e forcës që përsëri të kyçet në koalicionin PAD-PBH-HDZ. Më në fund, debati kushtetues në vitin 2006 nuk mund të kuptohet duke mos u marrë parasysh rekonponime tjera komplekse mes fraksioneve të brendshme në PAD, nga njëra anë (shih pjesën 2.3.2) dhe nga ana tjetër mes partisë dhe Bashkësisë Islame (shih pjesën 3.1.3)

2.3. Lëvizja islame mes ngritjes dhe marginalizimit

2.3.1. Faktorë të jashtëm dhe të brendshëm që ndikuan në rënien e lëvizjes islame

Pas luftës, lëvizja islame fiton pozitë qendrore në kuadër të PAD-it dhe në kuadër të aparatit shtetëror, siç edhe dëshmon Edem Biçkaçiq, njëri nga nxënësit e medresesë në Sarajevë, i cili u bë kryeministër dhe emërimi i Hasan Çengiqit për zëvendës ministër i mbrojtjes në shkurt të vitit 1996, apo emërimi i shumë anëtarëve të lëvizjes islame për deputet të Kuvendit në vitin 1996. Centralizimi i kësaj lëvizjeje kontribuon edhe për afrimin e PAD-it me Bashkësinë Islame. Shumë kuadro të Bashkësisë islame të afërt me lëvizjen islame apo me ata të cilët kanë qenë luftëtarë në ndonjë nga njësitë fetare në armatën boshnjake, hyjnë në instancat kryesore të partisë.

Gjatë viteve të ardhshme, lëvizja islame shënon rënie në ndikimin e saj në aparatet shtetëror dhe në parti. Kjo rënie ndodhi për shkak të paraqitjes së disa faktorëve, nga të cilët më evident është dëshira e aktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë për ta copëtuar jetën politike boshnjake. Nga viti 1996, SHBA-t e kushtëzojnë implementimin e programit të tyre për ndihmë ushtarake me tërheqjen e Hasan Çengiqit dhe ndërprerjen e çdo lloj bashkëpunimi me Iranin në lëmit e mbrojtjes. Në vitet në vijim, përfaqësuesit e lartë Vestendorp dhe Petriq tërheqin nga funksionet shumë figura të rëndësishme të lëvizjes islame, siç janë Edem Biçakçiq, i cili në ndërkohë u bë drejtor i ndërmarrjes publike Energoinvest apo Mirsad Belaxhiq, guvernator i kantonit të Bihaqit. Dhe më në fund, gjatë periudhës së Aleancës për ndryshime, disa ish persona përgjegjës në aparatet e sigurisë të lidhur me lidhjen islamike akuzohen për aktivitete terroriste. Nga ana tjetër, implikimi i institucioneve ndërkombëtare financiare dhe OJQ-ve perëndimore në procesin e rindërtimit dhe kthimit të refugjatëve e forcojnë pozitën e elementeve pragmatike në vet PAD-in.

Përveç faktorëve të jashtëm, rënia e lëvizjes islamike ka të bëjë edhe me rënien e përgjithshme të PAD-it. Nga njëra anë ndërprerja e armiqësive, zhdukja progresive e shtetit-parti e vendosur gjatë kohës së luftës dhe rënia zgjedhore e PAD-it e lejnë këtë lëvizje pa resurse materiale, të cilat i kishin në dispozicion për të qenë në qendër të rikomponimit të elitave në bashkësinë boshnjake (shih pjesën 1.1.1). Nga ana tjetër, kohezioni i kësaj lëvizjeje kontestohet për shkak të mospajtimeve të brendshme. Në fakt, deri në vitin 1996 njëra nga fuqitë e lëvizjes islamike ishte kohezioni i saj i fortë, gjatë kohës i bazuar në veprimin gjysëmlegal dhe në lidhjet familjare apo vëllazërore, të ballafaquar me fraksione tjera të natyrës së ndryshme. Megjithatë, në periudhën e pas luftës, disa anëtarë apo “pasardhës” të lëvizjes islamike vazhdojnë të kenë funksione të rëndësishme në kuadër të partisë, aparatit shtetëror dhe/apo afarizmit, ndërsa të tjerë janë politikisht të marginalizuar. Kjo situatë i ushqen vërejtjet në vet lëvizjen islamike dhe fillon një konflikt rreth vendimeve për politikën e jashtme, rëdefinimin e projektit nacional të PAD-it apo integrimin e ish elitave komuniste në atë parti.

2.3.2. Lëvizja islamike pas largimit të Alija Izetbegoviqit: të vazhdohet me PAD-in apo të dilet?

Deri në fund të vitit 1990 Alija Izetbegoviqi vazhdon të jetë mbrojtësi më i madh i lëvizjes islamike, para bashkësisë ndërkombëtare dhe në kuadër të partisë, njëkohësisht duke i qetësuar zënkat e brendshme dhe duke imponuar koncesione të caktuara. Kështu, në vitin 1996 ai vendosën ta pranon ndihmën ushtarake amerikane në dëm të lidhjeve me Iranin dhe e kërkon dorëheqjen e Çengiqit. Madje edhe gjatë Kongresit të tretë të PAD-it në tetor të vitit 2001, Izetbegoviqi duke u kujdesur për ta ruajtur përkrahjen e SHBA-ve, edhe pse në atë kohë SHBA-t e filluan “luftën kundër terrorizmit”, e emëroi farefisën e tij, i cili nuk kishte asnjë lidhje me lëvizjen islamike, Sulejman Tihqi, si pasardhës të tij në parti. Tërheqja politike, e pastaj dhe vdekja e Izetbegoviqit në fillim të vitit 2000, e dobësojnë akoma më tepër lëvizjen islamike dhe e sjellin në rangun e fraksionit mes fraksioneve tjera në parti, në të cilën kjo lëvizje dominonte më shumë se një dekadë. Ardhja e Tihiqit në PAD, vendimet që u sollën në Kongresin e katërt të partisë në vitin 2005 (transformimi i partisë në “multietnike”, refuzimi të vendosën në të njëjtin plan fashizmi dhe komunizmi, bashkëngjitja me Partinë popullore evropiane, etj), përkrahja e dhënë për

projektit e reformës kushtetuese me ndërmjetësim të SHBA-ve paraqesin disa sinjale se lëvizja islamike e humbën ndikimin e vet. Kjo bën që lëvizja islamike të ketë akoma më tepër shkaqe ti hakmerret Tihiqit.

Humbja e ndikimit të lëvizjes islamike në kuadër të PAD-it në fakt edhe nuk është sinonim i marginalizimit të plotë. Nga ana tjetër, disa anëtarë akoma ndodhen në trupat udhëheqës të partisë, edhe pse qasja e tyre deri në status të caktuar shkon krah për krahë me kujdesin politike. Nga ana tjetër në periudhën e luftës lëvizja islamike rekrutoi aktivistë të rinj dhe edhe pse kantonet janë strehimoret e fundit të shtetit-PAD-it, po në eshalonët e mesme të aparatit partiak kjo lëvizje është më mirë e vendosur. Këto evolucione çojnë deri te ndryshimi i konfiguracionit të brendshëm të PAD-it: gjatë formimit të vet në vitin 1990, lëvizja islame kishte kapacitet shumë të kufizuar, por dominonte në organet kryesore të partisë; gjashtëmbëdhjetë vjet më vonë, ajo ka humbur një pjesë të madhe të kontrollit, por arrin që ta përforcon pozitën e vet në instancat rajonale dhe bazën militante. Kjo situatë e ballafaqon lëvizjen islamike me dilema dhe konflikte të reja: derisa disa largohen nga PAD-i dhe orvaten të themelojnë parti islamike, të tjerët vazhdojnë ta çojnë betejën brenda në PAD me qëllim që ta marrin kontrollin.

Duke i marrë parasysh këto evolucione të cilat janë karakteristike për lëvizjen islamike pjesërisht i nxjerr në pah rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2006. Kështu, Partia popullore boshnjake (PPB) paraqet orvatje të parë për tu themeluar parti specifike islamike në Bosnje dhe Hercegovinë. Rezultati i zgjedhjeve të cili e arrin kjo parti është shumë modest (0,5% e votave, gjegjësisht 4.346 vota, prej të cilave gjysma janë në Bosnjën Qendrore) dhe kjo tregon se sa hapësirë ka për një parti të tillë¹⁷. Disfata e PPB-s është në kundërshtim me kapacitetin e anëtarëve të saj nga lëvizja islamike, së bashku me fraksione tjera të brendshme në PAD dhe disa persona na Bashkësinë Islame, që në mënyrë diskrete ti detyrojnë votuesit e PAD-it të votojnë për Haris Sillajxhiqin në vend të Sulejman Tihiqit. Megjithatë, strategjitë e kufizuara përta marrë përsëri udhëheqjen me PAD-in u treguan edhe ma faktin se në muajt në vijim kishte zgjedhje dhe Tihiqi, nënkuptohet duhet të heq dorë nga ideja për koalicionin PAD-PSD, por refuzon që të cakton Kongres të jashtëzakonshëm të partisë dhe e vazhdon të jetë liderë i partisë. Në atë kontekst, nuk është befasi që një numër i madh i anëtarëve të lëvizjes islamike tërhiqen nga jeta politike për tu kthyer përsëri në Bashkësinë Islame apo për tu marrë me shoqatën “Myslimanët e rinj ‘39” e cila rrënjët e veta i ka qysh në vitin 1930. Por kjo shoqatë nuk mundet ti konkurren lëvizjes neosalafiste apo lëvizjeve sufiste dhe neosufiste¹⁸.

.....
17 Veç asaj, një pjesë e mirë e votuesve potencial të Partisë popullore boshnjake padyshim se kanë preferuar të votojnë për Partinë patriotike boshnjake (shih në pjesën 2.1.1), parti ultranacionaliste e cila në rradhët e veta kishte shumë anëtarë nga lëvizja neosalafiste.

18 Lëvizjet kryesore neosufiste turke rrjedhin nga vëllazëria *nakshbendi* (shihe fusnotën 8) dhe janë zhvilluar gjatë shekullit 20 dhe funksionojnë më tepër në mënyrë joformale për dallim nga vëllazëritë tradicionale sufiste.

3. Evolucionet fetare të bashkësisë boshnjake pas Dejtonit

3.1. Ripozicionimi i rëndë institucional i Bashkësisë Islame

3.1.1. Disfatë e politikave të islamizimit totalitar

Politikat për islamizim totalitar të realizuara gjatë luftës kontribuojnë në përforcimin e lidhjeve mes identitetit fetar dhe nacional të boshnjakëve, të cilat pjesërisht ishin të ndara gjatë pesëdhjetë viteve të komunizmit.

Ata madje çojnë deri te ndryshimi i hapësirës për artikulum të islamit mes hapësirës publike dhe private, ashtu siç praktikimi i fesë ka qenë i kufizuar në hapësirën private gjatë periudhës komuniste dhe kjo bëhet shumë e evidente, madje edhe e tepërt, duke filluar nga viti 1990. Por, orvatjet për reislamizim të identitetit nacional boshnjak çojnë deri te “nacionalizimi” i islamit, gjë që u vërtetua me formimin e Bashkësisë së re Islame e dedikuar ekskluzivisht për popullatën boshnjake (shih në pjesën 1.3.1) apo valorizimin e disa praktikave të famshme (këngë fetare, shkuarja në haxhillëk, etj) të cilat më para kanë qenë të emëruara si “heterodokse” nga ana e lëvizjes islamike¹⁹. Madje çdo herë kur politikat për reislamizim dalin nga definicioni i identitetit kolektiv të boshnjakëve duke u orvatur të ndikojnë në sjelljet private, ata hasin në rezistencë të madhe, siç edhe tregojnë disa polemika rreth martesave të përziera dhe festimi i disa festave jomyslimane. Së fundi, doke të caktuara fetare kolektive (festa fetare, haxhillëku, hapja solemne e xhamive, etj.) nuk donë të thotë se implikojnë rritje automatike të praktikimit individual të fesë – në situata të rënda ekonomike numri i besimtarëve të cilët paguajnë zeqatë (tatim fetar) madje ka edhe tendencë të rënies. Rikomponimet fetare të periudhës së luftës nuk janë sinonim të reislamizimit të popullatës boshnjake, procesi i laicizmit të cilin popullata e njëjta në periudhën komuniste ngelën të jetë i pakthyesëm.

3.1.2. Bashkësia Islame mes ringjalljes dhe krizës në identitet

Në plan institucional Bashkësia Islame është larg gjetjes së vendit të cilin e kishte gjatë Luftës së Dytë Botërore: aluzionet e rralla për ringjallje të gjyqeve të sheriatit për çështjet e statusit personal shkaktuan reaksione të ashpra dhe kthimi i vakëfeve (fondacione islamike) të nacionalizuara në vitin 1947 hasi në pengesa të shumta ligjore dhe praktike. Institucionet fetare, gjithashtu, kanë probleme serioze për të gjetur resurse financiare dhe punëtorë të kualifikuar për ti realizuar idetë e tyre (rinovim të xhamive të shkatërruara dhe hapjen e qendrave islamike në lagjet socialiste, zhvillimin e institucioneve arsimore karakteristike për Bashkësinë Islame dhe mësim fetarë në institucionet publike, etj.). Që atëherë ata shfrytëzojnë ndihmë financiare dhe stipendione nga vende të caktuara myslymane (monarki, Iran, Turqi, etj.) si mënyrë më e mirë për tu ballafaquar me problemet e veta, duke pritur tu kthehen vakëfet, të rriten të ardhurat nga zeqatë dhe paraqitja e gjeneratës së re të ulemave.

.....
¹⁹ Shih te Ksavie Bugarel (2001)

Në fund, Bashkësia Islame do ta humbë monopolin mbi jetën fetare dhe rolin e institucionit nacional që e kishte gjatë periudhës komuniste: institucione të ndryshme me karakter laik bëjnë konkurrencë në artikullimin e identitetit nacional boshnjak (Kongresi i intelektualëve boshnjak, shoqata kulturore “*Rilindja*”, etj.) dhe paraqiten një numër i madh i aktorëve fetar, qoftë ato të jenë lokal apo nga bota myslimane, Rrjetëve të xhihadistëve të ardhur gjatë kohës së luftës u bashkëngjiten edhe lëvizje të ndryshme fetare. Pos vëllazërive ekzistuese sufiste (së pari kashbendi) paraqiten edhe lëvizje të reja neosufiste me prejardhje nga Turqia²⁰. Kuptohet se nga fundi i viteve të '90 shumica e OJQ-ve islamike largohen nga Bosnja dhe Hercegovina, ndërsa rrjetet xhihadiste kalojnë në veprimtari gjysëmlegale (shih në pjesën 3.2.1). Por pushteti nuk i ndalon organizatat të cilat e shfrytëzojnë emrin “islamik” pa lejen e Bashkësisë Islame dhe se duhet të adaptohet në ekzistimin e aktorëve fetar të cilët ajo nuk i kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Ringjalljen të cilën e përjetoi Bashkësia Islame gjatë luftës e maskoi krizën latente dhe problemet e vazhdueshme gjatë ripozicionimit në rrethinën thellë të ndryshuar. Evolucionet e pasluftës vetëm i thelluan këto kriza. Nga njëra anë, institucionet fetare, mezi i plotësonin nevojat e gjeneratave të reja fetare, nga të cilët ata që kanë qenë të marginalizuar apo të traumatizuar gjatë luftës kyçen në lëvizjen neosalafiste, ndërsa personat tjerë të cilët janë më mirë të integruar gravitojnë kah lëvizjet sufiste dhe neosufitiste (shih në pjesën 3.2.). Pas shkatërrimit të shtetit-parti të formuar nga PAD-i dhe zvogëlimit të ndihmës financiare nga bota myslimane pas atentateve të 11 shtatorit 2001 dhe presionit të vazhdueshëm nga ana e diplomacisë amerikane, akoma më tepër kufizohen resurset materiale të Bashkësisë Islame, derisa gjenerata të reja të ulemave dalin nga institucionet arsimore të saj dhe universitetet islame. Edhe pse një pjesë e kuadrove të Bashkësisë Islame integrohen në kuadër të institucioneve fetare, kalimi nga periudha deficitare me kuadro të kualifikuara në periudhë suficitare pjesërisht shpjegon pse shumohen betejat e fraksioneve dhe zënkat për legjitimitet. Kjo shpjegohet edhe me faktin se gjatë zgjedhjeve për reis-ul-ulema në vitin 2005, Mustafa Ceriqi nuk fiton më tepër se 180 vota, përkundër 119 votave të fituara nga kundër kandidati i tij, Enes Kariq, i cili në ndërkohë bëhet dekan i Fakultetit për shkenca islamike në Sarajevë. Në fakt, ky i fundit e akuzon të parin se interesohet më tepër për jetën politike apo për vetë promovim, se sa për problemet e brendshme të Bashkësisë Islame dhe në atë mënyrë ai i kanalizon të gjitha zhgënjimet dhe shqetësimet materiale të një numri të mirë të imamëve. Por, ballafaqimi Ceriq – Kariq duhet njëkohësisht të shihet në një kontekst më të gjerë të themelimit të PAD-it (shih në pjesën 2.3.1) dhe në kontekst të diferencimit doktrinal të islamit boshnjak (shih në pjesën 3.2.2).

3.1.3. Komplikimi i marrëdhënieve mes Bashkësisë Islame dhe PAD-it

Në periudhën a pas luftës, Bashkësia Islame përjeton komplikim të marrëdhënieve të veta me PAD-in. Në vitin 1996 bashkëpunimi i tyre i ngushtë karakterizohet me praninë e dyanshme të personave të shumtë në organet kryesore, të cilët janë të lidhur apo jo me lëvizjen islamike. Por, nga fundi i viteve të '90, prania e disa personave fetarë në parti tjera politike (PBH, PPB, etj) dhe akumulimi i zhgënjimeve që kanë të bëjnë me statusin e institucioneve fetare apo kthimin e vakëfeve kontribuojnë në dobësimin e lidhjeve ekzistuese mes Bashkësisë Islame dhe PAD-it. Autoritetin personal të cilën e posedonte

.....
20 Shih në fusnotën 17.

Alija Izetbegoviqi nga njëra anë, armiqësia e përbashkët ndaj Aleancës për ndryshime nga ana tjetër, shpjegon pse institucionet fetare e përkrahnin PAD-in dhe Sulejman Tihiqin gjatë zgjedhjeve në vitin 2002. Por largimi i Izetbegoviqit dhe ardhja e Tihiqit në krye të PAD-it dhe akumulimi i kthesës së tij pragmatike sollën deri te largimi i bashkësisë Islame nga PAD-i e shprehur nëpërmjet mospjesëmarrjes në Kongresin e Katërt të PAD-it në vitin 2005.

Ky evolucion nuk shpjegohet vetëm me konfliktin i cili në kuadër të PAD-it i ballafaqonte Tihiqin me lëvizjen islamike (shih në pjesën 2.3.2), edhe pse kjo lëvizje vazhdon të ruan funksione të rëndësishme në organet e Bashkësisë Islame, por ajo nuk mund të pajtohet me Ceriqin i cili bëri kompromis me ulematë të cilët ishin të lidhur me regjimin komunist dhe e përkrahën kandidaturën e Kariqit në vitin 2005. Kështu, formimi i peizazhit politik boshnjak i detyroi institucionet fetare të prezantohen si aktorë që janë të vendosur “mbi partitë”, por nuk u mundëson përsëri të negociojnë nga pozita e forcës për lidhjet e tyre të privileguara me PAD-in, apo tua ofrojnë vendin e tyre partive tjera politike. Madje edhe kthesa pragmatike e PAD-it dhe zhdukja e institucioneve nacionale të natyrës laike i nxitë që të orvaten ta gjejnë rolin e tyre të mëparshëm si institucion nacional. Kjo dëshmohej edhe me implikimin e tyre të fuqishëm në kultin e luftëtarëve të vrarë (shehidë) apo në mbrojtjen e ofiqarëve boshnjak të akuzuar nga Gjyqi penal ndërkombëtar për ish Jugosllavi. Në atë kornizë duhet të vendoset edhe përkrahja e disa personave fetarë e në veçanti Ceriqi i cili e përkrahte kandidaturën e Haris Sillajxhiqit në zgjedhjet e vitit 2006. Kështu, Bashkësia Islame në fillim e përkrah projektin për reforma kushtetuese për të cilin negocionte Tihiqi, por liderët e saj ishin mjaft armiqësisht të pozicionuar ndaj transformimit të PAD-it në parti “multietnike” apo formimin e koalicionit PAD-PSD, sepse ngjarjet e tilla rrezikojnë që Bashkësia Islame ti hupë privilegjet institucionale të cilat i fitoi gjatë luftës (shih në pjesën 1.3.1). Nga ky moment, në interes të tyre është që Tihiqi të dobësohet në dobi të ndonjë kandidati tjetër, i cili do të jetë përparësi me atë që është ish kuadër i Bashkësisë Islame.

3.1.4. Strategjia evropiane e reis-ul-ulema Mustafa Ceriqit

Së fundi, një evolucion krejtësisht ndryshe është i rëndësishëm për Bashkësinë Islame kur flasim për pozicionimin e saj në hapësirën evropiane. Në periudhën e pasluftës, me ndërprerjen e ndihmave nga bota myslimane dhe me hyrjen e Bosnjës dhe Hercegovinës në procesin e integriteteve euro-atlantike i detyrojnë udhëheqësit e Bashkësisë Islame gjithnjë e më tepër të kyçen në debatet ekzistuese për islamit evropian. Kështu, Mustafa Ceriqi nga viti 1997 merr pjesë në Këshillin evropian për *fatva* dhe hulumtime i cili duhet ta lehtëson adaptimin e së drejtës shëriate me statutin e pakicave myslimane në Evropë. Në vitin 2005 në Londër prezantohet “Deklarata e myslimanëve evropian” e cila orvatet të vendos baza doktrinale të islamit evropian (shih në pjesën 1.3.2)²¹. Kjo strategji evropiane, promotor kryesor i së cilës është Ceriqi, ka dimension të dyfishtë, nacional dhe fetar. Nga njëra anë, ajo dëshiron ti vendos myslimanët boshnjak në qendër të islamit evropian dhe në atë mënyrë të përforcohet legjitimiteti i tyre politik dhe rëndësia e tyre strategjike në Evropë. Nga ana tjetër, ajo ka për qëllim të kompenson zvogëlimin e ndihmës financiare që vinte nga bota myslimane me financim evropian. Bashkësia Islame ofrohet si model

.....
21 Shih në tekstin “Deklarate e myslimanëve evropian” në gjuhën angleze <http://www.rijaset.ba>.

për formimin e institucioneve fetare në shtetet e Evropës Perëndimore²² dhe parasheh të siguron arsimim për ulematë a atyre institucioneve. Kjo strategji do të hasë në kritika të shumta. Kështu, disa intelektual laik dhe fetar, mes të cilëve edhe Enes Kariqi, do ta kritikojnë Ceriqin se e pengon formimin e boshnjakëve si popull në tërësi, me qëllim që të ngelin vetëm “milet mysliman” në Evropë. Persona të shumtë përgjegjës në *Bashkësinë Evropiane* mendojnë se kjo bashkësi, para së gjithash, duhet të merret me dobësitë e veta, e jo të arsimohen ulematë e Evropës Perëndimore, me çka në Bosnjë dhe Hercegovinë përsëri të importohen zënkat dhe rivalitetet gjeopolitike të botës myslimane.

3.2. Ngritja e neosalafizmit dhe llojllojshmëria doktrinale e islamit boshnjak

3.2.1. Ngritja dhe llojllojshmëria e brendshme e lëvizjes neosalafiste

Paralelisht me nevojën për ripozicionim në planin institucional, Bashkësia Islame ballafaqohet edhe me lëvizjen neosalafiste. Prania e kësaj lëvizjeje vërehet në vitet e '80, por ajo u përforcua gjatë luftës, duke i falënderuar ardhjes së OJQ-ve islamike dhe rrjeteve xhihadiste (shih në pjesën 1.3.2). Zhvillimi i saj vijon pas luftës, në forma të cilat duhet të precizohen mirë, sepse lëvizja neosalafiste ndahet në lëvizje neosalafiste e tipit xhihadist dhe lëvizje e tipit fetar.

Lëvizja xhihadiste zhvillohet rreth muxhahedinëve të huaj dhe boshnjakëve të ri të cilët kanë luftuar në kuadër të “el-Muxhahid”. Nga viti 1996 të njëjtit rigrupohen në forcat serbe apo në fshatrat e lëshuar kroate apo nëpër qytete duke iniciuar lëvizje për të rinj, siç është Rinia aktive islame me revistën e saj “Saff”. Pas kthesave në vitin 1999 dhe 2000, largimi i OJQ-ve islamike, forcimi i represionit policor dhe paraqitja e lëvizjeve neosufiste të gjeneratat e reja, lëvizjen xhihadiste e vendosin në pozitë defensive. Fshatrat Guçja Gora (Travnik) dhe Boçinja (Maglaj) atëherë lihen, por grupe tjera islamike vendosen në disa fshatra boshnjake, siç është Shehiqi (Zenicë) apo Maoça (Brčko). Madje edhe RAI paralajmëronte se do të shkatërrohet, por qendrat e saja kulturore për të rinjtë dot vazhdojnë me aktivitete si edhe revista “Saff”²³. Lëvizja xhihadiste duhet të shihet edhe si matricë e organizuar politike, e cila do të kryen disa atentate kundër kroatëve në fund të viteve '90 (pa dyshim se ndonjëherë ato janë kryer me dijeninë e shërbimeve sekrete) dhe e përkrahën xhihadin në Çeçeni, por nuk e sulmon as pushtetin lokal as interesat perëndimore. Për degën delikuede shembull më i mirë është francezi i cili ka kaluar në islam Lionel Dimon, i cili hyn në konfrontim të drejtpërdrejtë me policinë lokale.

Ky diferencim i brendshëm i lëvizjes xhihadiste vlen edhe për vitin 2000. Kuptohet se hyrja në pushtet e Aleancës për ndryshime në vitin 2000 dhe pasojat lokale të “luftës kundër terrorizmit” – simbolikisht e shprehur me dorëzimin e gjashtë algjerianëve në vitin 2002, te

22 I rëndësishëm është fakti se prezantimi i dytë i “Deklaratës së myslimanëve evropian” u bë në shkurt të vitit 2006 në Zagreb: Bashkësia Islame ka pozitë të fortë institucionale në Kroaci dhe myslimanët/boshnjakët kanë vend të garantuar në Kuvend si “pakicë e re nacionale”.

23 Njëkohësisht, lëvizja boshnjake rrënjëzohet në diasporën boshnjake, siç tregojnë edhe lëvizjet e lidhura me AIO – Shoqata e myslimanëve në Amerikën Veriore në SHBA, Rinia islamike dhe xhematët e pavarur në Evropën Perëndimore, etj, si edhe lokalizimi i internet faqeve xhihadiste në shtetet perëndimore.

lëvizja xhihadiste ngjallë dëshirën për ti qëruar hesapet me pushtetin lokal. Por, kontrolli i rreptë policor, presionet e ndryshme nga ana e personave fetarë dhe lëvizja neosafaliste e karakterit fetar dhe disa zgjedhje taktike karakteristike për lëvizjen xhihadiste, nuk lejuan që xhihadistët të ndërmarrin aksione. Prej atëherë rriten dallimet mes krahut të matur dhe atij ekstremist, i afërt me lëvizjen “Takfir-val-Hijra” dhe lëvizjen “Al kaeda”²⁴. Lëvizja e parë është përfaqësuar nga ish AIO apo “Vëllazëria myslimane” e cila e dënon terrorizmin dhe nuk donë të merr pjesë në xhihadin në Irak dhe gradualisht integrohet në peizazhin politik dhe fetar të vendit, për çka dëshmon edhe evolucioni i revistës “Saff” dhe radios “Naba”. Kjo dyta funksionon në mënyrë plotësisht joformale dhe jolegjitime, duke shfrytëzuar disa nga “emiratet islamik” si bazë për risocializim intensiv dhe mbështetjet në predikues apo internet faqe me afat të kufizuar të ekzistencës²⁵. Kjo radio pa dyshim i inspiroi katër xhihadistët të cilët u arrestuan në vitin 2005 në Sarajevë deri sa përgatiteshin për atentate vetëvrasëse.

Evolucionet e lëvizjes më të matur kanë të bëjnë me shumë me rikompozimet e brendshme të Bashkësisë Islame. Menjëherë pas luftës, gjenerata e parë e neosafalistëve boshnjak do të marginalizohet në kuadër të Bashkësisë Islame, ndërsa Halil Mehtiqi do të tërhiqet nga funksioni si myfti i Zenicës në vitin 1997, si edhe Salih Çollakoviqi i cili formon qendër të vete islamike në Mostar. Por, njëkohësisht, gjenerata e re e ulemave nën ndikimin e ideve neosalafiste shënon zhvillim të shpejtë, siç edhe tregon rasti i Nezim Haliloviqit, ish imam nga provinca i cili tani ka më shumë funksione, edhe atë imam kryesor i xhamisë në Sarajevë, e ndërtuar nga Arabia Saudite, përgjegjës për organizatën hajji dhe drejtor i administratës për vakëfet. Para së gjithash, kah fundi i viteve të '90, disa studentë të cilët ktheheshin nga universitetet e gadishullit arap luajnë rol të rëndësishëm në jetën fetare (përkthim dhe botim i literaturës fetare, botimin e revistës “Horizonte të reja” – pjesëmarrje në internet faqe të ndryshme islame, etj) dhe në vet institucionet fetare (ndikim dominues në akademitë pedagogjike islamike në Zenicë dhe Bihaq, depërtimi i tyre në organet udhëheqëse të Bashkësisë Islame, etj). Kjo lëvizje neosalafiste, për Bashkësinë Islame, para së gjithash, paraqet sfidë të dyfishtë. Nga njëra anë, duke mos e kontestuar *madhhabi hanefist*, siç bënin xhihadistët, këto përfaqësues të jetës lokale fetare mundësojnë qasje deri te literatura për islamin, duke insistuar në ligjet e sheriatit. Nga ana tjetër, ata mbështeten në njohjen më të mirë të gjuhës arabe dhe shkencat islamike për ta kontestuar legjitimitetin e ulemave të shkolluar gjatë komunizmit.

3.2.2. Vendi i lëvizjes neosalafiste në doktrinën e islamit boshnjak

Ky zhvillim i lëvizjes neosafaliste i detyroi komponentët tjerë të Bashkësisë Islame të përqendroheshin rreth kësaj lëvizjeje dhe kjo solli deri në rikomponimin global të islamit boshnjak. Duket se, në fakt, liderët e Bashkësisë Islame dhe, para së gjithash, Mustafa Ceriqi, u adaptuan me rrënjëzimin e kësaj lëvizjeje në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në vitet

.....
24 Lëvizja “Takfir-val-Hijra” është krahu ekstremist i lëvizjes Vëllezërit mysliman në Egjipt, të cilët i inspiruan vrasësit e kryetarit Anuar-el-Sadat në vitin 1981. Prej atëherë u zgjerua në vende tjera myslimane dhe bashkësi në Evropën Perëndimore dhe u afrua me lëvizjen “Al kaeda”.

25 Xhemati “Tevhid” i animuar në Vjenë nga imami Muhamed Porça, mendohet të jetë një nga foletë kryesore prej ku ky krah ekstremist i përhap idetë e veta në Bosnjë dhe Hercegovinë, Sanxhak dhe në diasporë.

e para të pas luftës, Ceriqi dukej i vendosur në luftën kundër neosalafistëve, siç edhe dëshmon tërheqja nga funksioni e Halil Mehtiqit apo orvatja për ta monopolizuar përsëri termin “islamik” nga ana e Bashkësisë Islame. Por, nga fundi i viteve të ’90 u arrit kompromis joformal mes institucioneve fetare dhe lëvizjes neosalafiste. Kështu, Bashkësia Islame e dënon represionin ndaj ish muxhahedinëve dhe xhihadistëve lokal, por i bindë që të mos ndërmarrin aksione të dhunshme dhe i detyron që ta pranojnë *madhhabin hanefist* në Bosnje dhe Hercegovinë. Para së gjithash, Bashkësia Islame lejon që neosalafistët e matur të luajnë rol gjithnjë më të madh në këtë bashkësi, duke parë mundësi për të mbajtur marrëdhënie të mira me shtetet islame të pasura me naftë, ta risin nivelin e kualifikimit të ulemave dhe ta forcon autoritetin e vet te gjeneratat e reja të besimtarëve.

Kjo strategji mundëson përforcimin e kontrollit të Bashkësisë Islame mbi disa aktivitete të caktuara fetare (mbledhja e zeqatave, organizimi i haxhillëkut, shkollimi i imamëve, etj.) dhe e kufizon ndikimin e lëvizjes xhihadiste. Për shembull, shumica e predikuesve të cilët ishin të lidhur me lëvizjen neosalafiste, në vitin 2005, e dënuan praktikën e „makfir²⁶“-it. Ajo i lehtëson dhe i shpreshton debatet dhe kompromiset e para mes ulemave me orientim modern dhe ato me orientim islamik dhe neosalafist, siç edhe u tregua në vitin 2005 kur u formua Këshilli i *fatvave* apo aprovimi i “Rezolutës për shpjegim të islamit” në Bosnje dhe Hercegovinë. Njëkohësisht, ky rekonponim i islamit boshnjak e shpejton formimin e lëvizjeve moderne islamike. Kështu, Mustafa Ceriqi, duket se është larguar nga pozitat moderne të cilat ai i përkrahte në fillim të viteve të ’90 për të ndjekur një linjë “qendrore” apo “të matur islamike”, e cila e bashkon karakterin laik të shtetit dhe investimin në hapësirën publike të institucioneve fetare, valorizim të disa dokeve “heterodokse” dhe implementim të disa pikave nga doktrina neosalafiste. Këtë qëndrim “safalist” me sa duket e ndajnë shumica e myftinjve, posaçërisht ato të gjeneratës së parë të neosalafistëve boshnjak (Seid Smajkij në Mostar, Hasan Makiq në Bihaq, Nusret Abdibegović në Travnik). Ajo ballafaqohet me humor armiqësor nga ana e disa ulemave modern të cilët insistojnë më shumë se çdo herë që Bashkësia Islame të çlirohet nga jeta politike nga njëra anë, ti ruan karakteristikat e islamit boshnjak përkundër sulmeve të neosalafistëve nga ana tjetër. Përfaqësuesit kryesorë të kësaj lëvizjeje moderne janë Enes Kariq, Fikret Karqij dhe Reshid Hafizović, ndërsa bastioni i tyre është Fakulteti për shkencë islamike në Sarajevë, ndërsa nga mediet përkrahës janë mediet e pavarura dhe revistat “Mësuesi i ri” dhe “Shenjat e kohës”.

Çështja e pozicionimit përkundër ngritjes së neosalafizmit do të shihet në kuadër të lëvizjes islamike, ku, disa, me sa duket do të afrohen me neosalafistët, ndërsa të tjerë haptazi do ti dënojnë. Së fundi, edhe pse rrethet sufiste dhe neosufiste, ritet e të cilëve kritikohen si “heterodokse” nga ana e lëvizjes neosalafiste, janë të brengosur nga kjo linjë e re e përçarjes. Në atë mënyrë, disa intelektual që janë të lidhur me rrethe sufiste (Reshid Hafizović, Rusmir Mahmutqehajiq, etj) do të mbështesin një version shumë më liberal të sofizmit. Kjo mundet të shihet pjesërisht te fehellakët dhe nurkutët, ndërsa nakshbendët dhe sulejmanët ngelin të afërt me lëvizjen islamike. Akoma më tepër, ritet sufiste në Bosnje dhe Hercegovinë mundësojnë fenomene të çuditshme të hibridizimit, disa predikues apo

.....
26 “Takfir” (anatemë) është një kualifikim në kuadër të bashkësisë myslimane të disa kundërshtarëve “qafirë” (të pafe, apostat) që eventualisht mundet të implikojnë se ekziston e drejta që ai të vritet.

imam lokal të cilët në fjalimet e tyre kanë elemente neosalafiste megjithatë në ritet fetare përdorin elemente sufiste. Ndërsa, nga ana tjetër, boshnjakët e rinj të cilët kanë marrë pjesë në njësinë ushtarake “El muxhahid” gjatë luftës apo në AIO nga fundi i viteve të '90, më vonë u kyçën në lëvizjet sufiste dhe neosufiste dhe i dënuan praktikën dhe idetë e lëvizjes neosalafiste. Prej atëherë, ngritja e tyre duhet të shihet në një kontekst shumë më të gjerë të përçarjeve të brendshme të bashkësive islame dhe më gjerë.

3.2.3. Dy sfidat afatgjate: statusi personal islam dhe islami evropian

Në këtë kontekst duhet të cekem debatet ekzistuese në kuadër të institucioneve fetare. I pari i përket statusit të sheriatit në Bosnje dhe Hercegovinë, ndërsa i dyti islamit në Evropë. Ulematë boshnjak njëzëshëm e pranojnë karakterin laik të shtetit në Bosnje dhe Hercegovinë, ndërsa ideja për formimin e shtetit islamik ngelën e kufizuar në lëvizjen xhihadiste dhe në shikim të parë konkretizohet me disa “emirat islamik” të cilët këtë lëvizje e animojnë. Nga ana tjetër, disa ulema me orientim neosalafist apo islamik dëshirojnë ti japin fuqi ligjore sheriatit për të gjitha çështjet e brendshme në Bashkësinë Islame dhe çështjet e statusit personal (martesa, ndarjet, trashëgimia, etj). Në atë mënyrë, vetë Mustafa Ceriqi përkujton në mundësinë për vënien e kurorëzimeve në bazë të sheriatit por në bazë vullnetare, ndërsa myftinjtë e Bihaqit, Mostarit dhe Travnikut kërkuar nga Këshilli i fatvave të shprehet për ligjshmërinë e poligamisë në Bosnje dhe Hercegovinë. Këto orvatje për promovim të idesë për status islamik personal shkaktuan reaksione të ashpra nga ana e ulemave me orientim modern, siç ishte edhe Fikret Karqiq, të cilët vlerësojnë se sheriatit në shtetin laik duhet të praktikohet vetëm te vlerat morale, duke mos pasur fuqi ligjore.

Çështja e statusit të sheriatit ka të bëjë edhe me debatin rreth islamit evropian. Madje, ulematë boshnjak insistojnë njëzëri në natyrën evropiane të islamit boshnjak dhe nevojën që i njëjti të vendoset në hapësirën politike dhe kulturore evropiane. Por, kjo njëzëshmëri në vete fsheh disa paradokse dhe mospajtime. Kështu, shkatërrimi i Jugosllavisë dhe ndarja e Bosnjës dhe Hercegovinës e fusin islamin boshnjak në probleme që janë karakteristik edhe e islamit në përgjithësi. Ndërsa procesi i integritetit euroatlantik e çon drejt problematikës së islamit ku ai është pakicë. Më konkretisht, Mustafa Ceriqi në strategjinë e vet evropiane mbështetet në persona (Jusuf el-Karadavi, Tarik Ramadan, etj) dhe organizata (Këshilli mysliman i Britanisë së Madhe, Mili gorush, Lidhja e organizatave islame në Francë, etj) të cilat i përkasin lëvizjes së matur islamike. “Deklarata e tij për myslimanët evropian” fillon duke e dënuar terrorizmin dhe myslimanët evropian i definojnë si qytetarë besnik të shteteve ku jetojnë, por kërkon nga këto shtete tu lejojnë myslimanëve të organizohen në bashkësi (hapjen e shkollave myslimane, fitimin e statusit special personal, praninë e “përfaqësuesve legjitim”²⁷ në kuvendet e vendeve anëtare të BE-s, etj). Po për këtë ai do të akuzohet se e kthen statusin e boshnjakëve në “miletin mysliman në Evropë” (shih në pjesën 3.1.4).

.....
27 Ky termin “përfaqësues legjitim” përdoret nga PAD-i në Mal të Zi dhe në Kroaci me qëllim që pakica nacionale boshnjake të ketë vende të rezervuara në Kuvendet e këtyre shteteve. Për rastin e Malit të Zi shih pjesën 4.2.2, ndërsa për at kroat shih në fusnotën 21.

4 . Rasti specifik i bashkësisë myslimane/boshnjake në Sanxhak

Në vitin 1990, mobilizimi nacionalist i myslimanëve / boshnjakëve në Sanxhak²⁸ ishte i lidhur ngushtë me atë të myslimanëve/boshnjakëve në Bosnje dhe Hercegovinë. Nga viti 1992 shpërthimi i konfliktit në Bosnje dhe Hercegovinë, formimi i Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) nga ana e Serbisë dhe Malit të Zi, si edhe operacionet e “pastrimit etnik” të kryer në Bosnjën Lindore, më saktësisht në disa fshatra kufitare, e izolojnë popullatën myslimane/boshnjake në Sanxhak. Tre vjet më pas, me ndërprerjen e konfliktit, mundësohet vënia e kontaktit me Bosnjën dhe Hercegovinën, por tani Republika Serbe futet mes Federatës dhe Sanxhakut.

Duke filluar nga viti 1996, Partia demokratike e socialistëve, e cila është në pushtet në Mal të Zi, përçahet mes fraksionit kryesor të kryeministrit Millo Gjukanoviq, i cili tani më nuk solidarizohet me regjimin e Millosheviqit. Në vitin 1997, Gjukanoviqi arin fitore të ngushtë (50,8%) në zgjedhjet presidenciale kundër Momir Bullatoviqit, duke i falënderuar përkrahjes së pakicave nacionale. Në vitin 1998/1999 lufta në Kosovë dh intervenimi ushtarak i NATO-s e shpejtuau shkatërrimin e RFJ-a. PDS-ja në vitin 2002 e fillon largimin nga lidhja serbo-malazeze me autorizime të kufizuara dhe në maj të vitit 2006 organizon referendum, në të cilin 55,5% e votuesve votuan për pavarësi, përsëri me ndihmën kyçe të pakicave nacionale. Katër muaj më vonë, lista e PDS-s dhe Partisë socialdemokrate – PSD-s afrohet drejt shumicës absolute të votave (48,6%) në zgjedhjet parlamentare dhe dominon në koalicionin e ri qeveritar.

Në Serbi formimi i Opozitës Demokratike të Serbisë – ODS e ndihmon humbjen e Partisë Socialiste të Serbisë – PSS-s, ish partia komuniste, gjatë zgjedhjeve në shtator të vitit 2000, e pastaj edhe rënien e Millosheviqit gjatë “revolucionit të 5 tetorit”. Në fillim, ODS-ja e ruajti unitetin e vet, kryetari i Partisë Demokratike të Serbisë – PDS-s, Voislav Koshtunica, bëhet kryetar i RFJ-s, ndërsa kryetari i Partisë Demokratike – PD-s, Zoran Gjingjiqi bëhet premier i Serbisë. Por, rritja e tensioneve mes LDS-s konservative dhe PD-s liberale, vrasja e Gjingjiqit në mars të vitit 2003 dhe suktesi zgjedhor i Partisë Radikale të Serbisë - PRS-s, parti ultranacionaliste, nëntë muaj pas do të sjellë deri të formimi i Qeverisë e udhëhequr nga Voislav Koshtunica. Gjatë zgjedhjeve parlamentare në janar të vitit 2007, PRD fiton 28,7% të votave, PD 22,9% dhe PDS-ja 16,7%, ndërsa formimi i qeverisë atëherë varej nga qëndrimet e partive të vogla parlamentare.

.....
28 Sanxhaku është rajon në kufirin mes Serbisë dhe Malit të Zi, me 11 komuna (gjashtë në Serbi dhe pesë në Mal të Zi). Në vitin 2002 Sanxhaku serb zyrtarisht numëronte 235.567 banorë, nga të cilët 60,4% boshnjak/mysliman (shih në pjesën 4.2.3) dhe 37,9% serb. Në vitin 2003 Sanxhaku malazez numëronte 157.656 banorë, nga të cilët 39,1% serb, 37,9% boshnjak/mysliman, 17,0% malazez dhe 2,4% shqiptarë. Komunat me shumicë boshnjake/myslimane (Tutin 95%, Rozhaje 88,8%, Sjenica 75,7%, Novi Pazari 78,1%, Plava 55%) ndodhen në pjesën lindore të Sanxhakut dhe nuk kufizohen me Bosnjën dhe Hercegovinën, por me Kosovën dhe me Shqipërinë.

4.1. Nga homogjenia e fortë deri te shpërndarja ekstreme e zërit mysliman/boshnjak

4.1.1. Evolucionet në PAD-in e Sanxhakut në vitet '90

Në fillim PAD-i i Sanxhakut është vetëm degë e PAD-it të formuar në Sarajevë²⁹. Në vitin 1990 PAD-i fiton 84.156 vota (1,7%) dhe tre deputetë nga 250 në Serbi, ndërsa “Koalicioni Demokratik” i formuar nga PAD-i dhe Partia Demokratike – PD, partia shqiptare, fituan 30.170 vota (10,1%) dhe trembëdhjetë deputet (nga të cilët nëntë për PAD-in) nga gjithsej 125 deputetë në Mal të Zi. Krahasimi i numrit të myslimanëve/boshnjak në krahasim me popullatën e përgjithshme në Serbi (2,4%) dhe në Mal të Zi (14,6% plus 6,6% Shqiptarë) sugjeron se zëri boshnjak është më homogjen në Sanxhakun serb, për dallim nga ai malazez. Në të dy rastet ky homogjenitet shpjegohet me karakterin rural të Sanxhakut, me faktin se popullata myslimane/boshnjake është pakicë (shih në pjesën 4.3.1).

Shpërthimi i konfliktit boshnjak në vitin 1992 dhe re-aktivizimi i kërkesave për pavarësi të Sanxhakut në vitin 1993 (shih në pjesën 4.2.1) iniciojnë një valë të madhe të represionit politik: kryetari i PAD-it serb, Sulejman Ugljanin, strehohet në Stamboll, ndërsa dhjetëra militantë të PAD-it nga Sanxhaku, mes të cilëve edhe kryetari i PAD-it malazez, Harun Haxhiq, dënohen me burg të rëndë. Në këtë kontekst, homogjenia politike e bashkësisë myslimane/boshnjake fillon të përçahet. Në Mal të Zi bojkotimi i zgjedhjeve lokale dhe parlamentare nga ana e PAD-it dhe burgosja e shumicës së liderëve i mundëson PDS-s të prezanton kuadrot e veta myslimane/boshnjake. Në Serbi PSS-ja nuk arin që ta bëjë të njëjtën gjë, por keqkuptime serioze paraqiten në PAD, mes Ugljaninit, i cili gjithashtu apelon në bojkot të zgjedhjeve dhe Rasim Ljajiq, sekretari gjeneral i partisë i cili ka ngelë në Novi Pazar dhe i cili është për afrimin e partisë me opozitën demokratike serbe. Kjo zënkë në vitin 1994/1995 solli deri te copëtimi i PAD-it në dy parti me emra të njëjtë, të cilat PAD-i i Bosnjës dhe Hercegovinës mundohet pa sukses ti pajton.

Firmosja e Marrëveshjes së Dejtonit në vitin 1995 solli deri te ndërprerja e represionit në Sanxhak (amnisti për militantët e PAD-it, kthimi i Ugljaninit, etj.), por ndihmon edhe në zhvillimin politik të bashkësisë boshnjake. Kuptohet se në fillim Ugljanini arrin që në Serbi ta kthen pozitën e vet homogjene: “Lista për Sanxhakun” e përbërë nga PAD-i dhe më shumë parti të vogla në vitin 1996 fiton tre komuna me shumicë boshnjake në Sanxhakun serb (Novi Pazar, Sjenicë, Tutin), e pastaj në vitin 1997 fiton 49.472 vota (1,2%) dhe tre deputetë gjatë zgjedhjeve që u bojkotuan nga opozita demokrate serbe. Por, praktika autoritare dhe diskriminuese e “Listës për Sanxhakun” të cilës i shtohet edhe kërkesa për pavarësi (shih në pjesën 4.2.1) do ti detyron autoritetet serbe ta shpërndajnë këshillin komunal të Novi Pazarit dhe të caktojnë administratë të përkohshme të kontrolluar nga PSS-ja. Në vitin 1996 fitojnë vetëm 10.167 vota (3,5%) dhe tre deputet në zgjedhjet parlamentare, sepse shumica e votave boshnjake shkuan te kandidatët e PDS-s apo PSD-s. Në vitin 1997

.....
29 Lëvizja islame me sa duket nuk ka qenë e rrënjëzuar në Sanxhak para vitit 1990, por disa nga themeluesit e PAD-it në Sanxhak ishin në kontakt me këtë lëvizje gjatë studimeve të tyre në Sarajevë: siç është Sulejman Ugljanini, kryetar i PAD-it serb i cili banonte te familja e Hasan Çengiqit gjatë studimeve të tij në medicinë dhe Harun Haxhiq, kryetar i PAD-it malazez është ish nxënës i medresesë.

PAD-i vendos ta përkrah Milo Gjukanoviqin në zgjedhjet parlamentare, e pastaj të hyj në koalicionin qeveritar. Përkundër këtij hapi pragmatik, Harun Haxhiq e formon Bashkimin Demokratik Ndërkombëtar – BDM. Disa muaj më vonë, gjatë zgjedhjeve parlamentare në vitin 1998, PAD-i fiton vetëm 1.996 vota (0,6%), ndërsa BDM-ja 419 (0,1%).

4.1.2. Sanxhaku serb në vitin 2000: kundërshtimet e PAD-it dhe PSD-s

Nga fundi i viteve të '90, largimi i Serbisë nga Mali i Zi shkon krah për krah me përçarjen e politikave dinamike në Sanxhakun serb dhe at malazez. Në Serbi pozita hegjemone e “Listës për Sanxhak” është vënë në rrezik nga Partia Demokrate e Sanxhakut - PDS³⁰, e formuar në vitin 2000 nga Rasim Ljajić dhe nga parti tjera të dala nga ndarjet e mëvonshme të PAD-it, siç janë Lëvizja popullore e Sanxhakut – LPS apo Partia për Sanxhakun – PS. Gjatë zgjedhjeve lokale në vitin 2000, “Lista për Sanxhakun” bëhet partia dominuese në Novi Pazar, Sjenicë dhe Tutin. Por, ky dominim vihet në dyshim në vitin 2004, kur PDS-ja dhe PPS-ja e morën komunën e Sjenicës³¹. Në Novi Pazar, Sulejman Ugljanini zgjidhet kryetar i komunës me votim të drejtpërdrejtë, por ballafaqohet me këshillin komunal ku dominon PDS-ja. Do të vijon një bllokadë e institucioneve komunale, incidente të dhunshme mes aktivistëve të Ugljaninit dhe të Ljajićit dhe në vitin 2006 do të mbahen zgjedhje të parakohshme, ku do të vritet një kandidat i “Listës për Sanxhak” e cila do të fiton bindshëm me 53,4% të votave.

Krizat që i përjeton Novi Pazar i dëshmojnë rëndësinë e institucioneve komunale në lojërat e brendshme të bashkësisë boshnjake dhe shpërthimi i konfliktit mes PAD-it dhe PSD-s. Por, evolucioni i këtyre konfigurimeve lokale politike duhet gjithashtu të ripërtërihet në kuptimin më të gjerë. Kështu, paraqitja e PSD-s nuk mundet të kuptohet nëse nuk merret parasysh pjesëmarrja e saj në ODS, me çka fitoi dy deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2002³². Më vonë Rasim Ljajić do të bëhet ministër i Federatës për të drejtat e pakicave³³. Gjatë viteve të ardhshme, përleshjet mes PD-s dhe LDS-s derdhen edhe mes Ugljaninit dhe Ljajićit. Në fillim, PSD-ja mbështetet në Qeverinë e Gjingjiqit me qëllim që ti zhvillon rrjetet e veta. Por, në zgjedhjet parlamentare në vitin 2003, PD-ja preferon të bashkohet me “Listën për Sanxhakun” me çka fiton dy deputetë³⁴. Në vitin 2005, të njëjtit do ta ndërpresin koalicionin me PD-n dhe përkrahjen e vet dot ja japin Koshtunicës. Ky ndryshim pjesërisht është rezultat i humorit armiqësor të PAD-it ndaj pavarësisë së Malit të Zi (shih në pjesën 4.2.2), por kjo njëkohësisht i mundëson “Listës për Sanxhakun” të

.....

30 Kjo parti nuk duhet të përzihet me Partinë socialdemokrate (PSD) të Malit të Zi, as me të njëjtën parti në Bosnje dhe Hercegovinë.

31 PSD-ja po ashtu fiton edhe në komunën Prijepolje, duke i falënderuar përkrahjes nga disa parti serbe.

32 “Lista e Sanxhakut” e përkrahën kandidaturën e Voislav Koshtunicës, përkundër Slobodan Millosheviqit në zgjedhjet federale presidenciale, por i bojkotoi zgjedhjet parlamentare në shenjë të protestës kundër pragut prej 5% të votave, i cili ishte i pavalitshëm për partitë etnike apo rajonale.

33 Pastaj Ljajić emërohet kryetar i Këshillit përgjegjës për marrëdhëniet e FPJ-s me MKSJ-n dhe me Qendrën për koordinim për Serbinë Jugore (ultësira e Preshevës).

